



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVA
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar me: Primljeno: 17.03.2025		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
15052/01-11913		

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

DATE	14.03.2025
NGA	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit
PËR	Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Lipjanit
LËNDA	Raporti Janar – Dhjetor 2024 i punë së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale



I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal, z. Daut Azemi,

Me anë të kësaj shkrese, po ua dërgoj raportin për periudhën janar – dhjetor 2024 të punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.

Ky raport për periudhën e mësipërme paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara dhe është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale për raportimin e Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.

Pranuar më: Prilbjen:		
25.02.25		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-052/01	-8734	



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN



R A P O R T
I PUNËS I ZYRËS SË KRYETARIT DHE
DREJTORATEVE KOMUNALE
JANAR – DHJETOR
2024

PËRMBAJTJA

Fjalahyrëse e Kryetarit.....	3
------------------------------	---

Përmbledhje Ekzekutive.....	5
-----------------------------	---

ZYRA E KRYETARIT

1. Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore	5
2. Avokatja Publike Komunale	6
3. Sektori për Marrëdhënie me Publikun	8
4. Njësia për Auditim të brendshëm	9
5. Sektori i Personelit	11
6. Sektori pronësor – juridik	13
7. Zyra Lokale për Komunitete	14

DREJTORATET KOMUNALE

1. Drejtorati për Administratë.....	15
2. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	19
3. Drejtorati për Arsime	31
4. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport	39
5. Drejtorati për Buxhet dhe Financa	41
6. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim	50
7. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.....	52
8. Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.....	60
9. Drejtorati për Infrastrukturë	62
10. Drejtorati për Inspeksion.....	64
11. Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.....	67
12. Drejtorati i Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.....	70
13. Drejtorati i Prokurimit.....	74

FJALA HYRËSE E KRYETARIT

**Të dashur qytetarë të Komunës së Lipjanit,
I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar këshilltarë, media dhe të pranishëm,**

Më lejoni që para jush të paraqes raportin vjetor të punës së Ekzekutivit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024.

Viti 2024 ka qenë një vit i angazhimit të madh, i projekteve ambicioze dhe i rezultateve konkrete që kanë sjellë përmirësime të prekshme në jetën e qytetarëve tanë. Përkundër sfidave të kohës, me përkushtim, transparencë dhe menaxhim të mirë, kemi arritur të përmbyllim këtë vit me sukses dhe të hapim horizonte të reja zhvillimi për Lipjanin.

Është vazhduar me progres ofrimi i shërbimeve për qytetarët, zbatimi i projekteve infrastrukturore, avancimi i kushteve dhe cilësisë në sistemin arsimor dhe shëndetësor, mbështetja e ekonomisë lokale, bujqësisë, kulturës, sporteve, etj., për të shënuar progres të qëndrueshëm të zhvillimit të komunës sonë.

Një nga shtyllat kryesore të qeverisjes sonë mbetet transparenca dhe llogaridhënia. Lipjani, ashtu si në vitet e kaluara, ka vazhduar të jetë një nga komunat më transparente në Kosovë. Në raportin e fundit të Institutit GAP, Lipjani ka ruajtur pozitën e tij si një komunë model për menaxhimin e buxhetit, duke garantuar publikimin e të gjitha raporteve financiare, investimeve dhe shpenzimeve.

Gjithashtu, në kuadër të projektit DEMOS të MAPL-së, Komuna e Lipjanit ka përfituar Grantin e Performancës, duke siguruar mbi 1 milion euro (1.041.389,61) me të cilat do të financohen projekte të reja.

Një tjetër sukses ka qenë tejkalimi i planifikimit të të hyrave vetanake, duke dëshmuar një menaxhim të qëndrueshëm të financave dhe një administratë efikase në mbledhjen e të ardhurave komunale. Viti 2024 është viti i vërtetësisë së qëndrueshmërisë progresive dhe stabilitetit në të hyrat buxhetore, duke shënuar rritje në tejkalimin e të hyrave vetanake prej 41.03%. Po ashtu, viti 2024 është ndër vitet më të suksesshme, duke shpenzuar buxhetin në shkallë prej 97.64%, që shënon një rezultat shumë pozitiv.

Një prej dëshmimeve për menaxhimin e mirë financiar është raporti i auditorit, i publikuar në vitin 2024 për vitin 2023, që vërteton edhe një herë për 10 vjet rresht suksesin tonë, duke cilësuar komunën tonë me vlerësimin më të lartë të pasqyrave financiare me opinionin e pamodifikuar. Ky është rezultat i shkëlqyer i gjithë qytetarëve, e në veçanti i zyrtarëve dhe menaxhmentit të Komunës sonë.

Viti 2024 ka qenë një vit i rëndësishëm për zhvillimin infrastrukturor të komunës sonë. Kemi përfunduar dhe kemi vazhduar një sërë projektesh të rëndësishme, ndër të cilat:

Finalizimi i nënkalimit dhe parkingut nëntokësor, si dhe vazhdimi i ndërtimit të sheshit qendror dhe parkut, janë projekte madhore që do të shërbejnë për një trafik më të lehtë, shtim të hapësirave gjelbëruese dhe parkingjeve të nevojshme, duke krijuar një hapësirë më të bukur dhe funksionale për qytetarët tanë.

Punimet në ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), një projekt kapital që ka filluar në vitin 2024 dhe pritet të përfundojë në vitin 2025, e cila do të ofrojë kushte moderne për trajtimin dhe shërbimin shëndetësor të qytetarëve tanë.

Renovimi dhe asfaltimi i shumë rrugëve dhe rrugicave në qytet dhe në fshatra, duke përfshirë Gadimen, Magurën, Sllavin, Qylagën dhe zona të tjera. Investimet në rrjetet dhe anekset e kanalizimeve dhe ujësjellësve janë shumë të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve.

Po ashtu, është përruruar çerdhja e re në fshatin Rufc i Ri dhe janë renovuar shkolla të ndryshme, si: Shkolla e Mesme në Shalë, SHFMU në Topliqan, Medvec, Sillovi, Qylagë, Rufci i Ri, me standarde efikase energjetike.

Kemi investuar në teknologji dhe digjitalizim, duke përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe qasjen në arsim.

Në fushën e shëndetësisë, gjatë vitit 2024 janë zgjeruar shërbimet shëndetësore nëpër qendrat mjekësore të fshatrave. Pajisja e QKMF-së me aparaturë moderne, duke përfshirë autoambulancat dhe pajisje diagnostikuese, ka bërë të mundur një shërbim më efikas.

Janë rritur grantet për bizneset e vogla dhe të mesme, duke krijuar vende të reja pune dhe duke ndihmuar zhvillimin ekonomik të komunës sonë. Gjatë vitit 2024, në bashkëpunim me organizata vendore dhe ndërkombëtare, janë subvencionuar mbi 900 fermerë (929) me grante në vlerë të përgjithshme prej 480,301 euro.

Kemi vazhduar projektin "Harta Dixhitale Komunale", një hapësirë inovative për bizneset dhe qytetarët për identifikimin dhe planifikimin e pronave.

Në fushën e sportit, rinisë dhe kulturës, janë shtuar aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive, dhe janë subvencionuar shumë prej aktiviteteve.

Janë organizuar aktivitete tradicionale si "Mërgata Fest & Sport", "Lipjani Këndon" dhe edicioni i dytë i "Rinia Fest", duke i dhënë qytetit një energji të re kulturore.

Klubet sportive dhe aktivitetet rinore janë mbështetur me fondet më të larta deri tani për të nxitur zhvillimin e sportit në Lipjan. Vlera e subvencioneve në sport dhe kulturë kalon mbi 200 mijë euro (204,445.00 euro). Po ashtu, është funksionalizuar palestra e re sportive, që tashmë është bërë një qendër e rëndësishme për ndeshjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Të nderuar asambleistë dhe ju qytetarë të dashur,

Ky vit ka qenë një tjetër dëshmi se Komuna e Lipjanit po zhvillohet dhe po rritet. Sfida gjithmonë do të ketë, por me punë të përkushtuar dhe bashkëpunim me qytetarët, ne do të vazhdojmë të ndërtojmë një komunë moderne, transparente dhe të zhvilluar.

Faleminderit për besimin dhe mbështetjen tuaj!

Lipjani po ecën përpara së bashku vazhdojmë ta ndërtojmë të ardhmen!
Ju faleminderit për bashkëpunim dhe kontributet tuaja për secilin qytetar dhe zyrtar të Lipjanit.

IMRI AHMETI
Kryetar i Komunës së Lipjanit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport për periudhen janar – dhjetor 2024, paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara nga Kryetari i Komunës dhe qeverisja lokale. Raporti është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për raportim të Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.

Edhe në këtë periudhë Janar- Dhjetor 2024, angazhim kryesor i Kryetarit të Komunës dhe organeve tjera komunale ka qenë përkushtimi për zbatimin e rendit, ligjit dhe disciplines në punë. Në vazhdim po e paraqesim raportin që përmban informata për punën e Zyrës së Kryetarit dhe të gjitha Drejtorateve dhe zyrave në kuadër të komunës.

ZYRA E KRYETARIT

SEKTORI PËR PËRFAQËSIM DHE ÇËSHTJE LIGJORE

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periodës raportuese Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore ka vazhduar me përcjelljen e zakonshme të Ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve tjera nënligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës si dhe harmonizimin e akteve të Komunës me dispozitat e reja ligjore.

Gjatë periodës raportuese kemi dhënë këshilla juridike dhe kemi ndihmuar Drejtoratet dhe sektorët e tjerë të komunës edhe në përplimin e akteve apo rregullimin e pjesës hyrëse- bazës ligjore sipas kërkesave të tyre si dhe kemi dhënë opinione të ndryshme rreth nënshkrimit të Memorandumeve apo Marrëveshjeve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

Gjatë periodës raportuese me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform legjislacionit në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

Për lëndët e adresuara Kryetarit të Komunës nga kompetenca e Drejtorateve dhe e Zyrës së Kryetarit është udhëzuar nëpunësi për dorëzimin e shkresave që lëndët ti dërgojë në Drejtoratet përkatëse ndërsa lëndët e Zyrës së Kryetarit te përpunuesit sipas kompetencës.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periodës janar-dhjetor 2024, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore me kërkesë të Kryetarit ka përgatitur Vendime, Urdhëresa, Shkresa të ndryshme, Marrëveshje, Kontrata, Autorizime, Propozim Rregullore dhe Propozim Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës të cilat i kemi specifikuar në tabelën në vijim:

STATISTIKAT

Aktet e përgatitura nga Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore për periodën janar-dhjetor 2024:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendimet	668 vendime gjithsej 536 vendime me karakter individual jo të përgjithshëm ndërsa 132 vendime me karakter të përgjithshëm
2.	Shkresat	277
3	Urdhëresa	1
4.	Kontrata	19
5.	Marrëveshje	275
6.	Propozim Rregullore dhe Propozim-Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës	38
7.	Autorizime	2

ZYRA E AVOKATURËS PUBLIKE KOMUNALE

Sipas lëndëve të pranuar nga zyra për pranimin e lëndëve dhe të regjistruara në regjistrin e lëndëve, Zyra e Avokaturës Publike Komunale, brenda afatit të kërkuar bën këtë raport të punës me sa vijon:

Përmbledhje statistikore:

Nga vitet paraprake janë bartur për vitin raportues gjithsej 1631 (civile, përmbarimore, penale dhe administrative) lëndë që janë ende në punë.

Statistikat për vitin raportues **2024.**

Në regjistrin e lëndëve brenda afatit 1 Janar – 31 Dhjetor 2024, bën këtë raport të punës me sa vijon;

Lëndët	Numri i lëndëve
Lëndë të pranuar civile	1249
Lëndë të pranuar përmbarimore	372
Lëndë në procedurë administrative brenda institucionit	15
Seanca të mbajtura	448
Ankesa të ushtruara në Gjykatën e Apelit (civile dhe përmbarimore)	796
Përgjigje në Padi të ushtruara	1249
Prapësime në procedurë përmbarimi	6
Padi të ushtruara	7
Lëndë të arkivuara civile	338
Lëndë të arkivuara përmbarimore	52

Përshkrimi i natyrës së lëndëve të pranuar

Nga 1249 lëndë (padi dhe propozime) të pranuar;

Kërkesa sipas Kontratës Kolektive të arsimit (ushqim, udhëtim, inflacion etj.)	754
Orë mbi normë, mësim në fundjavë, punë gjatë grevës dhe pandemisë	320
Kualifikim, pas Vendimi të Gjykatës Supreme për anulimin e nenit për pagat	130
Kompensim dëmi	17
Paga e 13-ta për punëtorët e sektorit të shëndetësisë	7
Anulim vendimi administrativ	6
Anulimi i procedurës së shpronësimit lidhur me shpronësimet për projektin e ndërtimit të nënkalimit dhe parkingut nëntokësor.	4
Ndryshim i koeficientit në pagë	3
Mbajtja e mësimi me klasë të kombinuara	3
Vërtetim pronësie	2
Propozime për ndryshimin e çmimit (vlerës) për shkak të shpronësimit	2
Mëditje për anëtarin e KKSb-së	1

Procedura të filluara sipas kërkesës së organeve komunale

I kemi filluar 3 (tre) procedura për anulimin e vendimit për shpronësim që ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovë në ZK Qylagë dhe Poturovc në afërsi të Zonës Ekonomike. E para për anulim të tërësishëm të vendimit, e dyta kundër vlerësimit (në rast se nuk aprovohet anulimi) si dhe e treta kemi kërkuar caktimin e masës që të ndalohet çfarëdo ndërtimi nga organi shpronësues.

Në këtë periudhë raportuese kemi ushtruar 3 (tri) padi në Gjykatën Komeriale, si vijon;

- Ndaj një Kompanie së Sigurimeve për pagesën e garancionit prej 20,988.92 €.
- Ndaj një Kompanie së Sigurimeve për pagesën e garancionit prej 33,954.39 €.
- Ndaj një operatori ekonomik për mos zbatimin e plotë të kontratës për 50m² të munguara sipas marrëveshjes për koncesion.

Një (1) padi kemi ushtruar për anulimin e Vendimit të MMPHI-së, lidhur me lejimin nga kjo e fundit për mbi—ndërtimin (jashtë normave të caktuara me Hartën Zonale).

Përmbledhje për disa lëndë të vlerës së madhe

Gjatë periudhës raportuese, veçojmë disa lëndë të cilat janë gjykuar në dobi të Komunës. Veçojmë lëndët e vlerës së konsiderushme, si më poshtë;

- C.nr. 1520/19 për kompensimin e pagave në shumen prej 932'698.69 €.
- C.nr. 565/17 kompensim dëmi, vlera 29'621.24 €.
- C.nr 475/13 vlera e kontekstit 60'000'00 € kompensim për dëmet e shkaktuara pas luftës – e tërhequr
- P.nr. 317/22, shuma e kontestit 655'743.59 € (pala ka parashtruar ankesë).
- C.nr. 95/18, për kompensimin e dëmit në shumen prej 81'963.85 € (pala ka parashtruar ankesë).
- C.nr. 1042/20, shuma e kontestit 12'000.00 € (pala ka parashtruar ankesë).
- C.nr. 313/16, vërtetim pronësie (kthyer në ri-gjykim).
- C.nr. 61/03, shuma e kontestit 13'188.00 € (vërtetuar nga Gjykata Supreme).
- C.nr. 134/05, shuma e kontestit 15'907.23 € (pala ka parashtruar ankesë).
- C.nr. 854/20, për vlerën e kontestit 34'286.16 € (vërtetuar nga Gjykata e Apelit).

Sfidat

Gjatë periudhave raportuese të kaluara por edhe kësaj periudhe, kanë qenë sfida kryesore që edhe kanë paraqitur problem gjatë mbrojtjes ligjore të interesave të Komunës, mungesa e dokumentacioneve nga arkiva dhe mangësia, vështirësitë për gjetjen e dokumenteve arkivore të viteve të paraluftës.

Gjithashtu sfidë tjetër është e Kontratave kolektive të arsimit dhe shëndetësisë në të cilat Komuna nuk është fare nënshkruese e tyre por janë ministritë e përkatëse, të cilat nuk kanë menduar fare për gjetjen e mënyrës së ekzekutimit të obligimeve që rrjedhin nga këto kontratë në procedurë administrative në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i komunave në procedurë gjyqësore dhe të krijohen shpenzime të pa nevojshme.

Sa i përket kompensimit për kualifikim nga lëmia e arsimit, bazë për miratimin e tyre Gjykata kanë gjykuar që është vendimi i QRK-së nr. 01/33 i dt. 29.08.2008 i cili ende është në fuqi pas anulimit të nenit përkatës nga Gjykata kushtetuese dhe se do të paraqiten padi të reja për kompensimin e kualifikimit, nëse nuk shfuqizohet ky Vendim nga Qeveria apo me ligj për paga ky të shfuqizohet ligjërisht.

Sfidë ka paraqitur edhe numri i madh i padive të dorëzuara gjatë tremujorit të fundit të vitit, të cilat kanë qenë në tërësi me shumë numerikisht se tërë viti paraprak i raportimit (viti 2023 ka pasur 422 lëndë, ndërsa vetëm gjatë muajit Nëntor 2024 ka pasur 478 padi të dorëzuara Komunës).

Këtë periudhë raportuese kemi disa Aktgjykime të shkallës së parë që i kanë njohur të drejtën për kompensim punëtorëve të sektorit të shëndetësisë sa u përket pagave të 13-ta për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe kompensimin prej 30% të pagës bazë për punën në punkte, ndaj këtyre kemi ushtruar ankesë dhe janë duke u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit.

Ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave kemi ushtruar padi për ri-mbursim për të gjitha pagesat që janë bërë për shkak të kontratave kolektive, por që paditë ende nuk janë shqyrtuar nga Gjykata që tani gati 2 vite.

Dëm financiar i është shkaktuar Komunës edhe për shkak të mos definimit të statusit të punëtorëve të Brigadës së Zjarrfikësve në Lipjan, të cilët edhe pse kanë kontratat e punës me Agjencinë e Menaxhimit Emergjent pagat i marrin nga buxheti i Komunës. Kësisoj në shkallë të parë ju është aprovuar padia dhe është obliguar Komuna që të ju paguaj pagesat shtesë sipas Ligjit të Punës për orë jashtë orarit, ndërrimet e natës, oraret gjatë funde javëve dhe festave.

Dëme të vazhdueshëm financiar i paraqitet Komunës edhe gjatë procedurës së shpronësimit për shkak të mos vlerësimit real të çmimit të tregut nga Departamenti përkatës i Ministrisë së Financave, ku shumica e palëve që atakojnë vendimet lidhur me shumen e caktuar nga Ministria i fitojnë. Rasti i shpronësimit për njërën nga palët për njësitë për ndërtimin e parkut qendror ku MF e ka llogaritur vlerën për shpronësim në shumen prej 84'884.00 € ndërsa eksperti gjyqësor financiar të njëjtën e ka vlerësuar në shumen prej 429'098.33 €.

Rekomandime

Në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës – Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të gjendet zgjidhje për kërkesat që dalin nga Kontratat Kolektive Sektoriale e po ashtu të definohet statusi i zjarrfikësve për shkak të dualitetit dhe përzjerjes së kompetencave mes të AME-së – MPB-së dhe Komunës.

SEKTORI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Sektori për Marrëdhënie me Publikun në vitin 2024 është angazhuar maksimalisht në realizimin e detyrave dhe përmbushjen e obligimeve në mënyrë që Komuna e Lipjanit të vazhdoj të jetë në mesin e komunave të para sa i përket transparencës dhe llogaridhënies.

Në web faqen zyrtare të Komunës ka vazhduar publikimi i materialeve të ndryshme në mënyrë që qytetarëve tu ofrohen të dhënat e nevojshme. Kjo web faqe ka qenë edhe një udhëzim shtesë dhe transparent në të cilën janë publikuar të gjitha vendimet, shkresat, njoftimet, rregulloret, raportet e shpenzimeve financiare, kontrata, planifikimi i buxhetit, ndarja e subvencioneve si dhe shumë material të tjera.

Po ashtu edhe gjatë këtij viti me një transparence të plotë janë zhvilluar punimet e të gjitha seancave të Kuvendit, të cilat janë transmetuar drejtëpërdrejtë në kanalin zyrtarë të komunës në Youtube.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periudhës raportuese Sektori për Marrëdhënie me Publikun ka kryer punët në vijim: Është bërë përcjellja e aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, po ashtu janë përcjellur edhe aktivitete të tjera që ka zhvilluar ekzekutivi si dhe Kuvendi e Komitetet. Aktivitetet janë përcjellë brenda dhe jashtë komunës dhe pastaj është bërë përgatitja e lajmeve për publikim në web faqen zyrtare, rrjetet sociale si dhe në media të ndryshme;

- Sipas kërkesave të Drejtorateve dhe sektorëve tjerë janë publikuar materialet e ofruara për zyrën e informimit;
- Janë publikuar në web faqe të gjitha vendimet e kryetarit, Publikimi i raporteve të drejtorëve për gjatë tërë vitit. Po ashtu janë publikuar në web faqe rregullore, vendime, plane strategji, njoftime dhe konkurse të shumta të cilat janë dërguar në zyrën për informim;
- Është bërë publikimi i kontratave të prokurimit sipas kërkesës nga Drejtoria e Prokurimit. Janë ofruar informata për gazetarë duke ju referuar kërkesave të tyre si dhe janë pranuar dhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike.
- Rëndësi të veçante i është kushtuar përditësimit të web faqes së komunës duke ofruar informacione të rëndësishme për qytetar, si publikimi i rreth të hyrave dhe shpenzimeve të buxhetit, thirrjet për grande, thirrjet për subvencionim e shumë dokumente të tjera.
- Janë publikuar informata të ndryshme si: për lejet ndërtimore, informata për shfrytëzimin e hapësirave publike, pronave komunale, regjistrin e auto taksive në Lipjan e shumë informata të tjera në interes të qytetrëve.
- Materiale të ndryshme që i'u janë drejtuar zyrës për komunikim me publikun janë publikuar edhe në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, platformën e konsultimeve publike të qeverisë së Kosovës dhe në gazetatat ditore për të cilat kërkohet me ligj.
- Po ashtu në periudhën e vitit 2024 është menaxhuar kontrata lidhur me shërbimet mediale në komunën e Lipjanit.
- Hartimi i rregullores për transparence në Komunën e Lipjanit.
- Është vazhduar publikimi i draft Agjendës javore të takimeve të Kryetarit në web faqen e Komunës së Lipjanit.
- Është vazhduar publikimi i buletinit mujor të aktiviteteve të realizuar nga Kryetari dhe ekzekutivi në web faqen e Komunës së Lipjanit;

STATISTIKAT

Nr.	Emërtimi	Publikimet
1	Reportazhi vjetor	1
2	Lajme në web	376
3	Marrëveshje	25
4	Vendimet e kryetarit	132

5	Raportet e kryetarit	2
6	Qasje në dokumente publike	47
7	Raporti i auditorit	1
8	Raporte për diskutime publike	15
9	Procesverbalet e konsultimeve	15
10	Deklarimi i pasurisë	2024
11	Raporte të drejtorateve	156
12	Kontrata të prokurimit	103
13	Dokumente të ndryshme nga Drejtorati i Prokurimit	135
14	Vendime të OSHP-se	9
15	Konkurse	54
16	Njoftime	234
17	Raporte dhe dokumente nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa	30
18	Thirrjet dhe Ekstraktet e KKS-së	6
19	Buletin	12
20	Vendime dhe akte të tjera nga kuvendi	54
21	Materialet e kuvendit	13
22	Procesverbale dhe ftesa nga sektori i kuvendit	62

TAKIME E NDRYSHME

Janë zhvilluar takime të ndryshme me gazetarë nga mediat e ndryshme të shkruara dhe elektronike, takime kemi pasur edhe me qytetarë të cilët i janë drejtuar zyrës sonë për informata rreth komunës po ashtu ju kemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve përmes thirrjeve telefonike në numrin e zyrës së informimit si dhe përmes emaili zyrtar të komunës së Lipjanit.

SFIDAT

Ndër sfidat që na ka përcjellur kryesisht janë problemet me funksionimin e web faqes zyrtare të komunës, ku edhe për gjatë kësaj periudhe kemi pasur shumë pengesa rreth publikimit të dokumenteve. Po ashtu është bërë edhe ripublikimi i shumë dokumenteve të tjera pasi që shumë të dhëna janë fshirë nga web faqja gjatë këtij viti.

NJËSIA PËR AUDITIM TË BRENDSHËM

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Me aprovimin e ligjit mbi kontrollin dhe menaxhimin financiar me të cilin ishte ndryshuar koha e dorëzimit të planit vjetor të punës në Ministrinë e Financave pas aprovimit nga Komiteti i Auditimit dhe Kryetari i Komunës , kështu në Muajin Dhjetor të vitit paraprak është përpiluar Plani Strategjik Trevjeçar 2024-2026 në të cilin janë paraparë Objektivat kryesore për një cikël trevjeçar të Auditimit për të gjitha fushat e Auditimit.

Pas vlerësimit të rrezikut për secilën fushë të identifikuar ,pas vlerësimit të rrezikut për secilën fushë është bërë renditja e detyrave të punës të cilat janë auditive të rregullta të planifikuara, duke u bazuar në shkallën e rrezikut për fushat e identifikuar në Planin Strategjik dhe kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore të cilat i ka Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Plani strategjik për vitet 2024-2026 , dhe plani vjetor i punës për vitin 2024 , pas përpilimit të planeve nga udhëheqësi i NJAB-së janë prezantuar për shqyrtim në Komitetin e Auditimit dhe pas miratimit të tyre janë aprovuar nga Kryetari i Komunës dhe janë dërguar edhe në NJQHB-MFT .

-Në përputhje me Planin Strategjik për vitet 2024-2026, është hartuar edhe plani vjetor i punës për vitin 2024.

NJAB ka filluar së impementuari detyrat e parapara me Planin e aprovuar vjetor të Punës që ti kryej Auditimet e planifikuara me planin vjetor të punës për vitin 2024.

Angazhimi i NJAB në vitin 2024, ka pasur për objektiv realizimin e auditimeve të planifikuara sipas planit të punës të aprovuar për vitin 2024 dhe kryerjen e rishikimeve për auditimet e kryera , pas pranimit të planit të zbatimit të rekomandimeve nga drejtorët e drejtorive ku është kryer auditimi dhe përmbajtjes së orarit për rishikim të cilin NJAB i dërgon me Raportin Final ,

ndërsa NJAB pas rishikimit ka përgatitur informatë me shkrim së bashku me formularin 4001 , me të cilën ka njoftuar edhe ZKA an lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve nga NJAB.

Puna që është kryer gjatë periudhës **janar 2024-dhjetor 2024**, i referohet pikërisht përmbushjes së objektivave të parapara me këto Plane të cekura më lartë.

Me planin e punës të aprovuar të NJAB-së për vitin 2024 , kishte planifikuar Auditime të rregullta, 11 detyra për dhënie të sigurisë lidhur me funksionimin e kontrollit të brendshëm në Organizatën Buxhetore Komuna e Lipjanit .

PUNËT DHEAKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë vitit 2024 NJAB ,ka Finalizuar 11 Raporte të Auditimit të cilat janë kryer në këto entitete:

- 1.)** Auditimi i procedurave të prokurimit për Vitin 2 0 2 3 Fushëveprimi : 01.01.2023- 31.12.2023.
- 2.)** Auditimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë –DBF ,Fushëveprimi i auditimit ka qenë periudha prej Shkurt 2023 – Janar 2024
- 3.)** Auditimi : „Përdorimi dhe menaxhimi i veturave zyrtare në Administratën Komunale” Fushëveprimi i auditimit është periudha 01.02.2022 deri me 15.03.2024
- 4.)** Auditimi i procesit të Hyrave në drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm, Fushëveprimi i auditimit është periudha prej 01.04.2023 – 31.03.2024
- 5.)** Emërtimi i Auditimit: „Procedurat e Shpenzimeve në QKMF , Drejtoria e Shëndetësisë“ për periudhën 01.04.2022 – 30.04.2024
- 6.)** „ Auditimi i të hyrave të arkëtuara nga taksat në Zyrat e Vendit dhe ofiqari në Drejtorinë e Administratës për periudhën 01.08.2022 deri me 01.05.2024
- 7.)** Auditimi „ Të hyrat nga pronat komunale nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria për Ekonomi dhe zhvillim”, periudha 30.06.2022 deri më 01.06.2024
- 8.)** Auditimi i procedurave për menaxhimin e kontratave me rastin e implementimit të projekteve kapitale “ në Drejtorinë për Infrastrukturë për periudhën prej 01.07.2023 -30.06.2024
- 9.)** Auditimi i Shpenzimeve në Administratën Komunale” (01.10.2023 - 20.09.2024)
- 10.)** Regjistrimi dhe Menaxhimi i Pasurive Komunale” për periudhën 01.11.2023 – 01.11.2024”
- 11.)** Auditimi i Performancës „Subvencionet në DBP dheDRSK periudha 01-01.2023-30.09.2024

Gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2024 , NJAB ka monitoruar edhe shkallën e implementimit të rekomandimeve të cilat janë dhënë me rastin e kryerjes së auditimeve të brendshme dhe për të cilat menaxhmenti (zyrtarët përgjegjës të entitete ku është kryer auditimi), ka përgatitur planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të NJAB-së

Në këtë periudhë janë kryer edhe 8 Rishikime të auditimeve sipas orarit të paraparë për rishikim .

Të gjitha raportet finale janë dorëzuar për përgjegjësitë e entiteteve të audituara dhe Zyrës së Kryetarit dhe Komitetit të Auditimit.

NJAB gjatë vitit 2024 , ka kryer edhe rishikimin e shkallës së zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i jashtëm për raportin e PVF për vitin 2021 , dhe këtë rishikim e ka prezantuar në Asamblenë Komunale .

NJAB në fund të vitit 2024 ju ka dërguar planet e zbatimit të gjitha entitete të audituara për të marrë informata lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NJAB , gjatë vitit 2024 , me qëllim të prezantimit sa më të saktë të shkallës së zbatimit të rekomandimeve nga NJAB në Raportin vjetor i cili dërgohet në NJQHAB .

STATISTIKAT

Për vitin 2024 , NJAB ka kryer 11 Auditime të rregullta të planifikuara të cilat ishin paraparë me planin vjetor të punës për vitin 2024, dhe 8 Rishikime të Auditime të kryera më herët nga NJAB me qëllim të monitorimit të progresit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së dhe dërgimi informative të shkruara përgjegjëse të entiteteve të audituara dhe menaxhmentit (kryetarit të komunës) lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve.

Është mbajtur një trajnim me NJQHAB –it me temën Auditimet e performances , si dhe takimi lidhur me prezantimin e përmbushjes së kriterëve për performancë nga fusha e financave , prokurimit , burimeve njerëzore dhe auditimit të brendshëm me DEMOSIN.

TAKIME E NDRYSHME

Gjatë këtij viti janë mbajtur edhe pesë takime të rregullta me Komitetin e Auditimit ku janë shqyrtuar raportet e punës së NJAB-së për periudhat:

Takimi i parë është mbajtur me komitetin në Muajin Janar 2024 ,për shqyrtimin e raporteve të punës së NJAB-së për periudhën TM4-2023,

Takimi i dytë për raporti për Tremujorin e parë 2024 , (TM1-2024) , takimi është mbajtur në Muajin Prill- 2024.

Takimi i tretë me Komitetin e Auditimit për shqyrtimin e Raportit Tremujorin e dytë(TM2-2024) të NJAB-së, është mbajtur në Muajin Korrik 2024 .

Takimi i katërt me Komitetin e Auditimit për shqyrtimin e Raportit Tremujorin e tretë(TM3-2024) të NJAB-së, është mbajtur në Muajin Tetor 2024 .

Takimi i pestë me Komitetin e Auditimit për aprovimin e planit strategjik të NJAB-së për vitet 2025-2027 dhe planit vjetor punës për vitin 2025 është mbajtur në fund të Muajit Dhjetor 2024 , ku është miratuar plani i punës për NJAB-në nga Komiteti i Auditimit dhe është aprovuar nga Kryetari i Komunës .

SEKTORI I PERSONELIT

PËRMBLEDHJA E PËRGHITHSHME E RAPORTIMIT

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore siguron menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore përmes zhvillimit të procedurave, programeve dhe shërbimeve që kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të institucionit dhe punonjësve duke bërë balancimin e duhur të nevojave të punonjësve dhe nevojave të institucionit, si dhe ushtron funksionet e kompetencat në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në fushën e burimeve njerëzore duke siguruar zbatimin e politikave, legjislacionit dhe procedurave për punësimin, dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në Komunën e Lipjanit. Udhëheq procesin e planifikimit, rekrutimit, vlerësimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe menaxhon e mirëmban sistemin e informatave për menaxhimin e burimeve njerëzore të komunës, identifikimin e nevojave për trajnimin, arsimimin dhe avancimin e burimeve njerëzore.

Në kuadër të fushë veprimtarisë së saj dhe në përputhje me kornizat ligjore në fuqi, që përfshinë shërbimin civil dhe atë publik të Komunës së Lipjanit Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore kujdeset për të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve publikë, në pajtim me dispozitat e ligjore në fuqi. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është angazhuar në kryerjen e punëve me përgjegjësi të plotë në hartimi e vendimeve dhe shkresave brenda fushëveprimit të saj.

Struktura Organizative e Administratës Komunale për vitin 2024

Nr	
1	Numri i përgjithshëm i të punësuarave në administratën Komunale janë 195
2	Numri i të punësuarave meshkuj janë 120
3	Numri i të punësuarave femra janë 75
4	Numri i të punësuarave nga komunitetet pakicë meshkuj janë 6
5	Numri i të punësuarave nga komunitetet pakicë femra janë 1
6	Të punësuarit me nevoja të veçanta meshkuj janë 3
7	Të punësuarit me nevoja të veçanta femra janë 1

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Njësi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka sistemuar formularët për vlerësimin e rezultateve në punë të zyrtarëve duke i vendosur nëpër dosje fizike dhe elektronike. Siguron zbatimin e procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë, pushimet, trajnimet, administron sistemin për vijueshmërinë në punë, procedurat disiplinore, procedurat e ankesave, mbështet dhe organizon punën e Komisionit Disiplinor për nëpunësit e shërbimit publikë dhe Komisionit të Ankesave për nëpunësit e shërbimit publikë, pezullimin e marrëdhënies së punës, transferimin e nëpunësve, përfundimin e marrëdhënies së punës – lirim nga shërbimi civil, vërtetimet, statistikat e të punësuarve etj., në bazë të legjislacionit në fuqi;

STATISTIKAT

Për më shumë, në formë statistikore, gjeni të bashkangjitur një tabelë, pjesë e këtij raporti

përmbledhës.

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Raporti 1 vjetor 2024 (janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor korrik gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor)	6
2	Aktemrime	9
3	Aktemrime për Zyrtarët Komunal	110
4	Vlerësimi i rezultateve në punë për Zyrtarët e administratës komunale	141
5	Konfirmimi për disponueshmëri të mjeteve	1
6	Kompletimi i të dhënave të përvojës së punës për Zyrtarët e Administratës Komunale për Ministrin e Financave	156
7	Punimi i kontratave për Praktikant	34
8	Punimi i kontratave për nëpunës teknik dhe mbështetës	5
9	Punimi i përshkrimit të detyrave të punës	3
10	Rifreskimi i të dhënave të zyrtarëve në dosjet personale dhe në SIMBNJ në rregullimin e përvojës së punës dhe të aktemrimeve të reja	130
SHKRESAT PER ANTIKORRUPSION		
11	Njoftime për deklaram të pasurisë në APK	10
12	Njoftime për deklaram të dhuratave për zyrtarët publik të Komunës së Lipjanit dhe APK-ën	2
LISTAT		
13	Punimi i listës për pagesë për sistem të pagave për anëtarët e kuvendit	167
14	Printimi, shpërndarja dhe mbledhja e listave të pagave	97
PUSHIMET		
15	Pushime mjekësore.	132
16	Pushime vjetore.	321
17	Pushim i Atësisë	1
FORMULARET PER NDRYSHIME		
18	Punimi i formularëve për ndryshime	66
19	Punimi i formularëve për punëtorët e larguar	12
20	Punimi i formularëve për punëtorë të rinj	13
21	Punimi i formularëve për transfer bankar	4
22	Punimi i formularëve për retroaktiv	24
VERTETIMET		
23	Vërtetim për kryerjen e praktikës	10
24	Vërtetim për përvojë të punës	10
VENDIMET		
25	Vendim për pushim ditore për nënat lehonë për mbrojtjen e të Ushqyerit të fëmijës	1
26	Vendim për ndërprerje e marrëdhënies së punës	7
27	Vendime për kryerjen e praktikës	8
28	Vendim për emërim	1
29	Vendim për Pushim të Lehonisë	2
30	Vendim për Transferime	15
31	Vendim për përvojë të punës	15
32	Vendime për Udhëtime Zyrtare	14
33	Vendim për Pushim pa pagesë	4
34	Vendim për shfuqizim të marrëveshjes për punë shtesë	1
35	Vendim për Komisionin për Klasifikimin e vendeve të punës	1
36	Vendim për përfundimin e Marrëdhënies së Punës	1
KONKURSET		
37	Kërkesa për aprovim të konkurseve	25
38	Publikimi i konkurseve në Administratën Komunale	18
39	Publikimi i konkurseve për Arsim dhe Shëndetësi	28
40	Publikimi i konkursit për Praktikantë me pagesë	1
41	Vendim për Formimin e Komisionit Rekrutues	16
42	Vendimi i komisionit për vlersimin e aplikacioneve të praktikanteve	1
43	Verifikimi paraprak i Aplikacioneve SIMBNJ	404
44	Njoftim për procedurat e rekrutimit, për test me shkrim dhe intervistë	59
45	Vendim për refuzimi të Aplikacioneve	148
46	Intervistë dhe testit me shkrim për procedurat e rekrutimit	19
47	Formular i vlerësimit individual për kandidatë	5
48	Pjesëmarrja në komision në Drejtoratin për Arsim– test me shkrim dhe intervistë	2

	KERKESAT	
49	Kërkesë për Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/ DMZP (pagesa retroaktive)	6
50	Kërkesë për Komision Disiplinor	2
51	Kërkesa për ID- kartela zyrtare	20
52	Kërkesë për DMZP për ekuivalentim te pagës për zyrtaret e gjendjes civile	1
53	Kërkesë për DMZP për ndryshim te planit te personelit	1
54	Kërkesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës	1
55	Kërkesë për DMZP për ekuivalent im te pagës për zyrtar te ambientit	1
	PERGJIGJET	
56	Përgjigje ne kërkesë për masë disiplinore	1
57	Përgjigjeje në Kërkesat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	7
58	Përgjigje në kërkesë	16
	NJOFTIM	
59	Njoftim për arritjen e moshës së pensionimit	2
60	Njoftim/ ftesë për komision disiplinor	2
61	Njoftim për përfundimin e periudhës provuese	12
62	Njoftim për drejtorët dhe shefat e sektorëve lidhur me pushimet dhe vijueshmërinë ne pune	1
63	Njoftime te ndryshme	5
64		
	PËLQIME	
65	Pëlqim për Transferime	14
66	Pëlqim për nënshkrimin e Aktemrimit (për emërim)	8
	REGJISTRAT	
66	Regjistri i trajnimeve	56
67	Regjistri për vijueshmëri për ASHI	1
	AUDITORET	
68	Auditim nga Auditorët e jashtëm	1
	Gjithsejtë	2418

TAKIME TË NDRYSHME

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka marrë pjesë në takim pune, trajnime të ndryshme profesionale dhe në komisione të ndryshme të angazhuara me Vendim të Kryetarit të Komunës.

SEKTORI PRONËSORO – JURIDIK

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periodës raportuese është bërë përcjellja e dispozitave ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës.

Gjatë kësaj periudhe me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform dispozitave ligjore në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periodës raportuese të vitit 2024 janë përgatitur: Vendime, Shkresa të ndryshme, Pëlqime, Kontrata, dhe Propozim-Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

STATISTIKAT

Aktet e përgatitura nga Sektori Pronësoro-Juridik për vitin 2024:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendime	13
2.	Shkresa	177
3.	Pëlqime	1
4.	Kontrata	27
5.	Propozim-Vendime	14

Sektori Pronësoro-Juridik ka pranuar lëndë nga Drejtorati i Administratës Komunale, Sektor të Komunës si dhe lëndë të parashtruar nga palët, në procedurë administrative janë pranuar gjithsej 245 lëndë, prej tyre të kryera 232 dhe në procedurë 13 lëndë.

TAKIME E NDRYSHME

Sektori Pronësoro-Juridik ka marrë pjesë në takim pune, trajnime të ndryshme profesionale dhe në komisione të ndryshme të angazhuara me Vendim të Kryetarit të Komunës.

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Gjatë kësaj periudhe, ZKKK zyra ka qenë e angazhuar rreth zgjidhjes së problemeve të personave të riatdhesuar, familjet e kthyer dhe komunitetet, puna me organizata ndërkombëtare dhe joqeveritare dhe puna me institucionet e Kosovës.

Gjat kësaj perudhe raportuese është regjistruar 1 person i riatdhesuar nga Gjermania. Në zyrë janë lajmruar 4 familje të riatdhesuara nga Gjermania që kanë qëndruar më pak se një vit në Gjermani dhe që nuk i plotësojnë kriteret për dhënien e ndihmës në MPB, ne për familjet që janë në gjendje të keqe ekonomike kërkuam ndihmë nga organizata URA. Kemi pranuar 4 kërkesa për strehim të personave të riatdhesuar, lëndët i kemi përfunduar dhe i kemi dërguar për shqyrtim në Komisionin Komunal për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. Komisioni miratoi 3, refuzoi 1 kërkesë për akomodim. Janë përgatitur 3 vendime pozitive dhe 1 negative për strehim dhe janë nënshkruar 3 kontrata për strehimin e personave të riatdhesuar. Është përgatitur kërkesa për vazhdimin e akomodimit dhe është nënshkruar kontrata për vazhdimin e akomodimit për një azilkërkues nga Turqia.

Për personat e riatdhesuar janë dhënë 3 konfirmime.

Të dhënat për këta persona janë futur në bazën e të dhënave të MPB-së

Edhe gjatë vitit 2024 kemi vazhduar bashkpunimin me institucione vendore e ndërkombëtare si dhe me organizata vendore e ndërkombëtare: me MPB, MAPL, FSK, ROMACTED, UNHCR, GIZ, URA, IOM, UNDP, OSBE etj, ku në baza mujore kemi raportuar në detaje për të gjitha aktivitetet dhe punët tona në teren.

DREJTORATET KOMUNALE

DREJTORATI PËR ADMINISTRATË

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në Drejtoratin për Administratë janë realizuar detyra dhe obligime në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, statutit të Komunës së Lipjanit, ligjet tjera, Udhëzimet, Urdhëresat, si dhe Rregulloret tjera Komunale.

PUNËT DHEAKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Përgjatë kësaj periudhe, në bashkëpunim me menaxherët kemi bërë evidentimin e kontratave që skadojnë përgjatë këtij viti, e që janë të ndërlidhura me Administratën si dhe i kemi proceduar tutje për Planifikim të Prokurimit për vitin vijues, si dhe janë bërë planifikime shtesë të nevojshme për Drejtoratin e Administratës.

SEKTORI PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

Raporti për periudhën një vjeçar përmend aktivitetet dhe progresin e ndodhur në disa sektorë të Administratës. Përmendim disa nga aktivitetet kryesore kryesisht në sektorin e Administratës së Përgjithshme, Gjendjes Civile, Punëve të Kuvendit dhe Komiteteve, si dhe Mirëmbajtjes dhe Operimit të organizatës.

Gjatë vitit 2024, sektori i Administratës së Përgjithshme në Komunën e Lipjanit ka shënuar përparime të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe menaxhimin e detyrave institucionale. Ky raport paraqet arritjet kryesore, sfidat dhe rezultatet e arritura gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Në qendrën e shërbimeve për qytetarë, janë protokolluar mijëra kërkesa përmes sistemit të intranetit komunal.

Shërbimet postare, përgjigjet ndaj shkresave dhe arkivimi janë realizuar në mënyrë efikase, duke përfshirë edhe qytetarët nga diaspora.

Menaxhimi i Kontratave dhe Planifikimi i Prokurimit

Në bashkëpunim me menaxherët, janë evidentuar dhe menaxhuar kontratat që skadojnë gjatë vitit 2025.

Këto kontrata janë proceduar për planifikim të prokurimit për vitin vijues, duke përfshirë planifikime shtesë për Drejtoratin e Administratës.

Trajnime dhe takime lidhur me shërbimet komunale dhe procedurave administrative:

Gjat vitit 2024 janë mbajtur konsultime për përdorimin e platformës **E-Kosova**, duke ndihmuar qytetarët në regjistrime dhe shërbime civile. Përdorimi i kësaj platforme ka lehtësuar aplikimet për subvencione dhe regjistrime të tjera. Po ashtu janë organizuar konkurse për Drejtoratet e Shëndetësisë, Arsimit, Bujqësisë dhe shërbimet civile, të cilat janë protokolluar dhe publikuar në tabelën komunale.

Shërbimet e sigurimit fizik në objektet komunale janë zbatuar sipas kontratave në fuqi.

Raportet financiare janë përgatitur dhe harmonizuar me Thesarin dhe Drejtorinë e Financave, duke përfshirë edhe harmonizimin e pagave për punëtorët fizikë.

Raporti për inventarizimin e pasurisë jo-financiare është përgatitur dhe dorëzuar Kryetarit të Komunës.

Kemi mbajtur trajnime për përmirësimin e performancës komunale, si dhe për përdorimin e sistemit **HRMIS** dhe arkivimit.

Në bashkëpunim me organizatat si **GIZ** dhe **IKAP**, janë organizuar punëtori për reduktimin e barrës administrative.

Është hapur konkurs për 30 pozita praktikantësh me pagesë, të cilët kanë marrë trajnime profesionale në sektorë të ndryshëm.

Rritja e përdorimit të platformave elektronike për shërbime administrative dhe biznesore.

Zbatimi i masave për përsheptimin e shërbimeve komunale dhe reduktimin e barrës administrative.

Kemi bërë monitorimin e trendit të lëvizjes së migrimit pas hyrjes në fuqi të udhëtimit pa viza, është dorëzuar raporti zyrtar mbi lëvizjet migratore pas heqjes së vizave në Ministrinë e Pushtetit Lokal.

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ka dërguar njoftime lidhur me komisionin vlerësues për ndarjen e shfrytëzimit të tokave në komunën e Lipjanit. Procedurat e shpalljes dhe njoftimeve publike janë kryer në mënyrë të shpejtë dhe transparente.

Përdorimi i Platformave Elektronike për Shërbimet Biznesore dhe të Administratës ka përfunduar me vlerësimin e përdorimit të tyre për përfshirjen e shërbimeve për biznese dhe të tjera të ofruara nga Drejtoria e Administratës. Në kuadër të këtij vlerësimi, janë grumbulluar të dhënat nga platformat elektronike, të cilat janë paraqitur në mënyrë fizike dhe elektronike para komisionit.

Komisioni Rajonal Vlerësues për Projektin BFC ka konstatuar se përdorimi i platformave elektronike për shërbimet për biznese dhe të tjera të ofruara nga Drejtoria e Administratës ka bërë përparime të mëdha. Me përmirësime të mëtejshme dhe zbatimin e rekomandimeve të sugjeruara, këto platforma mund të ofrojnë një nivel edhe më të lartë të shërbimit dhe efikasitetit për përdoruesit.

Gjat vitit 2024, administrata e Komunës së Lipjanit ka qenë aktive në organizimin dhe pjesëmarrjen në një sërë trajnimesh dhe aktiviteteve trajnuese, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të stafit.

STATISTIKAT:

Nr.	Emërtimi i Llojit të Punës	Sasia
•	Protokollimi i kërkesave, ankesave si dhe aktet tjera te personave fizik dhe juridik, në Qendrën për Shërbime me Qytetarë	
1	Kërkesa të regjistruara nga personat fizikë dhe juridik	14776
2	Kërkesa për mbajtës familje dhe shtesa për fëmijë jashtë vendit	708
3	Kërkesat gjendjes civile të regjistruara në sistemin e intranetit	33166
•	Pranimi dhe Dërgimi i shkresave bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar të brendshëm zyrtarit të postes së institucionit.	0
4	Aktvendime të Shpërndara	525
5	Ftesa të Shpërndara	1582
6	Vendime të Shpërndara	322
7	Fletëparaqitje për Gjykatë	106
8	Njoftime të Shpërndara	439
9	Të Arritura me Postë	672
10	Të Dërguara me Postë	2081
11	Fatura tatimore të Qirasë	96
12	E veçantë për të raportuar harxhimet në të holla për dorëzim në postë janë 2,1058€	
	Gjithsej	54473

SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Në sektorin e Gjendjes Civile, të gjitha shërbimet janë realizuar në mënyrë transparente, dhe me korrektësi me shërbime të shpejta të cilat janë dhënë për qytetarët.

Respektivisht në udhëzim administrativ (MPB) Nr.01/2022 për dokumentet e gjendjes civile, për përdorim brenda vendit lëshohen në letër të bardhë standarde të formatit A4, ndërsa dokumentet e Gjendjes Civile për përdorim jashtë vendit lëshohen në letër të veçantë sipas specifikave të përcaktuara nga Agjencia e Regjistrimit Civil, ashtu siç janë lëshuar deri më tani. E-kiosku ka vazhduar të jetë në funksion për të lehtësuar qytetarët, duke siguruar lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2022. Ky sistem ka përmirësuar aksesin në shërbime, duke reduktuar radhët dhe vonesat. Si prioritet i punës kanë qenë shërbimet e kërkuar nga mërgimtarët.

STATISTIKAT:

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Ekstrakt i lindjes	31416
2	Certifikatë e martesës	6566
3	Certifikatë vdekje	2947
4	Certifikatë Vendbanimi	2929
5	Vërtetim nga arkiva	520

6	Certifikatë Shtetësie	487
7	Certifikatë e Statusit martesor	1598
8	Certifikatë të lindjes	15315
9	Certifikatë e Bashkësisë familjare	4898
10	Lindejt	513
11	Brenda vitit	5
12	Jasht vendit	197
13	Me vonesë	311
14	Brenda vendit	30
15	Jasht vendit	281
16	Martesa	555
17	E rregullt	457
18	Jasht vendit	98
19	Rishkrimi i martesave	353
20	Brenda vendit	336
21	Jasht vendit	17
22	Shkurorzimet	58
23	Me elemnt të huaj	116
24	Vdekje	264
25	E rregullt	172
26	Brenda vitit	148
27	Jasht vendit	24
28	Me vonesë	92
29	Brenda vendit	58
30	Jasht vendit	34
31	Rishkrim i qytetarëve të vdekur	84
32	Verifikime	147
33	Me numer personal	147
34	Rishikimi i lindjes	131
35	Me vendim të komisionit	16
36	Aktvendime nga lamia e gjendjes civile dhe akt vdekje	150
	Totali	69125

SEKTORI I KUVENDIT

Në sektorin për punë të kuvendit dhe komiteteve janë realizuar të gjitha punët në kuadër të planit dhe përgjegjësi.

Përmbledhje e shkurtër e punëve që janë kryer gjatë kësaj periudhe kohore në Sektorin për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve: përgaditja e materialit në mënyrë fizike, janë mbajtur procesverbalet dhe janë hartuar ekstrakte për 12 mbledhje të Kuvendit të Komunës, 11 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa, 12 mbledhje të Komitetit për Komunitete, 6 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si dhe për disa mbledhje të Komitetit për Arsim , Komitetit për Shëndetësi, Komitetit për Kulturë Rini e Sport. Për mbledhjet e sipërshënuara të Kuvendit i është dërguar materiali në mënyrë elektronike Kryetarit, Nënkrjetarëve, Drejtorëve, anëtarëve të kuvendit, sektorit të informimit si dhe në Ministrisë përkatëse etj. Po ashtu edhe vendimeve e rregulloreve të aprovuara.

Aktet juridike nënligjore të aprovuara në Kuvend fillimisht janë dërguar në Ministrin përkatëse për të vlerësuar ligjshmërinë e tyre mandej në publikim në ueb faqe e kështu me radhë për t’krijë plotfuqishmëri dhe zbatueshmëri të tyre.

Përveç kësaj gjatë këtij viti janë përkthyer dhe lektuar 60 vendime 5 rregullore, plane dhe strategji të aprovuara në Kuvend si dhe shumë materiale tjera të ndryshme. Janë bërë edhe shumë orë përkthim simulantë e gojor.

STATISTIKAT:

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Mbajtja e procesverbalit nga mbledhjet e KK	12	178 faqe
2.	Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e KK	12	173 faqe
3.	Nxjerrja e Vendimeve dhe akteve të tjera nga mbledhjet e Kuvendit	54	189 faqe
4.	Përkthimi i Ekstrakteve	35	152 faqe
5.	Përkthime zyrtare-simultane në organe të ndryshme	241	329 orë
6.	Përkthimi i dokumenteve të ndryshme të Drejtorateve	279	1150 faqe
7.	Përkthimi i shkresave të tjera	299	271 faqe
8.	Fotokopjimi	1170	45000 faqe

9.	Mbajtja e Procesverbalit nga mbledhjet e KPF-së	10	48 faqe
10.	Nxjerrja e Ekstrakteve nga mbledhjet e KPF-së	10	40 faqe
11.	Mbajtja e procesverbalit dhe Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e komiteteve tjera dhe komisioneve të ndryshme	29	140 faqe
12.	Mbajtja e procesverbalit dhe nxjerrja e ekstraktit nga mbledhja e KKS B	6	15 faqe
13.	Përgaditja e ftesave të ndryshme për mbledhje dhe tubime të ndryshme.	87	550 faqe
14.	Përgaditja e rehistrave të ndryshëm (për meditet e anëtarve të Kuvendit dhe komiteteve e të ngjajshme).	80	165 faqe
15.	Të ndryshme(dërgimi i dokumenteve për veb faqe,dokumente të skenuara në MAPL etj. të ngjajshme)	510	830 faqe
16.	Rregullore,Plan, Korniza e të ngjajshme-	2	183 faqe
17.	Lektorim të materialeve të ndryshme (rregullore, vendime ekstrakte,raporte,ftesa etj. të ngjajshme)	199	623 faqe
19.	Gjithsejt	3008	50502 faqe
			Përveq kësaj që pasqyrohet me faqe janë edhe 329 orë përkthim gojor

SEKTORIN PËR MIRËMBAJTJE DHE OPERIM

Në sektorin për mirëmbajtje dhe operim të gjitha punët janë kryer sipas obligimeve që kemi, deri te mirëmbajtja dhe sigurimi i veturave dhe gjendjen e tyre e vazhdueshme teknike, si dhe kontrollimi i karburanteve të shpenzuara. Të gjitha veturat janë të pajisura me pjesë kontrolluese.

STATISTIKAT PARCIALE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Furnizim me lëndë djegëse - karburant për gjenerator dhe mesatarja e harxhimeve	2	403.97 litra.
2	Furnizim me lëndë djegëse – karburant për automjete	173	15968.42 litra karburante
3	Evidentimi i kilometrave të kaluara të automjeteve dhe mesatarja e shpenzimeve	173	185608 km mes; 8.60 lit/100 km
4	Mirëmbajtja e parkut – kositja e barit	4	
5	Mirëmbajtja e higjienës në sipërfaqe	/	3200m2
6	Ndërrimi – meremetimi i dorëzave për dyer të drurit	19	
7	Servisimi i automjeteve	25	
8	Bartja e zyrtarve komunal ne trajnime-Prishtine me Kombi	1062	
9	Vazhdimi i regjistrimit të autojemjeteve	17	
10	Kerkesa per vetura zyrtare	1985	
11	Gjithsejt	3460	

NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZINË GJINORE

Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore kanë realizuar aktivitete të ndryshme dhe po ashtu ka qenë pjesë e debateve, takimev, tryezave dhe trajnimeve të organizuara nga institucione vendore dhe organizata ndërkombëtare.

Më posht lanë listuar në mënyrë kronologjike punët dhe aktivitetet e kësaj njësie:

- **Me Komisionin Komunal për Riintegrim** Është organizuar takim për shqyrtimin e dy lëndëve (kërkesave) që kanë nevojë për akomodim dhe strehim.
- **Tryezë pune e Grupit Punues për Hartimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore në Komunën e Lipjanit 2024-2026** Ky projekt mbështetet nga UN Women në Kosovë, në kuadër të projektit “Gender Equality Facility” që po zbatohet në Kosovë.
- **Takim i Grupit Punues për Hartimin e Rregullores së Brendshme të Shkollave Fillore** Takimi kishte si fokus luftimin e gjuhës së urrejtjes përmes rishikimit dhe hartimit të rregulloreve për shkollat fillore në Komunën e Lipjanit.
- **Takimi i Dytë për Hartimin e Planit Komunal për Barazinë Gjinore 2024-2026** Gjatë këtij takimi, është prezantuar drafti i parë i këtij plani, i cili mbështetet nga UN Women në Kosovë, në kuadër të projektit “Gender Equality Facility”.
- **Punëtori Treditore mbi Zbatimin e Gjuhëve Zyrtare në Ndërmarrjet Publike të Administratës së Komunës së Lipjanit** Punëtorja kishte për qëllim hulumtimin e mënyrës së komunikimit publik nëpërmjet shkrimeve zyrtare në institucionet publike dhe përmirësimin e komunikimit me qytetarët. Ky projekt financohet nga Zyra dhe Komisionari për Gjuhët në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Aktivitete dhe Takime të Realizuara

- **Punëtori Treditore për Zhvillimin e Planit të Mitigimit për Pasojat e COVID-19** Më 5, 6 dhe 7 mars, është zhvilluar një punëtori për hartimin e Planit të Mitigimit për pasojat e COVID-19 dhe ndërlidhjen me barazinë gjinore. Ky trajnim u mbështet nga Kosova Women4Women, me financim dhe ekspertizë nga lektorë të fushës.
- **Debat Publik me Qytetarët** Më 7 mars, u organizua një debat publik me qytetarët për të marrë komentet dhe sugjerimet e tyre lidhur me hartimin e Planit Komunal për Barazi Gjinore 2024-2026.
- **Diskutime për Hartimin e Statutit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Lipjan** U zhvillua debat me qytetarët për të diskutuar dhe hartuar statutin e ri të Qendrës së Mjekësisë Familjare.
- **Debat për Hartimin e Planit të Këshillit Komunal Kundër Dhunës në Familje** U mbajtën takime për hartimin e planit komunal kundër dhunës në familje dhe për barazi gjinore për periudhën 2024-2026.
- **Takim Pune me Komisionin për Planin Komunal për Zhvillimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.** Ky takim kishte si qëllim hartimin e Planit Komunal për vitet 2024-2026 dhe përfshirjen e komuniteteve në aktivitetet zhvillimore të komunës.
- **Konsultim me Agjencinë për Barazi Gjinore** Kemi zhvilluar takim pune me konsulenten Ardiana Gashi, për plotësimin e aktiviteteve të realizuara nga zyrtarët komunalë për barazi gjinore gjatë vitit 2023.
- **Takim me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Dhunës Seksuale** U organizua një takim me përfaqësues të institucioneve për të diskutuar dhe informuar mbi gjendjen aktuale të të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Takimi kishte për qëllim identifikimin dhe referimin e të mbijetuarave në mbështetje institucionale.
- **Hartimi i Draft Planit për Persona me Aftësi të Kufizuara** Takim për hartimin e Draft Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara për Komunën e Lipjanit 2024-2027, i cili u realizua nga Shoqata Down Syndrome në Ferizaj.
- **Sesion Informues për Trashëgiminë në Pronë** Në bashkëpunim me OJQ-në lokale “Ideas Partnership”, u organizua një sesion në Janjevë, ku gratë nga komuniteti u informuan dhe u inkurajuan për të ushtruar të drejtën e tyre mbi trashëgiminë pronësore.

STATISTIKAT:

Trajnime	Takime	Debate	Tryezë e rrumbullakët	Të ndryshme
26	19	3	2	Këshilla dhe sugjerime me palë në zyre 159

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale gjatë vitit 2024 është fokusuar në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit për Kujdes Parësor Shëndetësor 2020-2024, Strategjinë dhe Planin Veprimit për Përfshirjen Sociale 2022-2024, Planin e Punës së DHSPS-së për vitin 2024 si dhe Planin e Punës së QPS-së për vitin 2024.

Objektiv i përgjithshëm i shëndetësisë gjatë këtij viti ka qenë vendosja e pacientit dhe komunitetit në fokus duke ofruar shërbime cilësore përmes përmirësimit të qasjes në shërbime, modernizimit të proceseve, përmirësimin e ambientit të punës brenda institucioneve shëndetësore, modernizimin e teknologjisë si dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore të personelit shëndetësor.

Gjatë kësaj periudhe kemi avancuar dukshëm duke adresuar në tërësi objektivin strategjik krijimi i kushteve infrastrukturore për implementim të plotë të mjekësisë familjare. Këto përmirësime të dukshme infrastrukturore kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në organizimin më të mirë të punës, përmirësimin e kushteve për mjekët dhe infermierët si dhe krijimin e mundësive për ofrim të shërbimeve më kualitative mjekësore.

Përmirësimi i kushteve, fuqizimi i stafit infermior dhe mjekëve familjar është duke dhënë rezultat të mirë. Në QKMF ordinancat e mjekëve familjar janë duke funksionuar mirë. Stafi infermior është i kyçur drejtpërdrejtë në shërbim. Ndarja e detyrave të

stafit infermieror dhe bashkëpunimi i duhur në mes të infermierëve dhe mjekëve familjar gjatë ofrimit të shërbimit është duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Planifikimi i hershëm për fuqizimin dhe përmirësimin e shërbimeve të urgjencës ka dhënë rezultate të mira. Shërbimi i urgjencës është plotësuar me numër të nevojshëm të mjekëve dhe infermierëve. Kushtet e punës janë përmirësuar në këtë shërbim. Urgjenca është e furnizuar me aparatura dhe pajisje të reja mjekësore si dhe autovetura të mirëmbajtura mirë dhe të gatshme për intervenim për shërbime akute dhe urgjente. Infermierët e propozuar nga shërbimi i urgjencës janë licencuar për ngasje të shpejtë, dhe tani janë duke ndikuar në ofrimin e shërbimeve të shpejta dhe më cilësore.

Kjo periudhë raportuese ka qenë shumë e sukseshme në realizimin e planit të vaksinimit si dhe vaksinimin e vajzave të klasave të gjashta kundër virusit Human Papiloma (HPV). Komuna e Lipjanit është ndër top komunitat me përqindjen e realizimit të imunizimit.

Gjatë kësaj periudhe, kemi avancuar dukshëm me shërbimet laboratorike duke arritur të sigurojmë qëndrueshmëri në ofrimin e 43 testeve/analizave laboratorike për pacientët e Komunës së Lipjanit dhe atyre që marrin shërbime në institucionet tona shëndetësore duke përfshirë edhe analizat HbA1c/Hemoglobina e Glikogjenizuar, AST, ALT dhe ASTO. Jemi ndër komunitat e pakta që ofrojmë numër kaq të lartë të analizave.

Shërbimi i integruar për personat e prekur me sëmundjet kronike jo ngjitëse si Diabet, Hipertension dhe Astma është duke funksionuar mirë. Nga 31.12.2023, përkrahja direkte e AQH për këtë projekt ka përfunduar. Në këtë vit ne kemi ofruar këtë shërbim të pavarur. Gjatë kësaj periudhe sa jemi të pavarur, ne kemi arritur progres të theksuar. Këshillimorja për pacientët 65+ të prekur nga sëmundjet jo ngjitëse kronike është zhvendosur në një ambient të mirë dhe të përshtatshëm. Më tutje, nga dy infermier sa kanë qenë në këshillimore, numri i infermierëve është rritur në katër infermier, të cilët janë drejtpërdrejtë në shërbim të pacientëve me sëmundje kronike.

Te shërbimet e integruara, duhet të fuqizojmë pjesën e shërbimit social si pjesë integruese e këtij shërbimi duke siguruar zyrtar të mjaftueshëm dhe të disponueshëm për kryerjen e vlerësimeve në terren së bashku me personelin shëndetësor.

Marrë parasysh se kemi arritur të përmirësojmë kushtet e punës në sektorin e Stomatologjisë duke furnizuar këtë sektor me katër karrige të reja stomatologjike, dhjetë sterilizator, dy autoclav, material stomatologjik dhe pajisje e instrumente të mjaftueshme stomatologjike, numri i pacientëve të cilët marrin shërbime duhet të rritet.

Vazhdimi i aplikimit të qasjes strategjike më ndryshe dhe pragmatike në vitin 2024, hartimi i një plani të veprimit si dhe hartimi i një plani të punës të thjeshtë, të matshëm dhe të realizueshëm brenda një viti kalendarik kanë rezultuar të suksesshme dhe kanë ndikuar drejtpërdrejtë në:

- Ofrimin e shërbimeve të mamografisë për të gjitha gratë e interesuara mi moshën 40 vjeçare si dhe eliminimin e tërësishëm të kohës së pritjes në shërbimin e radiologjisë diagnostike,
- Ofrimin e shërbimeve të paliativit 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë,
- Realizimin e planit të vaksinimit me sukses si dhe vaksinimin e vajzave të klasave të gjashta kundër virusit Human Papiloma (HPV).
- Avancimin e mëbtutjeshëm të shërbimeve shëndetësore në kuadër të mjekësisë familjare,
- Avancimin e shërbimeve laboratorike duke bërë rritjen e numrit të analizave të ofruara në gjithsej 43 parametra dhe shkurtimin e kohës për ofrim të analizave,
- Rritjen e numrit të shërbimeve stomatologjike dhe rritjen e sigurisë gjatë ofrimit të shërbimeve,
- Rritjen e shërbimeve dhe vizitave për nënat në sektorin e maternitetit dhe gjinekologjisë dhe
- Avancimin dhe përmirësimin e kushteve të punës për personelin shëndetësor të angazhuar në ofrim të shërbimeve në institucionet shëndetësore në Lipjan.

Shërbimet në Sektorin e Gjinekologjisë dhe Maternitetit janë rritur. Blerja e tavolinës gjinekologjike ka ndikuar në cilësinë e shërbimeve. Kemi punuar në fuqizimin e tri programeve në maternitet: Kujdesi për Nënën, Kujdesi në Grup në 1000 Ditët e Para dhe programit Vizitat Shtëpiake dhe Ligjerata për Shëndetin dhe Mirëqenien e Nënave dhe Fëmijëve nga mosha 0 deri në 3 vjet.

Duke marrë për bazë se preventiva, edukimi dhe identifikimi i hershëm sëmundjeve zvogëlon rrezikun për sëmundje, paaftësi dhe vdekje, gjatë këtij viti kemi intensifikuar aktivitetet tona në zvogëlimin e sëmundshmërisë përmes promovimit dhe edukimit shëndetësor të popullatës. Janë mbajtur shumë fushata vetëdijësuese. Në vitin 2024, për herë të parë, kemi planifikuar buxhet dhe kemi organizuar aktivitetet e promovimit dhe edukimit shëndetësor të pavarur nga AQH.

Në mënyrë që stafi menaxherial dhe mjekësor të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore kemi fuqizuar mekanizmat e mbikëqyrjes mbështetëse dhe menaxhimit të cilësisë, jemi angazhuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, janë marrë masat për parandalim të infeksioneve dhe janë zbatuar nga gjithë profesionistët shëndetësor.

Kemi punuar ngushtë me Qendrën për Punë Sociale (QPS-në) me qëllim të identifikimit të vështirësive, sfidave dhe avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve sociale.

Aktivitetet e planifikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për Përfshirjen Sociale 2022-2024 të aprovuar nga Kuvendi Komunal janë duke u implementuar.

Kemi përmirësuar kushtet logjistike, të transportit dhe kushtet e punës për punëtorët e Qendrës për Punë Sociale. Po ashtu, nga Zyra e EU është implementuar projekti për ndërtimin e ashensorit dhe tualeteve.

Gjendja në Shtëpinë me Bazë në Komunitet në vitin 2024, duke përfshirë edhe shëndetin e rezidentëve, në përgjithësi ka qenë e mirë. Është bërë avancim i mëtutjeshëm i kushteve për pacient dhe punëtorët e Shtëpisë me Bazë në Komunitet duke siguruar kujdes, higjienë, mirëmbajtje dhe ushqim të mirë për pacientët si dhe kushte të mira për stafin.

Punimet në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit kanë vazhduar.

Stomatologjia është duke funksionuar në objektin e maternitetit ndërsa rëntgeni në katin e dytë të objektit kryesor të QKMF-së.

Punët dhe aktivitetet e realizuara në vitin 2024

Me qëllim të përgatitjes për projektin e Zonimit dhe implementimit të plotë të mjekësisë familjare, gjatë kësaj periudhe kohore është vazhduar të punohet në fuqizimin e mjekut dhe infermierit me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore për pacientin. Kemi marrë hapa konkret duke riorganizuar ordinancat. Secila ordinacë është e përbërë nga dy dhoma, njëra për mjekun e tjetra për dy infermier. Kartelat e pacientëve janë bartur në secilën ordinancë dhe secili pacient regjistrohet te mjeku i tij/saj familjar.

Futja në funksion e rëntgenit të ri në QKMF ka bërë diferencën në ofrimin e shërbimeve. Përveç eliminimit të kohës së pritjes për marrje të shërbimeve të rëntgenit, është përmirësuar ndjeshëm edhe kualiteti i shërbimeve imazherike.

Shërbimi i paliativit është zgjeruar me staf dhe është zgjatur orari i këtij shërbimi duke kaluar në tri ndërrime, 24 orë dhe 7 ditë në javë.

Është zhvilluar kampanja informuese për përzgjedhjen e mjekut familjar e udhëhequr nga MSh. Qytetarët e komunës së Lipjanit janë informuar se si mund të aplikojnë në e-Kosova për përzgjedhjen e mjekut të tyre familjar dhe në të njëjtën kohë, qytetarët kanë aplikuar për përzgjedhjen e mjekut të tyre familjar.

Dhoma për promovim dhe edukim shëndetësor është zgjeruar dhe është plotësuar me staf. Tani janë të caktuar katër infermiere për të ofruar shërbimet e kujdesit të integruar për pacientët geriatrik 65+ me sëmundje kronike jo ngjitëse si diabeti, hipertension, astma etj.

Është kryer me sukses fushata e vaksinimit me HPV vaksinën për klasat e gjashta për nxënëset e gjinisë femërore dhe është realizuar vaksinimi. Sipas raportit të pranuar nga QKMF, respektivisht nga sektori i vaksinimit, është shënuar një sukses i lartë dhe koordinimi me Drejtorinë e Arsimit dhe shkollat ka qenë i mirë.

Ashensorët e montuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në QPS në Lipjan janë duke pasur ndikim të madh tek personat me aftësi të kufizuara ngase ju kanë ofruar qasje të lirë në marrje të shërbimeve shëndetësore.

Kujdes i veçantë i është kushtuar higjienës në ambientet e institucioneve shëndetësore në Komunën e Lipjanit me qëllim të ofrimit të sigurisë për pacientin dhe personelin shëndetësor. Si rezultat, është shënuar avancim i dukshëm në mirëmbajtjen dhe pastërtinë brenda ambienteve të QKMF-së. Është monitoruar furnizimi i ordinancave me material dezinfektues dhe higjienik si dhe pajisja e secilës ordinancë dhe sallës me çarçaf të ri.

Avancimi i shërbimeve të cekura më lartë në përmbledhje, por jo vetëm, është bërë duke zgjeruar komunikimin me personelin mjekësor, komunikimin në mes të personelit shëndetësor dhe pacientit si dhe anasjelltas. Në këtë drejtim, na ka ndihmuar shumë këshilli i pacientëve i cili është duke bërë punën e tij në nivel.

Në fushën e sigurisë shëndetësore, si komponentë e menaxhimit kualitativ të shërbimeve mjekësore, është duke u bërë avancim dhe jemi duke e përcjellur për së afërmi këtë proces. Përmirësimi i kushteve të punës për stafin mjekësorë dhe për pacientin si dhe ofrimi i shërbimeve adekuate është trajtuar me kujdes. Për së afërmi është monitoruar furnizimi i ordinancave me material dezinfektues dhe higjienik si dhe pajisja e secilës ordinancë dhe sallë me carcaf të ri. Kujdes i veçantë i është kushtuar higjienës në ambientet e institucioneve shëndetësore në Komunën e Lipjanit me qëllim të ofrimit të sigurisë për pacientin dhe personelin shëndetësor. Si rezultat, është shënuar avancim i dukshëm në mirëmbajtjen dhe pastërtinë brenda ambienteve të QKMF-së.

Furnizimi me material mjekësor dhe laboratorik është kryer me rregull dhe me sukses, sipas kërkesave nga shefat e sektorëve, mirëpo furnizimi me barna dhe material mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë nuk është bërë në tërësi. Furnizimi me insulinë kryesisht ka qenë i kënaqshëm ndërsa furnizimi me barna për hipertension nuk është bërë me rregull nga depo qendrore e Ministrisë së Shëndetësisë, ka pasur mungesë për periudha të gjata kohore dhe kemi hasur në probleme të mëdha.

Bashkëpunimi me AQH-në rreth implementimit të planeve dhe projekteve për insitucionet shëndetësore në Komunën e Lipjanit ka qenë i shkëlqyeshëm.

Siç kemi bërë viteve të fundit, në majin Qershor dhe muajin Nëntor kemi bërë përgatitjet për rritjen e kapaciteteve dhe riorganizimin e punës në QKMF me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe përballje me rritjen e numrit të pacientëve si pasojë e rritjes së temperaturave dhe ardhjes së bashkëatdhetarëve nga diaspora gjatë muajve Korrik, Gusht, Dhjetor dhe Janar. Më tutje, kemi marrë vendim për ngritjen e kapaciteteve të urgjencës duke dërguar mjek dhe infermier shtesë me qëllim të mbajtjes së urgjencës në funksion dhe gatishmëri të plotë për intervenim gjatë këtyre muajve të cilët janë zoakonisht të ngarkuar.

Jemi përgatitur për të menaxhuar ikjen e mjekëve nga vendi dhe ose kalimi i tyre në biznes privat. Kemi zhvilluar me kohë procedurat e rekrutimit.

Në kuadër të riorganizimit, me qëllim të evitimit të trafikut të ngarkuar brenda në QKMF, barnatorja është zhvendosur në katin përdhësë dhe shërbimi do të ofrohet nga hyrja e veçantë.

UNICEF, përmes angazhimit të OJQ-ve lokale me bazë në komunitet, ka përkrahur sektorin e vaksinimit përmes projektit të imunizimit të fëmijëve nga komuniteti jo shumicë. QKMF, respektivisht njësia për imunizim, është duke ofruar shërbime profesionale dhe duke bërë vaksinimin e të pa vaksinuarve.

Kuvendi Komunal ka aprovuar Planin e Punës për të Drejtat e Fëmijës 2024-2026 përmes të cilit Komuna e Lipjanit ka për qëllim promovimin e të drejtave dhe mirëqenies së çdo fëmije. Ky plan do të ofrojë mundësi për të analizuar politikat ekzistuese, pasqyrimin socio-ekonomik dhe financiar për çështjet e fëmijëve, identifikoj nxitësit kryesorë të pabarazive dhe sfidat kryesore për të përmbushur të drejtat e fëmijëve dhe ofron rekomandime për zhvillimin e politikave adekuate. Komuna e Lipjanit është e

angazhuar që të kontribuojë më tej në informimin dhe rritjen e llogaridhënies si dhe reagimit të institucioneve lokale ndaj të drejtave të fëmijëve dhe grave.

Në këtë periudhë raportuese kemi përkrahur projektin kujdesi për nënat e reja dhe fëmijët deri në moshën tre vjeqare. Do të vazhdojmë me përkrahjen. Kemi siguruar një veturë për kryerjen e vizitave në terren. Shërbimi i vizitave në shtëpi për nënat dhe fëmijët deri në moshën 3 vjeqare në Sektorin e Gjinekologjisë dhe Maternitetit është duke vazhduar dhe ka në avancim të theksuar. Janë rregulluar proceset brenda këtij shërbimi duke filluar me planifikimin e vizitave, referimin, administrimin dhe ndarjen e detyrave, realizimin e vizitave dhe monitorimin e raportimin e vizitave të realizuara.

Projektet kapitale të realizuara dhe në proces janë si vijon:

- Renovimi i infrastrukturës së jashtme në QMF Gadime dhe krijimi i parkingjeve të reja ka përfunduar dhe QMF është lëshaur në përdorim.
- Renovimi i QMF në Janjevë ka përfunduar dhe QMF është lëshaur në përdorim.
- Renovimi i AMF në Babush ka përfunduar dhe AMF është lëshaur në përdorim.
- Punët në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit kanë vazhduar sipas planit dinamik të projektit.

Është shënuar dita botërore kundër TB me 24.03.2024 përmes organizimit të aktiviteteve në sheshin Adem Jashari dhe organizimit të ligjëratave në QKMF-Lipjan.

Kemi ndërmarrë hapa konkret për fuqizim të shërbimit të urgjencës dhe përgatitjen për sezonin e verës, e cila shoqërohet me ndryshim të temperaturave. Shërbimi i Urgjencës ka burime të mjaftueshme njerëzore, kushte të mira logjistike dhe barna e material medicinal të mjaftueshëm për intervenime të shpejta akute dhe urgjente. Automjetet kanë qenë në gjendje të rregullt në sigurimin e ofrimit të shërbimit dhe servisimet janë kryer me kohë.

Është shtuar kontrolli i brendshëm dhe është hartuar Pani i Veprimit në të cilin specifikohet se menaxherët e kontratave do të kujdesen që faturat e operatorëve ekonomik të mos pranohen para se të lëshohet urdhërblerja. Kjo është komunikuar te menagjerët e kontratave aktuale. Më tutje, hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallrave dhe shërbimeve apo punëve, dhe pastaj pranohet fatura do të komunikohen nga autorizuesi i programit për çdo menaxher të ri të kontratës.

DSHPS është angazhuar në sigurimin e një planifikim të mirëfilltë si dhe monitorimin dhe zbatimin e projekteve kapitale me qëllim të realizimit sipas paramasës dhe planit dinamik të përcaktuar me kontratë. Po ashtu, është kërkuar nga secili menaxher menjëherë mbas njoftimit për emërim si menaxher i kontratës të bëjë planifikimin e menaxhimit të kontratave duke përcaktuar fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Më tutje, është siç është siguruar që menaxherët e kontratave të azhurnojnë dhe bëjnë vlerësimin e performancës së kontratave në modulën e menaxhimit të kontratave publike në platformën e- Prokurimi.

Është bërë shënimi i ditës botërore të zemrës në sheshin Adem Jashari. Ky aktivitet ka pasur ndikim të mirë në ndërgjegjësimin e pacienteve për shëndetin e zemrës dhe edukimin e pacienteve për stilin e shëndetshëm të jetesës, ndalimin e duhanit, shtimin e aktiviteteve fizike, dietën e shëndetshme, etj.

Është bërë organizimi i fushatave për ndërgjegjësimin mbi diabetin dhe hipertensionin, me pjesëmarrjen e rreth 650 personave.

Janë organizuar ekskursione ku kanë marrë pjesë 50 persona me semundje kronike jo ngjitëse 65+ vjeç. Në këto ekskursione, përveç aktiviteteve rekreative për të moshuar, janë ofruar ligjerata mbi menaxhimin e semundjeve kronike, ecje dhe ushtrime të lehta fizike.

Janë organizuar dy karvane „Për ShëndetJe” për shenimin e ditëve botërore të shëndetit ku kanë marrë pjesë afër 600 persona. Këto karavane janë organizuar me mbështetje të AQH-së, këshillit të pacientëve, QKMF-së dhe Komunës së Lipjanit.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF

Misioni i kujdesit Primar Shëndetësor është t'i ofroj komunitetit shërbime shëndetësore cilësore të qasshme dhe gjithëpërfshirës pa dallim gjinie, race, përkatësie etnike, feje apo bindje. Stafi i KPSH do të i përgjigjet nevojave të komunitetit bazuar në konceptin e Mjekësisë Familjare, kryesisht përmes parandalimit, promovimit, trajtimit të pacientëve të sëmurë dhe kujdesit paliativ.

Me 06 Mars 2024 në QKMF kemi pritur në vizitë Z. Lukas Rüttimann, Menaxher i Programit të SDC për Kosovën nga Bern, së bashku me ekipin e SDC-së në Kosovë dhe përfaqësuesit e AQH-së. Gjatë vizitës, së bashku me AQH-në prezantuar progresin e arritur në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët, si dhe identifikuar fushat që kanë nevojë për përmirësim në të ardhmen. Komuna e Lipjanit dhe QKMF "Mehdi Zejnullahu" përmes projektit AQH, i financuar nga SDC dhe i zbatuar nga Sëiss TPH, përmes bashkëpunimeve të tilla synon të përmirësojë edhe më tutje qasjen dhe cilësinë e shërbimeve për të gjithë qytetarët e Komunës së Lipjanit.

Në QKMF janë zhvilluar ligjërata për edukimin e vazhdueshëm profesional. Këto ligjërata janë të rëndësishme për profesionistët të cilët dëshirojnë të përditësohen me njohuritë e fundit në fushën e tyre.

Më 06.06.2024 me përkrahje të AQH-së në Parkun e Blinajës është zhvilluar aktivitet rekreativ dhe ushtrime të lehta fizike me pacientet e moshave 65+ vjeç të prekur me sëmundje kronike jo ngjitëse.

Statistika kryesore të QKMF-së

Vizita dhe Shërbime:

- Numri i pacientëve të trajtuar gjatë këtij viti ka qenë 299849.
- Numri i vizitave të shërbimeve ambulatorie ka qenë 248035.
- Rastet e referuara në spitale terciare kanë qenë 20521, apo shprehur në përqindje 8.27%.

Shërbimet parandaluese të ofruara:

- Numri i vaksinimeve ka qenë 11393.

Numri i shërbime shëndetësore të integruara, për sëmundje kronike te pacientet 65+ vjeç ka qenë 1286.

Gjithsej kanë qenë 547884 vizita mjekësore dhe shërbime shëndetësore në QKMF, QMF dhe AMF gjatë vitit Janar-Dhjetor- 2024.

Burimet njerëzore

Gjatë vitit 2024 janë rekrutuar dhe pranuar në punë 9 mjekë të përgjithëshem, një farmacist/e, 2 stomatolog/e, 5 Infermier/e dhe 2 laborant/e mjekësor.

Bazuar në evidencat shefave të sektorve, 85% e stafit ka marr pjesë në trajnime profesionale dhe konferenca mjekësore. Gjashtë specialistë të Mjekësisë Familjare janë trajnuar në aplikimin e Ekografisë së abdomenit dhe gjëndrrës tiroide. Tre mjekë janë përkrahur në specializimin e Mjekësisë Familjare, Dy mjekë në Pediatri si dhe një është aktualisht në vitin e fundit të specializimit në Pediatri. Dy Mjekë në Biokimi Klinike, njëri tani më e ka përfunduar specializimin.

Departamenti i Mjekësisë Familjare

Puna me mjekë ka qenë e organizuar mirë si dhe është bërë mbulimi i punkteve përveç AMF-Smallushë dhe AMF-Banullë që nuk kanë punuar, të cilat janë jashtë funksionit si pasojë e numrit të vogël të pacientëve.

Në mbështetje të avancimit të mëtutjeshëm të cilësisë së shërbimeve mjekësore dhe rritjes së saktësisë, është adresuar objektivi specifik 1. Deri në vitin 2024 e gjithë infrastruktura dhe pajisjet mjekësore në IKPSH e kompletuar për të ofruar shërbime shëndetësore të qasshme dhe cilësore, pajisje dhe aparatura të mjaftueshme mjekësore, si dhe nën-objektivi 1. i. Blerja e aparaturave mjekësore nga Plani i Punës për vitin 2024. Në kuadër të kësaj, sektori i Laboratorit, Stomatologjisë, Gjinekologjisë, Urgjencës, Radiologjisë dhe sektorët tjerë janë furnizuar me aparatura dhe pajisje të reja shëndetësore të cilat kanë ndikuar në rritjen e numrit të shërbimeve të ofruara, saktësi dhe shkurtime të kohës së pritjes.

Higjiena dhe mirëmbajtja në institucione shëndetësore ka arritur në nivelin e duhur. Me synim që të avancojmë shërbimet e mirëmbajtjes dhe higjienës në QKMF dhe institucionet tjera shëndetësore në Komunën e Lipjanit, në këtë periudhë kohore për të cilën po raportojmë kemi adresuar nën objektivin 1.b. Përmirësimi i ambienteve të punës dhe përmirësimi i higjienës në ambientet e QKMF-së. Kemi kryer inspekte te rregullta ne ambientet në QKMF. Jemi takuar me menaxhmentin e QKMF-së dhe kemi diskutuar standardet dhe kërkesat e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale rreth higjienës dhe mirëmbajtjes. Në takime po ashtu kemi diskutuar, nevojat, vështirësitë dhe sfidat të cilat burojnë për shkak të numrit të madh të pacientëve të cilët frekuentojnë ambientet shëndetësore.

Me qëllim të organizimit më të mirë të punës dhe shërbimeve mjekësore, jemi fokusuar në implementimin e nën objektivit 1.c. Implementimi i SISH-it dhe kartelës elektronike të pacientit. Edhe përkundër problemeve teknike si rënia e kohëpaskohshme e serverit të SISH-it në Ministrinë e Shëndetësisë dhe rrjetit, është shënuar një rritje e lehtë në përdorimin e Sistemit Informativ Shëndetësor SISH.

Përkrahja nga AQH në këtë viti ka qenë e shkëlqyeshme dhe është shtrirë në disa fusha si: Kujdesi i integruar, menaxhimi cilësor i shërbimeve, komunikimi me pacient, investime kapitale, formimi i këshillit të pacienteve, etj. Po ashtu, me AQH-në kemi mbajtur takime për zbatimin e projektit Qendrat Demonstruese në QKMF, QMF-Gadime dhe AMF-Kraishtë.

Sektori i Infermierisë

Në sektorin e infermierisë është arritur koordinim i mirë në organizimin dhe shpërndarjen e punëve, si në kryerjen e raportimeve me kohë, planifikimin dhe shfrytëzimin e pushimeve pa penguar procesin e punës. Po ashtu, janë organizuar planifikim i trajnimeve të stafit dhe shënim i ditëve të caktuara në shëndetësi.

Shërbimi i Urgjencës

Shërbimi i urgjencës në QKMF ofron shërbime 24 orë në ditë dhe është duke vazhduar të përmirësohet dukshëm. Ky shërbim është fuqizuar shumë me resurse njerëzore dhe tani stafi i Urgjencës përbëhet nga 9 mjek dhe 16 Teknik/Infermiere si dhe njësia e transportit me nga 1 vozitës për çdo ndërrim (4 ndërrime), me pajisje dhe automjete për intervenim të shpejtë.

Është implementuar Objektivi 1. i Planit të punës për vitin 2024 Fuqizimi dhe përmirësimi i shërbimeve të urgjencës, nën-objektivi 1.e) Respektimi i orarit të punës përmes implementimit të sistemit të monitorimit 1.g) Caktimi i personave përgjegjës në secilin ndërrim për përgatitjen e autoambulancave për ekipet e intervenimit dhe 1.i) Prokurimi i një autoambulance për ndërhyrje të shpejta.

Planifikimi dhe mobilizimi me kohë për përballim të numrit të madh të pacientëve gjatë ardhjes në pushim të mërgimtareve në sezonin e verës dhe gjatë festave të fund vitit ka dhënë rezultate të mira. Kjo qasje ka rezultuar e suksesshme.

Sektori i Laboratorit

Disponojmë aparatura të mira dhe plotësojmë kriteret nga UA 04/2020 për KPSH. Shërbimi i Laboratorit ka filluar të ofroj 43 analiza, siç specifikohet me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet administrative për kujdesin parësor shëndetësor UA 04/2020. Për të krijuar këtë mundësi, laboratorit është pajisur me aparaturat e nevojshme shëndetësore bashkëkohore si: aparat biokimik, numërues hematologjik, mikroskop, dhe aparatura tjera për nevojat e këtij shërbimi si ne QKMF ashtu edhe ne punkte. Kjo aparaturë e mirë tani ka mundësuar ofrimin e analizës HbA1c/Hemoglobina e glikogjenizuar.

Sektori i Radiologjisë Diagnostike

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare është pajisur me një Mamograf të ri digjital i cili është siguruar si donacion. Stafi i radiologjisë është trajnuar për përdorimin e mamografit të ri dhe i njëjti është lëshuar në funksion.

Kemi bërë të gjitha përgatitjet për Ndërgjegjësimin për Kancerin e Gjirit për muajin tetor 2024. Janë përfshirë të gjithë akterët relevant dhe është hartuar lista me aktivitete.

Duke filluar nga muaji tetor, pasi që është siguruar aparati mamografik, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ka filluar, mbas shume viteve, të ofroj shërbimet e mamografisë për të gjitha gratë e interesuara të Komunës së Lipjanit të moshës mbi 40 vjeç.

Kemi eliminuar nevojën për pritje për shërbime të rëntgenit në sektorin e Radiologjisë. Përmirësimi të sektorit të radiologjisë diagnostike dhe shërbimeve laboratorike i kemi adresuar duke vendosur komunikim të drejtpërdrejtë me këtë sektor, objektiv.4. Përmirësimi i shërbimeve në sektorin diagnostikues, laborator dhe rëntgen. Gjatë takimeve kemi identifikuar gjendjen e pajisjeve dhe aparaturave mjekësore, kemi identifikuar nevojat për aparatura shtesë dhe kemi siguruar një rëngën digjital i cili ka hyre ne funksion këtë vit. Ne Shërbimin e Radiologjisë diagnostike në QKMF do të kemi mundësi te ofrojmë teste radiologjike specialistike me kohë sipas kërkesave të mjekëve familjar, pediatri, stomatologe dhe mjekëve te profileve tjera shëndetësore.

Sektori i Stomatologjisë

Në sektorin e stomatologjisë nga fundi i këtij viti kemi arritur tw ofrojmë pakon me shërbimet e kompletuara stomatologjike duke filluar nga fotografimi, shërimi, mbushja, nxjerrja e dhëmbit dhe pastrimi. Ky përmirësim në këtë sektor është arritur duke bërë riorganizimin e stafit dhe përmirësimin e kushteve të punës. Sektori i Stomatologjisë është pajisur me katër karrige të reja stomatologjike, rentgenit të dhëmbëve, katër autoclav dhe 10 sterilizator.

Sektori i Maternitetit

Ky shërbim ka shënuar rënie të lindjeve, por tani janë orientuar drejt vizitave gjinekologjike-obstetrike, vizitave shtëpiake dhe këshillave për nëna dhe fëmijë deri në tre vjeç, po ashtu edhe klasa për nëna. Vizitat gjinekologjike-obstetrike kryhen nga dy mjek gjinekolog. Pajisja me karrige për ekzaminim, me sonda të reja për ECHO dhe aparat CTG ka përmirësuar dukshëm kushtet e punës.

Sektori i Vaksinimit

Është organizuar fushata e vaksinimit sipas grup moshave dhe fëmijëve nga 0-18 vjeç. Përqindja ka qenë 85% nga planifikimi vjetor.

Është realizuar vaksinimi i vajzave të klasave të gjashta të moshës12-13 vjeçare kundër virusit Human Papiloma (HPV). Komuna e Lipjanit është ndër top komunat me përqindjen e realizimit të imunizimit. Përqindja e realizimit në këtë vit ka qenë 94%.

Po ashtu, është realizuar edhe vaksinimi kundër gripit sezonal për personat e shtyer në moshë dhe ata me sëmundje kronike jongjitesë.

Sektori i Barnatores

Kemi një përmirësim në shpërndarjen, planifikimin si dhe evidentimin e stokut. Furnizimi me barna është bërë sipas planifikimit të gjashtë muorit të parë, dhe gjashtë muorit të dytë për çdo muaj sipas kërkesës. Jemi furnizuar mirë me Insulina dhe nuk ka pasur mungesë për pacientët. Ndërsa me material shëndetësor kemi qenë të furnizuar pjesërisht. Me barna tabletare furnizimi nuk ka qenë i dobët ndërsa ka munguar furnizimi me terapi ampulare.

Sektori i Mirëmbajtjes

Në fushën e sigurisë shëndetësore, si komponentë e menaxhimit kualitativ të shërbimeve mjekësore, është bërë avancim i theksuar. Është shënuar përparim i dukshëm në mirëmbajtjen dhe pastërtinë brenda ambienteve të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve.

Sektori i Autogarazhës

Pas furnizimit me vetura të reja për shërbime shëndetësore në KPSH është përmirësuar shumë shërbimi i transportit me autoambulanca dhe pacientëve në hemodializë, vizitave në shtëpi, kujdes paliativ. Është shënuar rënie e shpenzimeve të derivateve. Kemi edhe një orar të ri me pacientet e hemodializës si dhe shtim të pacientëve të ri. Është formuar komisioni për vërtetimin dhe evidentimin e shpenzimeve të derivateve në automjetet e QKMF-së. Servisimi është bërë me kohë i të gjitha automjeteve të QKMF-së.

Konkluzione

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në Kujdesin Primar Shëndetësor në komunën e Lipjanit përkundër vështirësive, si dhe vaksinimin kundër gripit sezonal, ka arritur të ndërtoj një besueshmëri nga qytetarët/pacientët ku dëshmohet me numrin prej 479,452 vizita mjekësore dhe shërbime shëndetësore.

Nga anketimi i kryer nga PRAK, ka dal rezultati se kënaqshmëria e pacientëve/qytetarëve të cilët marrin shërbime në KPSH-Lipjan është 66%. Nga kjo anketë kemi kuptuar se kënaqshmëria me shërbime shëndetësore dhe stafin mjekësorë është mbi 85%, por te furnizimi me barna nga lista esenciale kënaqshmëria është më e ulët (ky furnizim kryhet nga MSh). Si total përqindja 66% është një vlerësim i cilësuar nga PRAK si vlerësim shumë i mirë.

QEBDRA PËR PUNË SOCIALE – QPS

Qendra për Punë Sociale është i vetmi institucion publik me kompetencë profesionale si pikë referimi dhe menaxhimi për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për individët dhe familjet në nevojë për mbështetje materiale dhe profesionale në kuadër të shërbimeve sociale dhe familjare.

Në vazhdimësin e aktiviteteve për ofrim sa më efikas dhe cilësor të shërbimeve për qytetarët në nevojë, Qendra për Punë Sociale realizoi aktivitet në harmoni me legjislacionin, standardet, procedurat administrative dhe politikën sociale, përfshirë:

- Aktivitet promovuese për të drejtat, mbrojtjen sociale dhe siguria për PAK në raste të fatkeqësive (sesione publike informuese), si dhe në avansimin e kornizës organizative dhe administrative (infrastruktura PAK, numri i punonjësve) në QPS-ë.
- Aktivitet kordinues dhe bashkërendues në realizim dhe implementim të planit vjetor/ 2024.
- Aktiviteteve në promovim të strehimit familjar në QPS, sipas plan- programit vjetor/2024.
- Aktivitet ekipor koordinues ndër-institucional për mbrojtjen e fëmijëve në kuadër të tryezës për menaxhimin e rasteve/ fëmijëve me rrezik të mesëm dhe të lartë.
- Aktivitet bashkërendues me OFAP në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje familjare, Promovim i strehimit familjar, mbështetja materiale dhe me mjete didaktike e fëmijëve në strehim. Me Vendim miratim për subvencionim të familjeve strehuese me fëmijë në strehim. (Vendimi, dhjetor 2024).
- Aktivitet në partneritet me QKMF rreth zbatimit të programit për shërbime të integruara sociale dhe shëndetësore me bazë në komunitet, për personat me sëmundje kronike mbi 65 vjet.
- Zbatim i planit të veprimit për rrespektimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve nga konteksi sociale.
- Aktivitet promovues për rrespektimin e të drejtave të fëmijëve me AK, Organizuar nga UNICEF dhe Komuna Lipjan, nëntor/2024.
- Bashkrendim i aktiviteteve me MPB në proces të ri-integrimit për familjet e ri-atëdhesuara.
- Aktivitet rreth reformës SAS, Pilotimi i programit SAS për ndihmë mujore familjeve në nevojë financiare.
- Implementim i planeve mujore, periodike, vjetore në kuadër të SHS,SHNS,SHAF në QPS, gjatë vitit 2024.
- Bashkpunim me zyren për ndihmë juridike falas dhe ZP.
- Marrëdhënie me publikun dhe palët e interesit rreth shërbimeve sociale dhe familjare.

Objektivat e realizuara sipas programeve dhe Memorandum Mirëkuptimit për shërbime sociale.

- Mbështetja e fëmijëve pa përkujdesje prindërore në nevojë për përkujdesje institucionale nga SOS- Fshatrat për Fëmijë, sipas Memorandum , 2024.
- Zbatimi i Memorandum Mirëkuptimi me Organizatë “Terre Des Hommes”, për mbajtjen e tryezave për menaxhimin e rasteve të fëmijëve me rrezik të mesëm dhe të lartë, prill 2024.
- Zbatim i Memorandum Mirëkuptimi me Organizatën “ Qendra Kosovare për Mbështetjen e të Mbijetuarave të Dhunës”, shërbime psikologjike, ligjore për të miturit viktimë të dhunës familje, dhunës seksuale.
- Zbatim të Memorandum Mirëkuptimi me Organizatë “OFAP”, për mbështetje të fëmijëve në strehim familjar dhe familjeve strehuese, 2024.
- Aktivitet me “SOS Fshatrat e Fëmijëve” në hartimin e planit për strehim familjar:2025-2027.
- Aktivitet bashkëpunues për fëmijët me aftësi të kufizuar; shërbime të specializuara psiko-sociale dhe fizio-terapeutike nga Qendrën për Rehabilitimin e Fëmijet me Aftësi të Kufizuar “SMILE” Lipjan.
- Aktivitet me QKMF rreth zbatimit të programit shërbime të integruara sociale e shëndetësore për nënat me foshnje, program i zbatuar tani sa vite në mbështetje nga UNICEF.

Klientët dhe shërbimet sociale

Klientët	Numri i rasteve	Shërbimet	Numri i shërbimeve
Fëmijët e braktisur	5	Vendosja e fëmijëve të braktisuar në spital	5
Fëmija jetim	1	Vendosja në strehim familjar	1
Klient vendor të cilët kërkojnë fëmijë për adoptim	1	Vendosja e fëmijëve në adoptim vendor	1
Fëmijët e keqtrajtuar (lënë pas dore)	35	Bashkimi familjar – kthimi në familje.	7
Fëmijët me sjellje asocial-vështirësi në sjellje	82	Kujdestaria	15
Të miturit në konflikt me Ligjin (delinkuent)	207	Shërbime për të miturit në konflikt me ligjin.	290
Martesa e të miturve mbi 16 - kërkesa për mendim	4	Vendosja në strehim për viktimat e dhunës familjare, trafikim dhe krime seksuale	3
Klient në nevojë për këshilla martesore	43	Vlerësime për të miturit që kërkojnë të hynë në martesë.	1
Të moshuar në nevojë për shërbime	5	Këshillim për bashkëshortet në martesë.	55
Klient tjerë në nevojë për shërbime	611	Besim i fëmijëve dhe mbikëqyrja e vizitave prindërore.	87
Klient me aftësi të kufizuara - fëmijët	32	Kontaktimet prind – fëmijë active nga vitete e kaluara	10
Klient me aftësi të kufizuara – të rritur	1	Intervenime për viktimat	87
Viktimat e dhunës në familje	66	Intervenime të përgjithshme	4621
Viktimat e krimeve seksuale	7	Shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara.	178
Kujdestari për fëmijet e pa shoqëruar	8	Shërbime për të rritur me aftësi të kufizuara.	1
Tentim vrasje	1	Shërbime për moshuarit	5
Punë e rrezikshme e fëmijëve	0	Këshilla psiko- sociale	71
Rrëmbim ndërkombëtar i fëmijëve	0	Sanim i marrëdhënieve familjare.	5
Klient ndërkombëtar që kërkojnë fëmijë për adoptim	0	Intervenime gjatë orarit të kujdestarisë.	123
Viktima të trafikimit	0	Ndihmë material për fëmijët me aftësi të kufizuara	17
Kërkesa për përfaqësues të përkohshëm	19	Proces/e reintegrimi i fëmijëve	33
Total nr. i përgjithshëm i klientëve:	1109	Nr. i përgjithshëm i shërbimeve:	5600

PËRKRAHJA MATERIALE E FAMILJEVE ME FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Qendra për Punë Social përmes Shërbimit Social ka realizuar aktivitete të mbështetjes materiale dhe integruar për fëmijët me aftësi të kufizuara sin ë vijim:

QPS	Familjet e PAK	Fëmijët me AK	Totali	%
Lipjan	174	178	201,620.00€	100%

Të gjitha rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara i janë nënshtruar procedurës ligjore dhe ekspertizës mjekësor në kuadër të Komisionit të DPSF/MFPT, dhe vendimmarrjes nga QPS.

Rastet e FAK vazhdimisht përcjellen dhe raportohen për marrjen e shërbimeve psiko-sociale dhe fizio-terapeutike në qendrat e specializuara, siç është Qendra “SMILE” Lipjan, Zyret “ Burimore” në shkolla etj.

Përveq qasjes konstruktive e profesionale me fëmijë AK, Shërbimim Social realizoi aktivitete intervistues, vlerësues dhe të raportimit e socializues, ri-integruar për fëmijët me sjellje asociale në 82 raste, ndërsa në kuadër të delikuencës janë trajtuar gjithsej: 207 raste. Numri i delikuencës është në rënje për 17- raste, ose 8.21%.

Strehim familjar në familje biologjike.

Fëmijet në strehim familjar në familje biologjike/2024.

NR.	V.2024	FEMIJE TE STREHUAR NË FAMILJE STREHUESE	VLERA NË EURO
1	JANAR-DHJETOR	21	150

Gjatë kësaj periudhe raportuese është ofruar strehim familjar për tre (3) fëmijë jasht familjes biologjike, dhe për njëzet e një fëmijë (21) brenda familjes biologjike, prej tyre tre (3) fëmijë raste të reja. Gjithsej (24) njëzet e katër fëmijë në strehim familjar.

Mbrojtja e fëmijëve përmes strehimit familjar në familje tjetër, dhe familje biologjike, është njëzet e katër (24) fëmijë, prej tyre (16) gjashtbëdhjetë mashkuj, dhe(8)vajza.

Gjatë këtij viti është ofruar mbrojtje sociale nga përkujdesja institucionale dhe komunitet për 5 fëmijë. Tre djem dhe dy vajza. 12.

Strehimi familjar te të afërmit dhe në familje tjetër është realizuar brenda kompetencës territoriale të Lipjanit. QPS në Lipjan ka dy familje strehuese të miratuara për strehim të fëmijëve jasht familjes biologjike, ndërsa një në proces aprovimi.

Gjatë kësaj periudhe raportuese përveq strehimit familjar, Shërbimi Social ka trajtuar dhjetra lëndë në procedurë shkursorëzimi, për të cilat ka dhënë mendim Gjykatës kompetente rreth besimit të fëmijëve- kujdestarisë. Për fëmijët e prindërve të shkursorëzuar është mundësuar edhe realizim i kontakteve prind-fëmijë nën mbikqyerjen e Organit të Kujdestarisë. Organi i Kujdestarisë ka realizuar mbikëqyrje të realizimit të kontakteve prind-fëmijë në zyrën e kontakteve (miqësore) në QPS.

DHUNA NË FAMILJE NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË BAZA GJINORE

Dhuna në familje është trajtuar në harmoni me Ligjin për Familje 2004/32 dhe LigjinNr. 08/L- 185 Për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore. Në harmoni me PSV, dhe politikën sociale, strategjitë dhe programet për planet lokale të veprimit.

Dhuna në Familje ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore

Nacionaliteti	Nr.Rasteve	M	F	Fizike	Psikologjike	Gjykatë	Masat mbrojtëse
Ashkali	5	1	4	4	1	0	0
Rom	1	0	1	1	0	0	0
Sërb	/	0	0	0	0	0	0
Shqiptarë	55	10	45	43	12	6	9
TOTAL	61	11	50	48	13	6	9

Viktimave të dhunës në familje u është asistuar në polici dhe shërbime tjera të nevojshme në përfaqësim, mbrojtje,

rehabilitim dhe ri-itegrim. Është ofruar mbrojtje për 9 (nëntë) raste, strehim (QMGF), mbështetje për aplikim të qasjes në punësim, masa 1.8. “Mbështetja e punësimit të grave viktima të dhunës në familje, në kuadër të Skemës “Qeveria për Familjet.

Diferenca e rasteve të dhunës në familje është për pesë raste më shumë se në vitin e kaluar, apo në diferencë të rritjes për 8.1%

Njëherit vit 2024, përshkruhet edhe si vit i miratimit dhe aplikimit të planit të veprimit për parandalimin e dhunës në familje dhe baza gjinore, vit i raportimit në përmbushjen e obligimeve që dalin nga Strategjia Nacionale për planin lokal/komunal për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore.

Viti 2024, rezulton në përkrahje profesionale, avokim të familjeve dhe individëve të cënueshme, përmes ofrimit të shërbimeve dhe përfaqësimit në Gjykata, Sh. Gjendjes Civile. Polici. Strehimore, Qendra të kujdesit ditor dhe rezidencial, shkolla dhe në familje. Etj. Realizimit të punës me përqendrim në klient dhe detyrë në Qendrat e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare, Qendrat Rehabilituese Rezidenciale, SHPK, QKU – KL. Gjinekologjike, Pediatriisë, Psikiatriisë në Prishtinë, strehimore, SOS –Fshatin e Fëmijëve në Prishtinë etj. OFAP,KOMF,QKRMT,famjet strehuese etj.

PËRKUJDESJA INSTITUCIONALE

Përkujdesja institucionale nuk ka munguar nga institucionet e nivelit lokal dhe qendror, andaj gjatë kësaj periudhe raportuese është vazhduar me përkujdesje institucionale/rezidenciale, për 1 (një) rezident të vendosur në Qendren Rehabilituese Integruese në Shtime, si dhe për 10 (dhjetë) raste të vendosura në Qendrën për përkujdesje ndaj personave me ngecje në zhvillim intelektual në Lipjan.

SEKTORI PËR MIRËQENIE SOCIAL

Shërbimi i Ndihmave Sociale

Gjatë kësaj periudhe raportuese, si vazhdimësi e zbatimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë dhe ATK-ës, për verifikimin e tatim paguesve me AS-le. Pilotimit SAS, kemi shënuar rënje të numërit të shfrytëzuesve nga skema e ndihmës sociale.

Në Janar të këtij viti shërbimi i SAS-it kishte 1007 familje, me shumë totale prej **134,360.00€**, ndërsa në dhjetor, 2024 janë: 899 familje, me shumë prej 121, 400.00€, në diferencë të shfrytëzuesëve të AS-le nga SNS-le, për 108 familje më pak, apo në diferencë të uljes për 0.72%

PASQYRA E PAGESAVE TË ASISTENCËS SOCIALE

Pasqyra e pagesave të asistencës sociale, janar dhjetor/2024.

Muaji	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve të familjeve	Shuma në euro
Janar	1,007	4,361	134,360.00€
Shkurt	1,011	4,360	136,250.00€
Mars	980	4,200	130,730.00€
Prill	965	4,157	130,670.00€
Maj	963	4,135	130,080.00€
Qershor	933	4,018	124,850.00€
Korrik	929	3,991	124,170.00€
Gusht	914	3,928	122,820.00€
Shtator	931	3,992	125,920.00€
Tetor	916	3,923	122,480.00€
Nentor	893	3,826	119,370.00€
Dhjetor	899	3,823	121,400.00€

PASQYRA E PAGESAVE TË ASISTENCËS SOCIALE PËR AZIL KËRKUES

Pasqyra e pagesave të asistencës sociale, janar dhjetor/2024.

Muaji	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve të familjeve	Shuma në euro
Janar	7	8	510.00
Shkurt	7	8	510.00
Mars	13	16	970.00
Prill	19	21	1,370.00
Maj	13	18	1,010.00
Qershor	14	20	1,100.00
Korrik	14	18	1,060.00
Gusht	9	11	670.00
Shtator	11	17	890.00
Tetor	8	13	660.00
Nentor	11	20	790.00
Dhjetor	12	17	1,000.00

PERFITUESIT NGA PILOTIMI SAS

Gjatë kësaj periudhe raportuese është zbatuar edhe programi për pilotimin SAS, është avokuar dhe asistuar për aplikim në një numër solid të rasteve, pasi që shumica e aplikuesëve në këtë proces aplikim, kanë realizuar vet-aplikimin në platformën e-Kosova.

SHNS në Qendrën për Punë Sociale, pas kalimit të testit (Pilotimi SAS) nga palët aplikuese për të hyrat financiare dhe të llogaritshme nga MFPT, SHNS ka vlerësuar këto familje përmes verifikimit në teren, dhe rrjedha e përfituesëve është si në si në vijim:

Numri i aplikimeve të asistuar nga QPS	150
Numri i familjeve të përzgjedhura për verifikim dhe vlerësim nga QPS.	781
Numri i familjeve të verifikuara dhe vlerësuara, gjatë vizitave në teren.	370
Numri i familjeve përfituese të pilotimit SAS.	144

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Shërbimi i Ndhimave Sociale në Qendrën për Punë Sociale ka administruar dhe asistuar në aplikim të kërkesave për platformën SAS, ka verifikuar dhe vlerësuar familjet për miratim të kërkesave për mbështetje financiare, njëkohësisht ka lëshuar 105 vërtetima sipas evidences zyrtare.

Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk ka munguar bashkëpunimi me palët e interesit në mbështetje të familjeve në nevojë me pako ushqimore.

SHTËPIA ME BAZË NË KOMUNITET

Gjendja shëndetësore e rezidentëve:

Gjendja shëndetësore e rezidentëve gjatë këtij viti në përgjithësi ka qenë e mirë në përjashtim të disa rezidentëve të cilët kishin momente të krizave të rënduara psikike që ka qenë i pamundur menagjimi nga stafi dhe janë dërguar për trajtim specialistik në QKUK- kliniken e psikiatrisë në Prishtinë, ndërsa për kriza të lehta të gjitha rastet janë menagjuar dhe trajtuar nga stafi i Shtëpisë me bazë në Komunitet , kurse për trajtimet tjera shëndetësore kemi bashkëpunuar me QKMF- në-Lipjan ku çdoherë sipas nevojave për vizita i janë përgjigjur thirrjeve nga stafi i Shtëpisë me Bazë në Komunitet. Të gjithë rezidentët janë vaksinuar me vaksinën kundër gripave në muajin Tetor 2024.

Struktura e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit- Lipjan

STRUKTURA E REZIDENTEVE			
NACIONALITETI	NUMRI	FRMRA	MESHKUJ
SHQIPËTAR	8	4	4
ROM	1	1	
BOSHNJAK	1	1	
NUMRI I PERGJITHSHEM	10	6	4

DREJTORATI PËR ARSIM

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Sistemi arsimor në Komunën e Lipjanit organizohet në nivelet 0, 1, 2 dhe 3, me gjithsejt 28 Institucione Arsimore, prej të cilave 1 Institucion për edukimin parashkollor, 24 SHFMU dhe 3 SHML (një shkollë Gjimnaz, një shkollë Profesionale dhe një shkollë Mikse). Ofrimi i kushteve dhe arritja e rezultateve të kënaqshme në aspektin edukativo-arsimor janë çështje të cilat DKA në vazhdimësi mundohet t'i arrijë me punë dhe aktivitete të ndryshme, gjithmonë duke synuar më të mirën për shkollën, veqanërisht përmirësimin e nevojave primare të cilat ndikojnë pozitivisht në realizimin sa më të mirë të procesit edukativo- arsimor. Ngritja e cilësisë në mësim, në veçanti përmirësimi i praktikave vlerësuese të nxënësve, ka qenë prioritet në mënyrë që shkollat tona të arrijnë në stadin e shkollave të përparuara në aspektin zhvillimor.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

- Përfundimi i gjysëm vjetorit të parë për vitin shkollor 2024-2025 më datë **24.12.2024**. Gjatë kësaj kohe është bërë grumbullimi i statistikave nga secila shkollë dha analiza e tyre.
- Hartimi dhe dorëzimi i planit të zotimit dhe shpenzimit në buxhet
- Hartimi dhe dorëzimi I planit të punës të DKA për vitin 2025
- Evidentimi dhe pasqyrimi i borgjeve nga viti 2024 në pasqyrat financiare
- Përgatitja dhe dërgimi në buxhet i formularëve për deponimin e nënshkrimit për të gjithë autorizuesit e shpenzimit në nivel shkolle.
 - **Shënimi i ditës së 7 Marsit**
Për nder të festës së 7 Marsit Ditës së Mësuesit DKA ka organizuar takim me drejtorët dhe mësime dhënësit e shkollave në të cilin takim u ndanë mirënjohje për mësime dhënësit e dalluar në nivel shkolle. Gjithashtu është bërë përzgjedhja e punëtorit më të mirë në nivel Komune për vitin 2024. Të gjitha Shkollat e kanë shënuar këtë ditë me organizime festive.

➤ **Takimet:**

- Takim me përfaqësuesit e organizatës joqeveritare VORAE, qëllimi i takimit ishte marrja e informatave nga DKA-të rreth funksionimit të qendrave mësimore. Takime me përfaqësues të UNICEF-it me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjelltë.
- Takime me përfaqësuesit e IHDNJ-Instituti për Hulumtime dhe Të Drejtat e Njeriut, qëllimi i takimit ishte realizimi i projektit “Thuaj jo fjalës së urrejtjes dhe ngacmimit seksual”.
- Është nënshkruar memorandum bashkëpunimi ndërmjet OJQ-së “Shoqata Olimpiada speciale Kosova” dhe Komuna e Lipjanit, qëllimi i këtij memorandumi ka qenë ofrimi i mundësive për aktivitete sportive të nxënësve me nevojë të veqanta dhe për kategoritë e cënueshme
- Është bërë DDD në qerdhen Amë dhe paralelet në Gadime, Sillovi, Shalë dhe Rufc i Ri
- Kanë përfunduar Renovimet e banjove në shkollat “Ismail Luma” në Lipjan, dhe “Katër Dëshmorët” në Krojmir
- Në shfmu Llughaxhi është intervenuar në shkollë në krijimin e hapësirave të reja mësimore në mënyrë që shkolla të kalojë me punë në një ndërrim.
- Është finalizuar draft plani i veprimit kundër braktisjes dhe mos regjistrimit dhe inicimi i procedurës për miratim në Kuvend.
- Është mbajtur testi i arritshmërisë për nxënësit e klasëve të IX-nënta, test të cilit ju nënshtruan 801 semimaturantë.
- Është mbajtur testi i maturës pjesë e parë, test të cilit ju nënshtruan 673 maturantë.

➤ **Investimet kapitale në shkollë:**

Ka përfunduar renovimi i shkollës së mesme “Shaqir Hoxha” në Shalë, SHFMU

“Vëllezërit Domaneku” në Topliqan, SHFMU “Fehmi Agani” në Medvec,

SHFMU “Hasan Zyko Kamberi” në Sillovi, SHFMU “Haradin Bajrami” pnf në Qylagë si dhe renovimi SHFMU “Migjeni” Rufc i Ri.

Ka përfunduar ndërtimi i shkollës së re në Ribar i Madh.

Ka përfunduar ndërtimi i qerdheve për fëmijë në Rufc i Ri

Furnizimin i Çerdhës së fëmijëve në Shalë me inventar

Furnizimin i Çerdhës në Rufc i Ri me pajisje të ndryshme inventar, pajisje shtëpiake, klima, me materiale të imta- shtrojë e mbulojë

Më datë 29.05.2024 është bërë hapja e Çerdhës së re në fshatin Rufc i Ri.

Furnizimi me kaldaja për SHMP “Adem Gllavica” në Lipjan dhe SHFMU “Ibrahim Banushi” në Shalë

Organizimi i garave

Janë mbajtur garat e Olimpiada Matematike e Kosovës për nxënësit e klasave të 7-ta, 8-ta, 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe të 12-ta. Në këto gara të Olimpiadës Matematike të Kosovës kanë marrë pjesë të gjitha vendet e para dhe të dyta të klasave të 7-ta, 8-ta, 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe të 12-ta, të të gjitha komunave të Kosovës. Si çdo herë në komunën tonë përpos shkollave publike në këto gara kanë marrë pjesë edhe kolegjet private të cilat gjenden në teritorin e komunës së Lipjanit. Nga të gjitha shkollat pjesëmarrëse suksese të mira kanë arritur nxënësit nga SHFMU “Hasan Prishtina” në Llughaxhi.

➤ **Kuizi të diturisë.**

Nën organizimin e Shfmu “Ismail Luma” në Lipjan më datë 19/04/2024 është mbajtur finalja e

E kuizit të diturisë. Në bazë të rezultateve të pesë ditëve garuese, të drejtën për të garuar në finale e fituan ekipet e këtyre shkollave: Shfmu “Ernest Koliqi” në Babush i Muhaxherëve Shfmu “Hasan Prishtina”, në Llughaxhi, Shfmu “Ismail Luma” në Lipjan, Shfmu “Nezë Bujani” në Bujan dhe Shfmu “Emin Duraku” në Banullë. Pas një gare korrekte, fitues i finales së Kuizit të Diturisë 2024 u shpall Shfmu “Ernest Koliqi” në Babush i Muhaxherëve.

➤ **Psikologët shkollorë në vazhdimësi kanë ligjeruar në tema sensibilizuese kundër dukurive**

negative. Psikologjia e SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan ka mbajtur ligjëratë kundër bullizmit me nxënësit e klasave të VI-IX. Gjithashtu është punuar broshura kundër këtij fenomeni dhe punime në hollin e shkollës së bashku me këshillin e nxënësve për të bërë sensibilizimin dhe informimin e nxënësve për rrezikun e bullizmit dhe mënyrat e parandalimit të tij.

Më datë **16.11.2024** janë mbajtur garat ndërkombëtare nga lëndët Gjeografi, Histori, Gjuhë Angleze dhe Gjuhë Shqipe në Shqipëri, të cilat janë prezantuar me 4 projekte , që janë kualifikuar për finale. Në këto gara kanë marrë pjesë 45 nxënës, ku 2 nxënës kanë zënë vendin e parë dhe 4 nxënës vendin e dytë.

Me datë 23 dhe 24 nëntor janë mbajtur punëtori me mësimdhënësit e shkollave për rishikimin e teksteve shkollore.

➤ **Vlerësimi I fëmijëve me nevoja të veçanta**

Komisioni Komunal për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta ka bërë vlerësimin pedagogjik të 53 fëmijëve me nevoja të veçanta.

➤ **Oganizimi dhe mbajtja e panairit P-GJASHT** në Shfmu “VII Frashëri” në Lipjan-pjesë e këtij panairi ishin të gjitha shkollat e mesme të ulëta publike dhe private.

➤ **Planifikimi dhe regjistrimi i nxënësve per vitin akademik 2024/25**

Më datë **09.07.2024** është shpallur konkursi për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të (dhjetë) të Gjmnazeve dhe të shkollave Profesionale, për vitin shkollor **2024/2025**

➤ **Konkurs për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të (dhjetë) të Gjmnazeve dhe të shkollave Profesionale, për vitin shkollor 2024/2025**

Është mbajtur takimi i komisionit për Draft-Rregulloren për organizimin e punës së institucioneve edukative-arsimore të komunës së Lipjanit, ku e njëjta ka kaluar në diskutim publik dhe është proceduar për në kuvend.

Gjimnazi "Ulpiana"në Lipjan

Nr	Klasa	Drejtimi	Nr. I paraleleve	Nr I nxënësve
1	X	Gjimnazi natyror	6	155
2	X	Gjimnazi shoqëror shoqëror - gjuhësor	6	213
Gjithësejt			12	368

Gjimnazi "Ulpiana"në Lipjan, paralelja e ndarë fizike në Gadime

Nr	Klasa	Drejtimi	Nr. I paraleleve	Nr nxënësve
1	X	Gjimnazi natyror	1	19
2	X	Gjimnazi shoqëror - gjuhësor	61	19
Gjithësejt			2	38

SHMLM SHAQIR HOXHA - SHALË

Nr	Klasa	Drejtimi	Nr. I paraleleve	Nr I nxënësve
1	X	Gjimnazi shkenca natyrore	1	17
2	X	Gjimnazi shkenca shqërore	1	12
3	X	Kontabilitet	1	8
4	X	Makineri - Automekanik	0	0
Gjithësejt			3	37

SHMP “ ADEM GLLAVICA” - Lipjan

Raport për numrin e nxënësve të pranuar dhe vendeve të lira për klasë të X-të për vitin shkollor 2024/25.

Nr.	Drejtimi	Profili arsimor	Te pranuar	Numri i paraleleve.
1	Ekonomi	Banka financa dhe sigurime	26	1
2	Ekonomi	Marketing dhe shitje	26	1
3	Ekonomi	Kontabilitet dhe tatime	25	1
4	Administratë	Asistent i administratës	52	2
5	Makineri	Instalues i Ngrohjes e Klimatizimit dhe Ujësjellesit e Kanalizimit	29	1
6	Makineri	Automekanik	19	1
7	Makineri	Metal punues	00	1
8	Bujqësi	Agrobiznes	12	1
9	Elektroteknikë	Informatikë	28	1
10	Elektroteknikë	Instalues elektrik	22	1
11	Ndërtimtari	Arkitekturë	25	1
Gjithsej:			264	12

GJITHËSEJT NË TË TRI SHKOLLAT E MESME

SHKOLLA	Nr i paraleleve	Nr i nxënësve
GJIMNAZI " ULPIANA"	14	406
SHMP " ADEM GLLAVICA"	12	261
SHMLM " SHAQIR HOXHA"	3	37
Gjithsej	29	707

Vlerësimi i jashtëm – testet ndërkombëtare

TESTI TIMSS-2024

Në bashkëpunim me MASHT është realizuar vlerësimi ndërkombëtar TIMSS 2023 Longitudinale me nxënës të klasës së V-të, janë përgaditjet e duhura planifikimi i qendra të vlerësimit janë caktuar datat dhe koordinatorët e shkollave . Në këtë vlerësim kanë marrë pjesë gjithsej 144 nxënës nga 5 shkolla fillore.

Tabela e shkollave me numër të nxënësve dhe datat e mbajtjes së testit

Komuna	Shkolla	Kodi i shkollës	Klasa e përzgjedhur	Nr. i nxënësve	Qendra e testimit	Datat
Lipjan	Hasan Zuko Kamberi	1124	V/1	20	SHFMU "Ismail Luma " - Lipjan	05.06. 2024
	Vëllëzërit Frashëri	1058	V/1	42	SHFMU " V. Frashëri " Lipjan	5,6,7 .06.2024
			V/4	42		
	Zenel Hajdini	1121	V/1	23	SHFMU " Zenel Hajdini " - Gadime	3,4 06.2024
			V/3	19		
			V/4	5		
			V/5	2		
	Emin Duraku	1125	V/2	15	SHFMU "Emin Duraku " Banullë	06.6.2024
	Kadri Beba	1126	V/2	20	SHFMU " Ismail Luma" Lpjan	07.06.2024

➤ Vlerësimi I brendshëm : Testi i arritshmërisë dhe testi i maturës

Përgatitjet teknike dhe dërgimi i formularëve në MASHT për testin e arritshmërisë.

Rezultatete e testit të arritshmërisë në nivel komune për vitin shkollor 2023-2024

Nr.	Shkolla	Nr i nxënësve	Përqindja e kalueshmërisë në testin e arritshmërisë
1	SHFMU " VËLLËZËRIT FRASHËRI "	197	54.04
2	SHFMU "ISMAIL LUMA "	74	35
3	SHFMU "ZENEL HAJDINI "	42	44.54
4	SHFMU "DY DËSHMORËT"	27	40
5	SHFMU " IBRAHIM BANUSHI "	28	42
6	SHFMU "HARADIN BAJRAMI "	63	41
7	SHFMU "EMIN DURAKU "	25	53
8	SHFMU " HASAN Z KAMBERI "	49	41
9	SHFMU "MIGJENI "	33	44.86
10	SHFMU " ERNEST KOLIQI "	28	51
11	SHFMU " SHTJEFËN GJEQOVI "	15	40
12	SHFMU " KADRI BEBA "	38	43.03
13	SHFMU " SKËNDERBEU "	19	39
14	SHFMU " KATËR DËSHMORËT "	21	39
15	SHFMU " V .DOMANEKU "	11	40
16	SHFMU " HASAN PRISHTINA "	18	52
17	SHFMU " IBRAHIM KRASNIQI "	18	48
18	SHFMU "NEZË BUJANI "	13	47
19	SHFMU " FEHMI AGANI "	12	41
20	SHFMU " DRITA "	7	52
21	SHFMU " REGJEP AKLLAPI "	7	36
22	SHFMU "VEZIR KOLSHI "	26	39
23	SHFMU " 7 MARSË "	15	49
24	SHFMU - "17 Shkurti" GLLOGOVÇ	15	41
Gjithësejt		801	45.33

➤ **Organizimi dhe mbajtja e testit të maturës shtetërore 2024**

MASHT në bashkëpunim me koordinatoret komunal për testin e maturës shtetërore me kohë kanë bërë përgaditjet, duke bërë regjistrat e nxënësve formuar qendrat e testimit dhe janë ndarë klasët ashtu siç ka qenë me udhëzim administrativ nga 15 nxënës në një klasë. Po ashtu janë caktuar koordinatoret e shkollave dhe administruesit duke mbajtur takime informuese mbi rolin dhe përgjegjësitë e administruesëve për ditën e mbajtjes së testit të maturës.

Rezultatet në testin e maturës shtetërore 2024 afati i qershorit

GJIMNAZI"ULPIANA"LIPJAN				
DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%
Natyror	42	64.62	23	35.38
Shoqëror	33	48.53	35	51.47
GJITHSEJ	75	56.39	58	43.61

GJIMNAZI"ULPIANA"LIPJAN					
DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHSEJ NXËNËS
Natyror	181	84.58	33	15.42	214
Shoqëror	156	54.55	130	45.45	286
GJITHSEJ	337	67.40	163	32.60	500

SHMP"ADEM GLLAVICA"LIPJAN					
DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHËSEJ NXËNËS
EKONOMI	19	47.50	21	52.50	40
ADMINISTRATË	19	43.18	25	56.82	44
KIMI-TEKNOLOGJI	5	35.71	9	64.29	14
BUJQËSI	1	25.00	3	75.00	4
ELEKTROTEKNIKË	11	50.00	11	50.00	22
MAKINERI	3	60.00	2	40.00	5
NDËRTIMTARI	12	63.16	7	36.84	19
GJITHSEJ	70	47.30	78	52.70	148

SHML"SHAQIR HOXHA" SHALË					
DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHËSEJ NXËNËS
NATYROR	3	27.27	9	81.82	11
SHOQËROR-GJUHËSOR	5	41.67	7	58.33	12
EKONOMIK:BANKA DHE FINANCA	0	0.00	2	100.00	2
GJITHSEJ	8	32.00	18	72.00	25

Afati Qeshorit -2024				
NË NIVEL KOMUNE				
POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHËSEJ NXËNËS
415	61.66	259	38.48	673

Rezultatet në testin e maturës shtetërore 2024 afati I gushtit

SHMP"ADEM GLLAVICA"LIPJAN					
DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHËSEJ NXËNËS
EKONOMI	6	42.86	8	57.14	14
ADMINISTRATË	4	13.79	25	86.21	29
BUJQËSI	0	0.00	4	100.00	4
ELEKTROTEKNIKË	3	50.00	3	50.00	6
MAKINERI	0	0.00	1	100.00	1
NDËRTIMTARI	5	62.50	3	37.50	8
KIMI-TEKNOLOGJI	2	33.33	4	66.67	6
GJITHSEJ	20	29.41	48	70.59	68

Afati Gushtit -2024				
NË NIVEL KOMUNE				
POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHËSEJ NXËNËS
99	45.21	120	54.79	219

SHML"SHAQIR HOXHA" SHALË					
DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHËSEJ NXËNËS
NATYROR	2	33.33	4	66.67	6
SHOQËROR-GJUHËSOR	2	25.00	6	75.00	8
Kontabilitet	0	0.00	4	100.00	4
GJITHSEJ	4	22.22	14	77.78	18

Janë përgatitur të dhënat rreth suksesit të nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë për vitin shkollor 2023/2024 sipas niveleve

Tabela Nr.2 Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2023/2024

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2023/2024
Arsimi fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë (1-5, 6-9, 10-12)
Komuna LIPJAN
Shkolla: NIVEL KOMUNE

Klasa/Niveli	Nr. paraleleve	Nr I nxënësve	Suksesi pozitiv				Përsërisin klasën		Të pa notuar		Braktisës		Numri i mungesave			Nota mesatare
			Gjithsej me nota pozitive		Gjithsej me nota negative që përcillen								Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej	
1---5	282	4440	4143	93.31	58	1.31			25	0.56	10	0.23	53735	22231	75966	4.37
6--9	187	3547	3012	84.92			77	2.17	40	1.13	9	0.25	98134	50591	148725	3.24
10-12	93	2180	1761	80.78			22	1.01	85	3.90	42	1.93	52349	27086	79435	2.70
GJ.	562	10167	8916	87.70	58	1.31	99	0.97	150	1.48	61	0.60	204218	99908	304126	

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Rajoni: Ferizaj
Komuna: LIPJAN

Tabela e braktisjes së nxënësve sipas klasëve gjinisë dhe përkatësis kombtare

KLASA	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve			Braktisja																														
		Gjithsej			Shqiptarë			Ashkali			Romë			Kroatë			Të tjerë			Nr i nx. me rrezikshmëri të lartë për braktisje (numri i madh i mungesave, përforma e dobët në mësim			Nr i nx me rrethana jo të mire ekonomike dhe me tendencë për braktisje			Nr i nx me shëndet jo të mirë (mendor, fizikë etj.) dhe me tendencë për braktisje			Nr i nx. që kanë braktisur shkollimin por që janë kthyer prap në shkollë me angazhimin e ekipit të EPRBM-së			Numri i nxënësve që kanë braktisur dhe që nuk janë kthyer më në shkollë			
		M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	
Parafillor	66	374	379	753	356	355	711	18	23	41				0	1	1				1			3	2	1	1	2	1		1			1		1
Klasa e parë	57	453	399	852	420	367	787	34	31	65										4	1	5	2	2	2	1		1	2	0	2	3	2	5	
Klasa e dytë	59	461	412	873	438	392	830	23	20	43										1	1	1	1	1	1							2	1	3	
Klasa e tretë	61	484	419	903	451	392	843	32	27	59				1	0	1				2	2	4	2	3	5		1	1	2	0	2	0	2	2	
Klasa e katërt	58	493	453	946	472	434	906	21	19	40										3	2	5		1	1							3	1	4	
Klasa e pestë	63	469	462	931	442	431	873	26	31	57				0	1	1				2	0	2	3	0	3							2	1	2	
Klasa e gjashtë	67	511	466	977	477	439	916	31	22	53				1	3	4	7			10	4	13	7	3	10	3		4	3	3	5	2	2	3	
Klasa e shtatë	47	494	470	964	466	444	910	25	25	50				3	1	4				2	2	3	0	2	2	0	2	2				0	1	1	
Klasa e tetë	46	456	394	850	438	368	806	17	27	44										4	0	4	1	0	1	1	1	1	1		1	3	0	3	
Klasa e nëntë	47	419	396	815	400	378	778	19	18	37										6	2	7	2	0	2	1	1	1	1		1	2	0	2	
	571	4614	4250	8864	4360	4000	8360	246	243	489				1	7	7	14			33	17	46	19	12	29	7	3	11	9	3	11	18	10	26	
Klasa e dhjetë	30	389	364	753	384	363	747	5	1	6																						11	5	16	
Klasa e njëmbëdhjetë	31	384	337	721	383	334	717	1	3	4																						7	2	9	
Klasa e dymbëdhjetë	32	348	386	734	344	383	727	4	2	6				0	1	1																4	4	8	
GJITHËSITË	93	1121	1087	2208	1111	1080	2191	10	6	16				0	1	1				1	33	17	46	19	12	29	7	3	11	9	3	11	22	11	33

		Nr. i nxënësve	Braktisja
--	--	----------------	-----------

TOTALI I TË GJITHA NIVELEVE		Gjithsej			Shqiptarë			Ashkalinj			Romë			Kroatë			Të tjerë			Nr i nx. me rrezikshmëri të lartë për braktisje (numri i madh i mungesave, performanca e dobët në mësim)			Nr i nx me rrethana jo të mirë ekonomike dhe me tendencë për braktisje			Nr i nx me shëndet jo të mirë (mendor , fizikë etj.) dhe me tendencë për braktisje			Nr i nx. që kanë braktisur shkollimin por që janë kthyer prap në shkollë me angazhimin e ekipit të EPRBM -së			Numri i nxënësve që kanë braktisur dhe që nuk janë kthyer më në shkollë		
		M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
	664	5735	5337	11072	5471	5080	10551	256	249	505			1	7	8	15				33	17	46	19	12	29	7	3	11	9	3	11	40	21	59

Kërkesë DPU-së:

- Hartimi i paramasës dhe parallogarisë për: Ndërrimin e kaldajave në shkollat: Shfmu “Ibrahim Banushi” në Shalë dhe "Adem Gllavica" në Lipjan,
- Marrjen e pëlqimit “Rrërimi i shkollës së vjetër në fshatin Janjevë,
- Hartimin e paramasës dhe parallogarisë për projektin: Renovimi i shkollave në Shalë (fillore) dhe Sillovi,
- Hartimin e paramasës dhe parallogarisë për projektin: Renovimi eficientë i shkollave në Rufc i Ri, Topliqan, Janjevë, Qylagë, Medvec, Kojskë, Shalë-Shkolla e mesme,
- Hartimin e paramasës dhe parallogarisë për projektin: Renovimi i shkollave në Shalë (fillore) dhe Sillovi dhe
- Hartimin e paramasës dhe parallogarisë për projektin: Renovimi eficientë i shkollave në Rufc i Ri, Topliqan, Janjevë, Qylagë, Medvec, Kojskë, Shalë-Shkolla e mesme.

Kërkesë DP-së për zhvillimin e procedurës:

- Demolimi, furnizimi, montimi i dyerve dhe dritareve në disa IEA (kontratë një vjeçare),
- Furnizimi me material higjienik i të gjitha IEA – (kontratë kornizë dy vjeçare),
- Furnizimi me mallrat për mbjelljet pranverë – vjeshtë për periudhën dy vjeçare 2023-2025 (kontratë kornizë),
- Riparimi, pastrimi dhe mbushja e klimave në IEA (kontratë një vjeçare),
- Riparimi i defekteve dhe rregullimi i kulmeve në IEA-të (kontratë kornizë dy vjeçare),
- Furnizimi i gjitha IEA-ve me vegla (pajisje) të ndryshme pune (kontratë dy vjeçare),
- Finalizimi i planit të prokurimit (me shtimin e disa aktiveve të punës),
- Sigurimin fizik të objekteve në shkollat: Shfmu “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan dhe SHML Gjimnazi “Ulpiana” në Lipjan,
- Pajisje për makineri bujqësore në Ekonominë bujqësore-kontratë tre vjeçare,
- Riparimin, pastrimi dhe mbushja e klimave në IEA-kontratë një vjeçare,
- Furnizimin me kompjuter dhe projektor në IEA-të e Komunës së Lipjanit,
- Ndërrimin e kaldajave në shkollat Shfmu “Ibrahim Banushi” në Shalë dhe SHMP “Adem Gllavica” në Lipjan,
- Furnizimin me pajisje për makinerinë bujqësore në ekonominë bujqësore-Ritenderim,
- Furnizimin me Pelet për ngrohje të IEA-ve, të Komunës së Lipjanit-Kontratë njëvjeçare (12 muaj),
- Furnizimin me material të ndryshme për nevoja të IAE-ve, kontratë kornizë trevjeçare,
- Furnizimin me pajisje të teknologjisë,
- Transporti i nxënësve në relacionet shtëpi- shkollë në 17 lloje,
- qendrën e testimit&anasjelltas,
- Shitjen e asteve jashtë përdorimit përmes ankandit publik,
- Furnizimi i Çerdheve dhe kabineteve në disa shkolla me tepison/tepi për dysHEME-kontratë kornizë dy vjeçare,
- Furnizimi i IEA-së me perde (shiritore, rollne ose zebra mbajtës dhe perde për projektor),
- Rishpallje-instalimin e internetit në disa shkolla dhe shërbimet e rregullta mujore me internet (kontratë kornizë) për periudhën tre vjeçare,
- Renovimin eficientë të shkollave në: Rufc i Ri, Topliqan, Janjevë, Qylagë, Medvec, Kojskë, Shalë shkolla e mesme-kontratë dy vjeçare,
- Furnizimi i Çerdhës së re në Shalë me pajisje të ndryshme dhe inventar,
- Furnizimi me artikuj të ndryshëm për Çerdhën në Shalë,
- Furnizimi i Çeap “Çerdhja” në Lipjan me pemë dhe perime për periudhën tre mujore,
- Renovimi i shkollave në Shalë (fillore) dhe Sillovi-kontratë dy vjeçare,
- Trasporti i nxënësve të shkollave në relacionet vendbanim (fshat-lagje) deri në shkollë dhe anasjelltas-kontratë kornizë 2 vjeçare (17 loto),

- Transporti i nxënësve nga fshati Kojskë deri në Shfmu “Drita” Rubovc dhe anasjelltas-kontratë kornizë 2 vjeçare (lloto 6),
- Transporti i nxënësve në relacionin nga fshatrat Ribar i Vogël dhe Rufc i Vjetër deri në Shfmu “Migjeni” Rufc i Ri dhe anasjelltas-kontratë kornizë 2 vjeçare (lloto 3),
- Instalimi dhe monitorimi i sistemit të alarmit kundër thyerjes –vjedhjes në IEA-kontratë dy vjeçare,
- Renovimi i kulmit në Shfmu “Ernest Koliqi” në Babush i Muhaxherëve
- Është ndërtuar kulmi i shkollës në Shfmu “Emin Duraku” pnf në Bujari, dhe është ndërtuar kulmi në shkollën Shfmu “Skënderbeu” në Kraishtë.
- Furnizimin e Çerdhës me pajisje të ndryshme.

Kërkesë MASHT-it për:

- Shtimin e numrit të personelit në Çerdhet: Gadime, Sllovi, Shalë dhe Rufc,
- Furnizimin me inventar në Çerdhet: Gadime, Sllovi, Shalë dhe Rufc,
- Furnizimin e Gjmnazit “Ulpiana” në Lipjan me pajisje kabinetike: Fizikë, Kimi, Biologji dhe Matematikë,
- **Furnizimin me pajisje të mirëmbajtjes për disa shkolla të Komunës së Lipjanit:**
- **Furnizimin e disa shkollave në Komunën e Lipjanit me rekuizita sportive:**
- **Furnizimin e sallave sportive me pajisje sportive në shkollat:**
- **Furnizimin e shkollave me tabela digjitale dhe kabinete të Tik-ut,**
- Furnizimin e shkollave me kabinete të shkencave,
- Renovimin eficient të shkollës Rufc i Ri,
- Ndërtimin e shkollës së re në Lipjan dhe
- Ndërtimin e shkollës “Adem Gllavica” në Lipjan.
- Kërkesë MASHT-it dhe Ministrisë për komunitet dhe kthim për renovimin e shkollës fillore në Janjevë.

Vizita pune në:

Vizitë sistematike e punës në të gjitha shkollat e komunës së Lipjanit.

Është bërë sigurimi i transportit të nxënësve për 15 lloto në relacione të ndryshme duke përfshirë edhe nxënësit me nevoja të veçanta. Me këtë aktivitet prokurimi janë kryer shërbimet e transportit për këto vendbanime: Gadime, Sllovi, Lagja e Poturve, Janjevë dhe Teqe, Vrellë e Gadimes, Qallapek, Jeta e Re, Grackë e Vjeter, Hallaq i Madh, Hallaq i Vogël, Varigovc, Zllakuqan, Torinë, Lluga, Gllanicë, Dobrajë e vogël, Leletiq, Mirenë, Vrellë e Goleshit, Shalë, Shfmu “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan-për nxënësit e lagjës së Akllapit dhe lagjës së Konjuhut për nivelet 0-9, Shfmu “Drita” në Rubovc-për nxënësit e Kojskës dhe Shfmu “Migjeni” në Rufc i Ri – për nxënësit e Ribarit të Vogël dhe Rufcit të Vjetër, si dhe nxënësit me nevoja të veçanta në disa relacione.

Futja e buxhetit në programin qeveritar **BDMS-së**.

Është bërë furnizimi i të gjitha IEA-ve me:

- Dokumentacion pedagogjik (ditar, libra amë, fletore pune etj) dhe furnizime të zyrës.
- Është intervenuar në rregullimin e nxemjes në Banullë, Poturoc dhe Gjmnaz.

SFIDAT

- Zvogëlimi i numrit të nxënësve në disa shkolla,
- Risistemimi i punëtorëve arsimor të cilët humbin normat për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve,
- Rritja e numrit të rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, si pasojë e kësaj komisioni për vlerësimin e këtyre fëmijëve e ka të pamundur t’i vlerësoj të gjithë në kohë reale dhe
- Nevoja për angzhimin e asistentëve për nxënës me nevoja të veçanta ose realizimi i mundësisë për angzhimin e tepricës së mësuesve që mbesin pa vend pune në pozitën e asistentëve.

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Raporti vjetor 2024 i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport reflekton përpjekjet dhe arritjet e këtij drejtorati në zhvillimin e aktiviteteve kulturore, aktiviteteve rinore dhe ngjarjeve sportive të organizuara në këtë periudhë. Raporti paraqet një pasqyrë të plotë dhe objektive të kontributit të drejtoratit tonë në promovimin e kulturës, rinisë dhe sportit në komunitetin tonë gjatë vitit që lam pas.

Në kuadër të kompetencave tona kemi punuar sipas planit të punës dhe arritjes së objektivave dhe qëllimeve të drejtoratit, ku janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE NË MËNYRË KRONOLOGJIKE

Edhe në vitin 2024 kemi vazhduar me mbështetjen e të gjitha projekteve rinore e kulturore, që janë paraqitur në departamentin tonë, duke mos përjashtuar edhe mbështetjen financiare të ofruar për OJQ-të (klubet) sportive dhe kulturore gjatë vitit 2024.

Janë përgatitur plane dhe raporte si dhe kemi pranuar barazimet e subvencioneve për OJQ dhe Klube sportive për përfituesit e vitit 2022. Po ashtu kemi përgatitur raportin vjetor të Bibliotekës së Qytetit, për Bibliotekën Kombëtare, si dhe kemi hartuar orarin që klubet sportive ta shfrytëzojnë QAS-në, duke inkuadruar ekipet e reja.

- Jemi kujdesur për nderimin e të rënëve në ditët e tyre të rënjes më vendojen e kukorave të luleve pranë varreve dhe lapidarëve.
- Në 16 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, kemi organizuar aktivitete kulturore, rinore dhe sportive,
- Kemi organizuar akademi përkujtimore për Martirët e komunës së Lipjanit,
- Kemi organizuar aktivitete të ndryshme për shenimin e Ditës së Fëmijëve, Ditës së Çlirimit të Lipjanit dhe Ditës së Dëshmorëve (1 – 14 qershor)
- Kemi vazhduar edicionin e “Mergata Fest dhe Sports 2024”,
- Në rastin e Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, 12 gusht, është mbajtur festivali i të rinjve “Rinia Lipjan Fest 2024”
- Janë organizuar aktivitete për nder të shenimit të Ditëve të Nëntorit,
- Është mbajtur edicioni i pestë i festivalit të fëmijëve “Lipjani Këndon 2024”,
- Është bërë dekorimi i sheshit “Adem Jashari” për festat e fundvitit

Disa nga aktivitetet tjera që vlejné të përmenden janë edhe:

- Subvencionimi i botimit të librit,
- Organizimi i orëve letrare,
- Aktivitete dhe tryeza me të rinjë,
- Subvencionimi i të rinjve lipjanas që përfaqësonin Kosovën në Konferenca Ndërkombëtare për të Rinjë,
- Organizimi i ekspozitave, panaireve etj,
- Mbështetje financiare për organizimin e turnireve sportive për nderim të dëshmorëve,
- Mbështetje e vazhdueshme e klubeve sportive.

Aktivitetete konkrete:

“Mërgata Fest and Sports 2024”,
“Rinia Lipjan Fest 2024”,
Festivali për fëmijë “Lipjani Këndon 2024”,
Promovim i librit,
Shfaqje teatrale,
Kinematografi,
Expozitë me piktura,
Expozitë me fotografi,
Turne sportive:

Futboll,
Volejbol.

Gara sportive në disiplinë të ndryshme:

Shah,
Ping – pong,
Badminton,
Vrapim,
Basketboll,
Voleybeach, etj.
Festat shtetërore,
Koncerte festive,
Tryeza me të rinjë etj.

Investimet Kapitale

- Ka vazhduar Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Glllogovc,
- Ka vazhduar ndërtimi i ulseve për shikues dhe bari artificial në fushat e hapura sportive, në fshatrat e komunës së Lipjanit,
- Janë ndërtuar kabinat e lexuesve në Bibliotekën e Qytetit të Lipjanit,
- Është bërë inventarizimi i sallës së leximit dhe Arkivës së Qytetit,
- Ka përfunduar ndërtimi i fushës së hapur sportive në fshatin Rubofc,
- Ka vazhduar përfundimi i infrastrukturës së dy stadioneve në Dobrajë të Madhe dhe Magure,
- Është nisur procedura për ndërtimin e Qendrës Multifunksionale në Lipjan (ka mbetur projekti në OShP duke u ankuar operatorët ekonomik)

Subvencionet

1. Thirrje publike për Klubet dhe Shoqatat Sportive
2. Thirrje publike për mbështetje financiare të OJQ-ve, të cilat kontribuojnë në avansimin e kulturës dhe rinisë.
3. Thirrje publike për aktivitetet e 17 Shkurtit,
4. Thirrje publike për aktivitetet e 1, 12 dhe 14 qershor,
5. Thirrje publike për “Mergata Fest and Sports 2024”,
6. Thirrje publike për “Lipjani Këndon 2024”,
7. Subvencionime individuale,
8. Subvencionim i OJQ-ve lokale

SUBVENCIONET DHE KAPITALET E VITIT 2024 TË DKRS-SË

EMERTIMI I PROJEKTIT	PROCEDURA
NDERTIMI I QENDRES SE RE TE KULTURES	Në procedurë
FURNIZIMI DHE VENDOSJA ME BARI SINTETIK DHE INFRASTRUKTURA	Vazhdon
NDERTIMI I INFRASTRUKTURES NE SALLAT E SPORTEVE NE GLLOGOV	Vazhdon

LLOJI I SUBVENCIONEVE	VLERA
Subvencione për OJQ kulturore sipas thirrjes publike	48,000.00 euro
Subvencione për OJQ sportive sipas thirrjes publike	77,000.00 euro
Subvencione për OJQ jashtë thirrjes publike	14,700.00 euro
Subvencione për individ	64,745.00 euro
Totali:	204,445.00 euro

STATISTIKAT

Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Proces	Hedhur Poshtë	Pezulluar
199	152	30	17	0	0

Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)
164	130	746

Raport për Biblotekën e Qytetit në Lipjan, Gadime, Shalë

Lexues të rinjë	Përpunim i librit	Lexus në sallën e leximit	Libra të dhuruar
1202	2141	1202	1420

DISKUTIME PUBLIKE

- Diskutime publike për Planifikim të Buxhetit 2024 - 2026.
- Diskutim publik me Klubet Sportive,
- Diskutim publik me OJQ Rinore dhe Kulturore,
- Diskutim publik për hartimin e strategjisë kombëtare për të drejtat e fëmijëve.

DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Ky raport përfshinë të dhënat vjetore nga sektorët e Drejtoratit për Buxhet dhe Financa si:

- Sektori i Buxhetit dhe Financave duke përfshirë edhe të dhënat nga Regjistrimi i Pasurisë Komunale dhe Arka,
- Sektori i Thesarit dhe
- Sektori i Tatimit në Pronë.

STATISTIKAT

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

Përgaditja dhe Dorëzimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2023

Pasqyrat Fianciare janë përgatitur dhe dorëzuar në MF në Janar 2024, brenda afateve të përcaktuar kohore. Këto pasqyra kanë reflektuar një situatë reale mbi menaxhimin e buxhetit dhe menaxhimin financiar të Komunës së Lipjanit.

Dorëzimi i Planit të Punës për 2024

Plani i punës është dorëzuar në Janar të Vitit 2024 dhe ka përfshirë objektivat dhe aktivitetet e të tri sektorëve të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa për vitin 2024. Një ndër objektivat kryesore të këtij plani ka qenë transparenca dhe publikimi i të gjitha raporteve lidhur me menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit, raporteve rreth inkasimit të të hyrave vetanake dhe menaxhimin e pasurisë. Gjatë tërë vitit do të jemi në kontakt me zyrën për informim dhe kemi siguruar që këto raporte të jenë të publikuara në web faqen e Komunës që qytetarit të ketë qasje në shpenzimin dhe menaxhimin e parasë publike.

Dorëzimi i Raportit të Punës për vitin 2023

Raport i Punës për Vitin 2023 është dorëzuar në Janar të vitit 2024. Ky raport i përgjithësuar ka ofruar informacione rreth punëve me të cilat kanë qenë të ngarkuar të tri sektorët dhe ka ofruar një informacion të shpenzimit të buxhetit sipas burimeve të financimit dhe kategorive ekonomike, menaxhimit dhe inkasimit të të hyrave vetanake, menaxhimit të pasurisë, tatimin në pronë dhe pagesat e kryera nga sektori i thesarit.

Përgaditja e raportit vjetor për Asamblenë Komunale për Shpenzimin e Buxhetit 2023 dhe Realizimin e Të Hyrave Vetanake të planifikuara për Vitin 2023

Në mbledhjen e radhës të muajit Janar 2024 , Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka dorzuar në Asamblenë Komunale raportin vjetor mbi Shpenzimet e Buxhetit dhe Realizimin e të Hyrave Vetanake për vitin 2023, dhe është raportuar nga Drejtori për Buxhet dhe Financa.

Alokimi i mjeteve

Alokimi i mjeteve nga granti qeveritar (10) ka filluar në Shkurt 2024.Pas aprovimit të buxhetit alokimi i mjeteve në të gjitha kategoritë është bërë ashtu siç është kërkuar me planin e rrjedhës së parasë. Të gjitha Drejtoratet dhe ZKA janë njoftuar me kohë për alokimin e mjeteve me qëllim të incimit të kërkesave për zotim të mjeteve. Kërkesat mujore janë dërguar me rregull në Thesar Qendrorë për alokimin e të hyrave vetanake.

Zotimet e mjeteve

Në baza të rregullta është përcjellur rrjedha e zotimeve dhe shpenzimi i mjeteve në zotim. Më tutje, në mënyrë të rregullt i është raportuar menaxhmentit dhe drejtorive rreth gjendjes së mjeteve në zotim dhe shpenzimit të këtyre mjeteve. Zotimi i mjeteve ka filluar pas alokimit të buxhetit në Shkurt 2024. Zotimi për kategorinë pasuri jofinanciare(investime kapitale) është bërë nga muaji Shkurt 2024 deri më 31.10.2024 ku, bazuar në Rregullen për Përfundimin e Vitit Fiskal MF-Nr 02- 2014, është mbyllur afati për zotim të mjeteve në këtë kategori. Zotimi per kategorinë mallra dhe shërbime është bërë nga muaji Shkurt 2024 deri më 26.11.2024 ku, bazuar në Rregullen për Përfundimin e Vitit Fiskal MF-Nr 02- 2014, është mbyllur afati për zotim të mjeteve në këtë kategori. Zotimet për Kategoritë komunali dhe subvencione janë bërë prej muajit Shkurt 2024 deri më 12.12.2024 ku bazuar në Rregullën Finaciare për Përfundimin e Vitit Fiskal MF-Nr 02- 2014, është mbyllur afati për zotim të mjeteve në këto kategori. Sipas rregullores për përfundimin e vitit fiskal MF-Nr 02- 2014 afati i fundit për regjistrimin e pagesave ka qenë 26.12.2024, ndërsa, afati i fundit për certifikimin e pagesave ka qenë 26.12.2024.

Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenëzuara të vitit 2023 në vitin 2024

Është bërë alokimi (bartja) e të hyrave vetanake nga viti 2023 në vitin 2024, në mujin Prill 2024 në shumë prej 1,944,833.26€. Bartja e të Hyrave Vetanake nga viti 2023 në vitin 2024 është bërë në këto programe dhe kategori ekonomike.:

- Mallra dhe shpenzime..... 24,999.99€
- Shpenzime komunale..... 43,005.07€
- Subvencione dhe transfere..... 19,784.91€
- Pasuritë jofinanciare..... 1,857,043.29€

Pranimi i Qarkores së Parë Buxhetore

Qarkorja e parë buxhetore na është doërguar nga MF në Maj 2024 e cila ka pasë për qëllim ofrimin e kufijve fillestarë të financimit të Buxhetit, afatet kohore për përgatitjen e buxhetit të propozuar komunal dhe kërkesat për ndarjet buxhetore për vitet 2025-2027.

Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

Që nga Pranimi i Qarkores së Parë Buxhetore është punuar në zhvillimin dhe përpilimin e KAB-it. 2025-2027. Përveç kësaj janë shqyrtuar prioritetet e Buxhetit Komunal, duke punuar me Drejtoratet në vendosjen e kufijve të brendshëm buxhetorë në përputhje me Financimi Komunal me Qarkoren e Parë Buxhetore. Në KAB-in 2025-2027 janë planifikuar shpenzimet e përgjithshme Komunale 2025-2027 sipas kategorive ekonomike. Pas konsultimeve të shumta me drejtorët e drejtorive hollësisht janë analizuar investimet të cilat do të bëhen në vitin 2025-2027. Gjatë muajit Qershor 2024 KAB-i është analizuar në strukturat Komunale dhe është prezantuar në Bordin e Drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete dhe strukturat e grupet tjera. Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2025-2027 është aprovuar në Asamblenë Komunale në Qershor 2024.

Qarkorja e Dytë Buxhetore

Qarkorja e Dytë Buxhetore është pranuar nga Ministria e Financave në Gusht 2024. Kjo qarkore është shpërndarë te Drejtoritë Komunale të angazhuara në hartimin e Buxhetit 2025-2027.

Sipas Qarkores Buxhetore , struktura e shpenzimeve për Buxhetin Komunal për vitin 2025 ka qenë si vijon:Buxheti për vitet 2025-2027 do të financohet:

FONDI BURIMOR	VITI 2025	VITI 2027	VITI 2028
Granti i Përgjithshëm	9,661,940.00	10,223,813.00	10,795,933.00
Granti specifik i Arsimit	8,837,533.00	9,102,659.00	9,375,739.00
Granti specifik i Shendetësisë	3,023,518.00	3,167,438.00	3,318,208.00

Të hyrat vetanake	3,174,047.00	3,421,933.00	3,675,284.00
Sherbimet Rezidenciale	200,000.00	200,000.00	230,000.00
Gjithësejt:	24,897,038.00	26,115,843.00	27,395,164.00

Mjetet financiare shpërdahen në kategorit ekonomike si vijon:

KATEGORITE EKONOMIKE	VITI 2025	VITI 2027	VITI 2028
Paga e Mëditje	12,779,219.00	13,482,076.00	14,196,626.00
Mallra dhe Shërbime	3,761,000.00	3,836,220.00	3,912,944.00
Shërbime Komunale(Komunalit)	450,000.00	470,250.00	493,763.00
Subvencione dhe Transfere	1,120,000.00	1,176,000.00	1,270,080.00
Investime Kapitale	6,786,819.00	7,151,296.00	7,521,750.00
TOTALI	24,897,038.00	26,115,843.00	27,395,163.00

Përgaditja, Planifikimi dhe Aprovimi i Buxhetit 2025-2027

Buxheti i planifikuar për vitet 2025-2027 është dorëzuar në seancën e Kuvendin Komunal në muajin Shtator brenda aftatit kohor, është aprovuar nga Kuvendi iKomunës së Lipjanit, ku i njeiti është dorëzuar në Ministrinë e Financave. Sipas procedurave të dhënat nga planifikimi buxhetor janë futur në sistemin e BDMS dhe PIP.

Buxheti i planifikuar Komual, i aprovuar në Shtator te vitit 2024, për vitin 2025 ka qenë 24,897,038.00€. Në ndarjen e planifikuar të buxhetit sipas fondeve burimore pjesëmarrja e grantit qeveritar ka qenë në përqindje 87.25%, ndërsa pjesëmarrja e planifikuar e të hyrave vetanake në buxhetin e Komunës ka qenë 3,174,047.00€, në përqindje 12.75%.

Ashtu siq kërkohet me Qarkore Buxhetore, në Ministrinë e Financave janë dorëzuar këto dokumente:

- Shkresa përcjellëse, e nënshkruar nga Kryetari i Komunës, bazuar në Aprovimin e Buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitet 2025-2027.
- Vendimi i Kuvendit Komunal mbi Miratimin e Buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitet 2025-2027.
- Tabelat e Buxhetit Komunal BDMS dhe PIP:
- Tabela 4.1, e shtypur nga BDMS dhe e nënshkruar, e cila përfshinë Planin e Ndarjeve Buxhetore, të Shpenzimeve Totale të Komunës për Vitet 2025-2027.
- Tabela 4.2, e shtypur nga Sistemi PIP dhe e nënshkruar, e cila përmbanë financimin vjetor të projekteve Kapitale për vitet 2025-2027.
- Tabelen 4.3, e shtypur nga BDMS dhe e nënshkruar, e cila përmban planin afatmesëm të të hyrave totale të Buxhetit Komunal.

Raportimet Periodike për shpenzimin e Buxhetit të vitit 2024

Duke u bazuar në raportin përmbledhës nga Free Balanc-it kemi përpiluar raportet përmbledhëse për realizimin e Buxhetit Komunal dhe kemi raportuar në baza të rregullta te ZKA dhe te secili drejtorat. Raportimet periodike të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa janë bërë si vijon:

- Raportet javore për realizimin e Buxhetit Komunal dhe aktivitetet gjatë periudhës raportuese.
- Raportet mujore të cilat jan publikuar në Web-faqen e Komunës së Lipjanit, raportet mujore për obligimet financiare të raportuara në MF.
- Raporti tre mujore, gjashtë mujor, nëntë mujor i shpenzimit të buxhetit, të hyrave vetanake dhe realizimit të projekteve kapitale, raportuar në Kuvendin Komunal
- Raporti Vjetor për Kuvendin Komunal dhe për Kryetarin e Komunës.

Raporti vjetor i buxhetit dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve, kategorive ekonomike dhe programeve për vitin 2024 për Komunën e Lipjanit

2.		Rrjeti i ujësjellësit në pjesë të caktuara të zonave në qytetin e Lipjanit	Lipjan	Finalizuar
3.		Ndertimi i rrjetit të kanalizimit dhe asfaltimi i rrugicave në vendbaniminin Kleçkë.	Kleçkë	Finalizuar

4		Ndërtimi i parkut në Magure	Magure	Finalizuar
D.	INFRASTRUKURË SHOQËRORE - SOCIALE			
1.	Hartimi i dokumentacionit teknik	Fusha e Futbollit Magure/ Rindërtim	Magure	Finalizuar
2.		Fusha e Futbollit Dobrajë e Madhe –Rindërtim	Dobrajë e Madhe	Finalizuar
3.		Rrënimi i objekteve ekzistuese në Magure	Magure	Finalizuar
4.		Rregullimi i kulmit të ndërtesës “Shpresa” në Lipjan	Lipjan	Finalizuar
5.		Projekti i rrënitimit të objektit B+ P+1- te tregu i gjelbër	Lipjan	Finalizuar
6.		Projekti për ndërtimin e tregut ditor	Lipjan	Finalizuar
7.		Renovimi i AMF Smallushë	Smallushë	Finalizuar
8.		Ndarja e kthinave në objektin Administrativ - Lipjan	Lipjan	Finalizuar
9.		Qendra kulturore	Lipjan	Finalizuar
10.		Infrastruktura në lokacionin e shkollës Rufc i Ri	Rufc i Ri	Finalizuar
11.		Rrënimi i objekteve shkollore në Lipjan dhe Resinoc	Lipjan , Resinoc	Finalizuar
12.		Renovimi i Shtëpisë me bazë në komunitet	Lipjan	Finalizuar
13.		Renovimi i shkollës në Bujan	Bujan	Finalizuar
14.		Renovimi i Shkollës në Sllovi /elektrika	Sllovi	Finalizuar
15.		Ndërtimi i Qerdhes në Magure	Magure	Në proces
16.		Ndërtimi i Qerdhes në Banullë	Banullë	Në proces

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE VJETORE NË FUSHËN E URBANIZMIT

Në kuadër të këtyre objektivave, DPUMM ka zhvilluar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për shqyrtimin e kërkesave të ndryshme të parashtruara nga palët, si dhe ka kryer aktivitete të tjera të caktuara.

Nga viti 2023 në vitin raportues janë bartur 104 lëndë, kurse gjatë vitit 2024 janë pranuar edhe 723 lëndë të natyrave të ndryshme. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve prej 827 janë shqyrtuar 808 apo 97.7%. Prej tyre janë miratuar gjithsejtë 513 lëndë, të refuzuara 230, në listë të pritjes 12³, të pezulluara 3⁴, të ceduara 47 dhe pushim i procedures 3, ndërsa 19 lëndë barten në vitin 2025, prej tyre vetëm 1 në proces të legalizimit. Shqyrtimi i lëndëve nga fusha e urbanizmit paraqitet në tabelen në vijim. Në këtë tabelë nuk janë përfshirë lëndët për legalizim.

Shqyrtimi i lëndëve në fushën e urbanizmit

Nr.	Llojet e kërkesave	Kërkesa të pranuar në 2024	Kërkesa të bartura nga 2023	Të pezullu.	Miratu.	Refuz.	Pushim i proced.	ceduar	Në proces
1.	Kushte ndërtimore	129	8	1	74	55		2	5
2.	Leje ndërtimi	94	8		70	25	1		6
3.	Leje, objekte të përkohshme, renovime, infrastrukturë	37			18	18		1	
4.	Leje rrënimi	21	2		16	6		1	
5.	Certifikatë perdorimi	7	5	2	10	2			
6.	LMK	64	2		45	13	2	1	5
5.	Emërtim rruge, adresa	12						12	-
6.	Infrormacione urbane	80	2		77	4			1
7.	Akte nga MMPHI	39	3		22	3		17	
8.	Bashkim/ndarje e parceles	2			1				1
9.	Kërkesa nga drejtoratet tjera	34		1	32			1	
10.	Të tjera	131	1	1	99	20		12	
	Totali	650 ⁵	31 ⁶	3	460	146	3	47	18

Gjithsejtë lëndët e pranuar dhe shqyrtuara në vitin 2024

Lëndë të pranuar në vitin 2024	Të bartura nga v. 2023	Gjithsejtë lëndë në vitin 2024	Të shqyrtuara në vitin 2024	Përqindja	Të bartura në vitin 2025
723	104	827	808	97.7	19

Lëndët e pranuar dhe shqyrtuara në vitin 2023 – për qëllime krahasimi

Lëndë të pranuar në vitin 2023	Të bartura nga v. 2022	Gjithsejtë lëndë në vitin 2023	Të shqyrtuara në vitin 2023	Përqindja	Të bartura në vitin 2024
679	138	817	713	87.27%	104

Duhet theksuar se përkundër kapaciteteve të pamjaftueshme njerëzore (2 pozita pune të pambuluara) në periudhen e vitit 2024 janë shqyrtuar 808 kërkesa krahasuar me 713 kërkesa të trajtuara në periudhen e njejtë të vitit 2023. Kjo ka ndikuar që shqyrtimi i lëndëve të arrij shifren e përgjithshme prej 97.7%. Vlerësojm se kishte një efikasitet të mirë në shqyrtimin e kërkesave, kurse mbetja prej 19 lëndëve për vitin vijues ka të bëjë me lëndët e pranuar gjatë muajit dhjetor.

Trajtimi specifik i kërkesave për leje ndërtimore - 2024:

Kateg. e ndërtimeve	Kërkesa të pranuar	Nr. i lejeve	Destinimi			Në qytetin e Lipjanit
			Banim	Afariste	Tjera	
I.	42	32	17	15		13
II.	60	38	16	19 ⁷	4 ⁸	6 + 3
Gjithsejtë	102 ⁹	70	33	34	4	

Në vitin 2024 janë pranuar 94 kërkesa për leje ndërtimi të kategorive të ndryshme dhe 8 të tjera kanë qenë të bartura nga viti paraprak. Prej 102 lëndëve, janë shqyrtuar 96 lëndë apo 94.11%. Të miratuara janë 70 leje ndërtimi apo 73% krahasuar me numrin e kërkesave të shqyrtuara. Të kategorisë së I-rë janë 32 lëndë dhe 38 të kategorisë së II-të. Numri i ndërtesave për banim dhe atyre afariste është i përafërt. Kjo tregon se investimet në fushen e banimit edhe më tutje janë tejet të larta.

Sipërfaqja tokësore në m2 ku janë dhënë lejet ndërtimore – 2024:

Kategoria	Jashtë qytetit		Vetëm në Lipjan		Gjithsejtë	
	Banim	Afarizëm	banim	Afarizëm	banim	Afarizëm
Kat. I	4564	17282	6492	8014	11056	25296
Kat. II	-	190156	104204	76754 ¹⁰	104204	266910
Gjithsejtë	4564	207438	110696	87468	115260	292206

Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtesave në m2 ku janë dhënë lejet ndërtimore - 2024:

Kategoria	Sip.banimi m2	Sip.afariste m2	Vetëm në Lipjan		Gjithsejtë	
			banim	Afarizëm	banim	Afarizëm
Kat. I	1315.64	7033.09	3261.27	3194.94	4576.91	10228.03
Kat. II	-	26777.51	119891.80	16496.41	119891.80	43273.92
Gjithsejtë	1315.64	33810.60	123153.07	19691.35	124468.71	53501.95

Shuma prej 119891.80 m2 të ndërtesave të banimit përfshinë edhe hapësirën afarsiste në katin përdhesë dhe bodrumin. Nga kjo kategori hapësirë neto e banimit është 71118.016 m2.

Në një leje të kategorisë së II-të (afariste) në sipërfaqe tokësore prej 104869 m2 përfshihet vendosja e paneleve solare, prandaj e tërë sipërfaqja tokësore është e shfrytëzuar.

Nisur nga kjo analizë, në vitin 2024 janë shfrytëzuar për ndërtim gjithsejtë 407466 m2 apo 40 hektar e 74 ari sipërfaqe tokësore. Nga kjo sipërfaqe për banim janë shfrytëzuar 115260 m2 apo 11 hektar 52 ari e 60 m2, kurse për afarizëm 292206 m2 apo 29 hektar e 22 ari.

Zona e lejuar për ndërtim në territorin e Komunës së Lipjanit është 5233.73 hektar. Dhënia e lejeve ndërtimore në sipërfaqen e caktuar përfshinë sipërfaqen tokësore të lejuar për ndërtim prej 0.78%.

Në këto të dhëna nuk përfshihen ndërtimet pa leje, për të cilat nuk ka të dhëna DPUMM.

Inspektimi i ndërtimeve gjatë ekzekutimit është përgjegjësi e Drejtoratit të Inspektoratit.

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE NË PROCESIN E LEGALIZIMIT TË OBJEKTEVE PA LEJE NDËRTIMI

Në kuadër të këtyre objektivave, DPUMM ka zhvilluar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për shqyrtimin e kërkesave për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi.

Gjatë vitit 2024 në procedurë shqyrtimi kanë qenë 146 lëndë për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi. Të bartura nga viti 2023 ishin 73 lëndë, kurse gjatë viti 2024 janë pranuar 73 lëndë.

Krahasuar me vitin paraprak 2023 ku ishin shqyrtuar 66 lëndë, në vitin 2024 janë shqyrtuar 145 lëndë dhe 1 është në proces.

Të gjitha lëndët e pranura gjatë vitit 2024 janë shqyrtuar brenda afateve ligjore.

Statusi i shqyrtimit të lëndëve paraqitet në tabelen në vijim:

Lëndët e pranura dhe shqyrtuara

Nr.	Lëndë legalizimi	Pranuar në 2024	Bartur nga 2023	Miratur	Listë të pritjes	Refuz.	Pezull.	Procedurë
1.	146	73	73	49	12	84	-	1

Duhet theksuar se shqyrtimi intenziv i kërkesave për legalizim ka filluar nga muaji tetor i vitit 2023 – ku në këtë kohë kanë filluar punën dy punonjëse me angazhim të përkohshëm (24 muaj). Përkundër vështirësive me shqyrtimin e disa kërkesa të parashtruara para disa vitesh, vlerësojmë se tani procesi i shqyrtimit të kërkesave është në rrjedhë normale.

Karakteristikë e veçantë të shumica absolute e kërkesave për legalizim është dokumentacioni i pa kompletuar, dhe çështjet e pa rregulluara pronësore. Dokumentacioni i pakompletuar ndikon në kohën që duhet shpenzuar për ato kërkesa.

Në 14 raste janë parashtruar Ankesa në DPUMM ndaj Vendimeve për refuzimin e dhënies së certifikates së legalizimit. Të gjitha ankesat janë shqyrtuar brënda afateve ligjore dhe me vendimet përkatëse janë njoftuar parashtruesit e tyre.

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE NË FUSHËN E BANIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Në kuadër të objektivave vjetore në fushën e banimit dhe mbrojtjes së mjedisit janë realizuar këto aktivitete:

Në fushën e banimit, **përkatësisht sistemit të adresave** ka filluar aktiviteti i regjistrimit zyrtar të adresave. Lidhur me këtë Agjencia Kadastrale e Kosovës përmes Bankës Botërore ka angazhuar 2 punonjës për një periudhë të caktuar 11 mujore.

Lejet mjedisore komunale të lëshuara

Sipas legjislacionit në fuqi Lejet mjedisore komunale (LMK) lëshohen për një numër të caktuar të objekteve të kategorisë së II-të. Gjatë vitit 2024 janë lëshuar 45 LMK.

Lëndët e pranura dhe shqyrtuara në procesin e legalizimit

LMK-gjithsejtë	Afariste	Afariste -banesore	Ferma të shpezëve	Stacione të tel. mobile
45	25	16	2	2

Në shqyrtimin e lëndëve për leje mjedisore komunale trajtohen aspektet si: identifikimi i ndikimeve në mjedis në tokë, ajër, ujë, florë dhe faunë, gjenerimi i mbeturinave dhe grumbullimi tyre, zhurma, procesi teknologjik i punës, masat në raste të aksidentit,

masat për rehabilitimin e sipërfaqës gjelbëruese si dhe masat për efikasitetin e energjisë. Po ashtu caktohet lokacioni i kontejnerëve në situacion, sipërfaqja e gjelbërt, mbjellja dhe lokacionet e drunjëve etj.

Me qëllim që këto ndikime të kontrollohen kurse ato negative të mund të zvogëlohen në nivel të “pranueshëm”, synohet edhe rehabilitimi i hapësirave të degraduara gjatë ndërtimit dhe realizimit të projekteve të ndryshme.

Gjatë këtij viti zyrtari për mbrojtje të mjedisit ka marrë pjesë në seminare dhe takime të ndryshme të organizuara nga institucione vendore e ndërkombëtare si:

- Punëtorinë me tematikë “Lejet Mjedisore dhe Ujore” (sfidat, praktikat dhe mundësitë).
- Puntorinë të organizuar nga MMPHI dhe organizata mejedisore Sllovene WWF me tematikë “Lidhshmëria ekologjike në Kosovë”.
- Punëtoritë e Ekipit Teknik për Bashkëpunimin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të mbeturinave organizuar nga GIZ dhe MMPHI me komunat.
- Takimet për Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Republikën e Kosovës 2024-2035 dhe Planin e Veprimit 2024-2026 organizuar nga JICA dhe AMMK me komunat.
- Pjesëmarrja në takimet të cilat janë të lidhura me mjedisin si ato për efikasitetin e Energjisë.
- Janë zhvilluar aktivitete vëzhguese mbi faktorët e ndotjes së mjedisit natyror gjatë javës së Tokës.
- Kemi organizuar dhe shënuar ditën ndërkombëtare të “Pastrimit” me datën 20 shtator 2024.
- Në fushën e Mjedisit po ashtu kemi bërë identifikimin në terren të deponive ilegale të mbeturinave dhe i kemi digjitalizuar në sistem GIS që rezultojnë 77. Duke mos i përfshirë 11 prej tyre të cilat janë pastruar si pjesë e projekteve të komunës.

Të dhënat për numrin e zbatimit të LMK-ve, duhet t’i prezantoj Drejtorati i Inspektoratit.

Realizimi i objektivave në fushën e banimit dhe mbrojtjes

Në kuadër të shënimit të Dites së Tokës me 22 prill 2024 është realizuar java e tokës me aktivitetet që përkojnë me këtë ditë.

Me datën 23 prill 2024 është prezantuar studimi me organizatën Sllovene WWF dhe Agjencia e Pyjeve Sllovene lidhur me "Lidhshmërinë ekologjike në Kosovë", duke theksuar të gjeturat e këtyre korridoreve të lidhjes së faunës shqiptare, barrierat dhe lokacionet për lidhshmërinë e tyre.

Me 24 Prill 2024 – kemi pjesë në aktivitetet e organizuara nga OJQ GAC në bashkëpunim me Eko Klubeet e shkollave dhe institucionet komunale mes shkollës së Mesme Adem Gllavica dhe OJQ GAC për mbjelljen e drunjëve në oborrin e shkollës. Po ashtu u organizua aktiviteti në qendrën e qytetit të Lipjanit “Planeti kundrejt Plastikës”, me qëllim ndërgjegjësimin për ndotjen nga plastika.

DPUMM ka qenë i angazhuar në projektin e nivelit kombëtar “Menaxhimi i mbeturinave” – projekt i cili i mbështetë komunat lidhur me hartimin e planeve për menaxhimin e mbeturinave.

Gjatë këtij viti zyrtari për mbrojtje të mjedisit ka marrë pjesë në seminare dhe takime të ndryshme të organizuara nga institucione vendore e ndërkombëtare si:

- Punëtorinë me tematikë “Lejet Mjedisore dhe Ujore” (sfidat, praktikat dhe mundësitë).
- Puntorinë të organizuar nga MMPHI dhe organizata mejedisore Sllovene WWF me tematikë “Lidhshmëria ekologjike në Kosovë”.
- Punëtoritë e Ekipit Teknik për Bashkëpunimin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të mbeturinave organizuar nga GIZ dhe MMPHI me komunat.

- Takimet për Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Republikën e Kosovës 2024-2035 dhe Planin e Veprimit 2024-2026 organizuar nga JICA dhe AMMK me komunat.

- Pjesëmarrja në takimet të cilat janë të lidhura me mjedisin si ato për efikasitet të Energjisë.

- Janë zhvilluar aktivitete vëditëse mbi faktorët e ndotjes së mjedisit natyror gjatë javës së Tokës.

- Në fushën e Mjedisit po ashtu kemi bërë identifikimin në terren të deponive ilegale të mbeturinave dhe i kemi digjitalizuar në sistem GIS që rezultojnë 77. Duke mos përfshi 11 prej tyre të cilat janë pastruar si pjesë e projekteve të komunës.

KRYERJA E DETYRAVE

Aktivitetet e caktuara janë realizuar në një masë të konsiderueshme dhe vlerësojmë se janë realizuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Arritja themelore në fushën e urbanizmit është shqyrtimi me kohë (brenda afateve ligjore) i të gjitha lëndëve të pranuar. Janë bartur në vitin 2025 vetëm lëndët që janë pranuar ditëve të fundit dhe të gjitha ato janë brenda afateve ligjore për shqyrtim. Po ashtu kemi arritur t'i shqyrtojmë të gjitha lëndët për legalizim.

Megjithatë, nuk kemi arritur të realizojmë të gjitha detyrat e planifikuara për vitin 2024.

Detyrat themelore të pa realizuara

Në kuadër të planifikimit hapësinor nuk është përfunduar dhe miratuar Planin Zhvillimor Komunal, për shkaqet e theksuara më lartë.

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit nuk kemi arritur të hartojmë dhe miratojmë Planin Lokal të Veprimit në Mjedis. Edhe ky projekt është i lidhur me "fatin" e Planit Zhvillimor Komunal.

KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA

Në kryerjen e aktiviteteve të caktuara, DPUMM ka komunikuar me palët sipas interesimit të tyre dhe në raste të caktuara, palët janë ftuar për shqyrtimin e çështjeve të ndryshme lidhur me kërkesat e parashtruara.

Në faqen zyrtare të internetit janë publikuar format e kërkesave të nevojshme që parashtrohen nga palët dhe informacione të tjera nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit. Po ashtu janë të publikuara edhe aktet përkatëse nënligjore që ndërlidhen me planifikimin urban dhe çështjet e ndërtimeve.

Puna e DPUMM është e hapur dhe aktet e duhura janë publikuar në faqen zyrtare të internetit. DPUMM përmes njësisë përkatëse iu ka përgjigjur të gjitha kërkesave për qasje në dokumente zyrtare.

Po ashtu në kuadër të detyrave të caktuara, DPUMM ka zhvilluar disa aktivitete në bashkëpunim me njësitë tjera organizative të Komunës dhe në formë të hapur për publikun.

DPUMM i ka të publikuara në faqen zyrtare të Komunës të gjitha dokumentet planore, formularët për aplikim për çështje urbane së bashku me udhëzimet përkatëse dhe po ashtu publikon për çdo vit listen e lejeve të lëshuara ndërtimore.

DREJTORATI PËR GJEODEZI DHE KADASTËR

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë – Zyra komunale Kadastrale e Komunës së Lipjanit, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarët, duke ofruar informacione dhe azhurnime të ndryshme sipas detyrës zyrtare.

Sektori i Gjeodezisë

Në sektorin e gjeodezisë në vitin 2024 kemi pasur shumë kërkesa nga persona fizik për realizimin e punëve gjeodezike si: regjistrimi ndarjeve , bashkim i parcelave dhe punë tjera ku jemi munduar që me mundësitë ti kryekmë kërkesat e tyre, ku janë kryesisht ndarja e parcelave që personat e ndryshëm ti kryejnë trashëgimitë për rregullimin e qështjeve që lidhen me pronën e paluajtshme

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Të pranuara	Nga viti paraprak	Gjithsej	Të miratuara	Të refuzuara	Të pezulluara	Gjithsej
938	-	938	933	5	25	963

KRYERJA E PUNËVE TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Kopje Plani	1757	
2	Konsultime me palë	356	
3	Marrje e produkteve	931	

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Në tabelen e poshtëshënuar janë paraqitur punët e kryera ne formën tabelare, nga të gjitha punët e kryera gjatë vitit 2024.

Nr.	EMËRTIMI I PUNËS	NR. I LËNDËVE	SHËNIM(vërejtje)
1	Ndarje të parcelave(regjistrim i ndarjeve)	822	në zyrë
2	Punë për shërbimin pronsor- juridik	34	në terren
3	Rirregullim kufiri	5	në zyrë
4	Ndërrimi kultures së parcelave	9	në zyrë
5	Regjistrim I ndertesave	15	në zyrë
8	Bashkim i parcelave	38	në zyrë
9	Regjistrimi i pjesëve të ndërtesave	10	në terren

Sektori Kadastri

Të dhënat dhe aktivitetet të cilat janë kryer gjatë vitit 2024 janë të prezentuara në formë tabelare.

Nr.	Llojet e kërkesave	Nr. i kërkesave të pranuara gjatë këtij viti	Nr. i kërkesave nga viti i kaluar	Të pezulluara	Të miratuara (kryera)	Të refuzuara	Në procedurë
1	Regjistrim prone	2262	-	-	2142	4	116
2	Regjistrim dhe fshirje të Hipotekave	233	-	-	229	2	2
3	Të tjera, Historiat,modifikim i te dhenave,regjistrim i mase se perkohshme	414	-	-	406	3	5
4	Çertifikata të Pronësisë	5305	-	-	5305	-	-
5	Vërtetime për raste sociale	4162	-	-	4162	-	-
6	Njoftim per palen e interesuar lidhur me te dhenat kadastrale	55		-	55-	-	-
7	Gjithsej:	12431		-	12299	9	123

Raporti I lëndëve të regjistruara sipas gjinisë për vitin 2024

Bashkëshortë	Burra	Gra	Persona Juridik
421	1.638	199	4

Gjatë vitit 2024 janë paraqitur numër i madhe i kërkesave për tu shqyrtuar. Në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, kemi pranuar dhe shqyrtuar këtë numër të lëndëve **16.413** Sfidues ka qenë edhe këtë vitë numri I vogël i zyrtarëve që kanë ofruar shërbime për qytetar në krahasim me numrin e kërkesave.

Bashkëpunimet

Gjatë periudhës së vitit 2024 kemi pasur bashkëpunime me institucione dhe organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare; me zyrtarët e Agjensionit kadastral kemi mbajtur takime të rregullta për avancimin e punës profesionale në drejtorat. Gjatë këtij viti kemi mbajtur takime të rregullta edhe me zyrtar të organizatave të ndryshme.

DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave të Drejtoratit për Infrastrukturë gjatë periudhës prej datës 01.01.2024 deri 31.12.2024, DI ka kryer aktivitetet të planifikuara dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara. Drejtorati për Infrastrukturë gjatë kësaj periudhe ka pranuar dhe zgjidhur këto kërkesa:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuara	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
221	51	100	45	25

Gjatë kësaj periudhe **Janar – Dhjetor 2024**, Departamenti për Infrastrukturë ka përgaditur dhe proceduar në Departamentin e Prokurimit për të publikuar projektet e planifikuara në kuadër të Departamentit për Infrastrukturë, si dhe ka përgaditur paramasat dhe parallogaritë për projekte të cilat janë në kuadër të Departamenteve tjera.

Përveq projekteve të parapara në buxhetin e Komunës për vitin 2024 Drejtoria për Infrastrukturë gjatë kësaj periudhe ka paraqitur kërkesa në Ministrit përkatëse dhe institucione tjera për projekte me bashkëfinancim siç janë:

- 1. Ndërtimi I rrugës Topliqan-Kojnsk
- 2. Ndërtimi I Urës mbi Lumin Sitnica
- 3. Asfaltimi I rrugicave në lagjët e fshatrave: Krojmir, Kraisht, Vërrshevc, Poturovc, Llugagji, Gumnasell, Magure, Torinë, Glllogovc, Konjuh
- 4. Vazhdimi I Ndërtimit të shtratit të lumit në fshatin Gadime e Epërme
- 5. Vazhdimi I ndërtimit të shtratit të Lumit në fshatin Gadime e Ulët.
- 6. Vazhdimi I ndërtimit të shtartit të lumit në fshatin Smallushë.
- 7. Rikonstruimi I rrugës Lipjan – Rubovc
- 8. Rikonstruimi I rrugës Ribar I Vogël - Ribar I Madh
- 9. Rikonstruimi I rrugës Poturovc Ribar I Madh
- 10. Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Medvec faza II
- 11. Mbjellja e drunjeve dekorativ në Qytetin e Lipjanit dhe në fashatra

Memorandumet

Kryetari i Komunës ka nënshkruar Memorandum bashkëfinancimi me: **MMPHI** në vlerë prej **370.000.00 Euro** për projektin: **Ndërtimi i Urës mbi Lumin Sitnic** Ndërsa Komuna e Lipajnit do të participoj në vlerë prej **30,000.00 Euro**.

Fondi per eficiencë të Energjis (FKKE) ne vlerë prej 233.530,00 Euro,

Ndersa Komuna e Lipjanit do te participoj 23.353,00 Euro

Ka përfunduar Memorandumi me MZHR “Rehabilitimi i qendrës kulturore në Janjevë” në vlerë **250,000.00 Euro** të ndara në dy vite 2023 - 2024. Në këtë projekt me marrëveshje bashkëfinancimi Komuna e Lipjanit do të participoj në vlerë prej **200,000.00 Euro** të ndara në dy vite.

Ecuria e projekteve

Gjate kësaj periudhe kanë vazhduar punimet në projektet të cilat i kemi lidhur kontratat në vitin 2023, Ndërsa projektet për të cilat kemi lidh kontrat në vitin 2024 kanë përfunduar punimet në projektet te cilat kan qenë nje vjeqare, ndersa ato projekte që jan dy vjeqare do të vazhdojn punimet edhe në vitin 2025.

Lista e projekteve nga Drejtoria për Infrastrukturë

1	Ndërtimi I trotuarit në rrugën Gadime-Llugaxhi	I përfunduar
2	Ndërtimi I trotuarit në Krojmir	I përfunduar
3	Anekse të rrjetit të Kanalizimit në Lipjan, Aklap, Krojmir, Rubovc, Sllovi, Grackë,Mirenë,Babushë	I përfunduar
4	Asfaltimi I rrugicave në Krojmir, Shalë, Resinoc, Qylagë, Magure,Vërshevc, Baic,Kraishtë Faza III	I përfunduar
5	Asfaltimi I rrugicave në Sllovi	I përfunduar
6	Asfaltimi I rrugicave në Krojmir, Shalë, Resinoc, Qylagë, Magure,Vërshevc, Baic , Ribar I Madh, Gumnasell	I përfunduar
7	Ndërtimi I rrugës së Lumit deri tek Rruga e Shkupit	I përfunduar
8	Asfaltimi I rrugicave në Krojmir, Shalë, Resinoc, Qylagë, Magure,Vërshevc, Baic , Kraishtë	I përfunduar
9	Ndërtimi I nënkalimit dhe vazhdimi I ndërtimit të sheshit dhe Ndërtimi I parkut qendror të qytetit dhe Parkingut nëntoksor në Lipjan	Në implimentim
10	Hapja dhe ndërtimi i rrugëve të reja brenda në Qytetin e Lipjanit (Rruga Arfim Zhitia, Rr.Bashkim Krasniqi-te rr.Haradin Bajrami- rr.Haxhi Kleqka,	I përfunduar
11	Ndërtimi I rrugëve në lagjet e fshatrave Sllovi, Gadime,Smallush ,Gomaselle,Llugaxhi,Babushë.	I përfunduar
12	Ndërtimi I rrjetit te kanalizimit dhe asfaltimi I rrugicave në Kleqk	Në implimentim
13	Rehabilitimi I infrastrukturës në Janjevë	I përfunduar
14	Rikonstruimi I rrugës Fehmi Agani	I përfunduar
15	Rikonstruimi I rrugës së shkollës në Dobraj të Madhe dhe rrugicat tjera	Në implimentim
16	Aneks të rrjetit te ujësjellsit në Lipjan, Sllovi	Në implimentim
17	Asfaltimi I rrugicave në fshatin Korjmir, Kraisht dhe Asfaltimi I rrugës me Trotuar në fshatin Zllakuqan faza V	I përfunduar
18	Ndërtimi I Urave në fshatarat Aklap, Janjev, Banull faza III	I përfunduar
19	Renovimi i objektit shte te Komunes (Baraka) renovimi adabtimi i zyreve per nevoja te sherbyesve civil	I përfunduar
20	Ndërimi I infrastrukturës së memorialit I UCK në fshatin Shalë	I përfunduar

Lista e projekteve nga Departamentet tjera e që menaxhohen nga Departamenti për Infrastrukturë

1	Ndërtimi i qendrës urgjente në Qytetin e Lipjanit dhe QKMF	Në Implimentim
2	Ndërtimi I ulseve për shikues dhe vendosja e barit articial në fushat e hapura sportive në fshatrat Kraishtë, Ribar I Madh, Smallushë, Rufc, Gadime e Ulët, Sllovi	I përfunduar
3	Ndërtimi I Qendrës multifunkionale në qytetin e Lipjanit	Në procedur të prokurimit
4	Furnizimi dhe vendosja me bari sintetik dhe infrastruktura tjetër në fushat sportive në Magaure dhe Dobrajë të Madhe	Në Implimentim
5	Renovimi efiqient I shkollave në Rufc të Ri, Topliqan, Qylagë,Medvec, Kojskë ,Shalë Shkolla e Mesme	I përfunduar
6	Renovimi I shkollave në Shalë (fillore) dhe Sllovi	I përfunduar
7	Ndërtimi I infrastrukturës ne sallën e sporteve në Glllogovc dhe në Rufc të ri	I përfunduar
8	Ndërtimi I infrastrukturës në oborrin e shkollës fillore në fshatin Ribar I Madh	Në implimentim

Sektori i menaxhimit të projekteve përveq bashkëpunimit në detyrat projektuese, hartimin e projekteve, hartimit të paramasave dhe parallogarive, procedimit të lëndëve në procedura të publikimit, menaxhimit të projekteve në teren dhe pranimit përfundimtar të punimeve, ka kryer edhe punë të tjera në suaza të kompetencave në bashkëpunim edhe me departamentet tjera.

Në kuadër të aktiviteteve të departamentit, veçojmë angazhimin në kuadër të grupit të performancës, në komisione për vlerësimin e dëmeve, në komision për vlerësimin e tenderëve, në hartimin e rregulloreve dhe strategjive, etj.

DREJTORATI PËR INSPEKSION

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtoria e inspektoratit për gjatë tërë vitit me prioritet ka realizuar agjendën e planifikuar për vitin 2024 duke vepruar përputhshmërisht me ligjet, udhëzimet administrative si dhe rregulloret komunale.

Janë realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Për realizimin e punëve në drejtori dhe objektivave të synuara janë realizuar inspektime të planifikuara, si dhe inspektimet e bazuara në kërkesat dhe ankesat e qytetarëve.

Me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë janë organizuar kujdestari të shumta, në ndërrimin e pasdites, vikendeve dhe festave zyrtare për të ju përgjigjur ankesave dhe parregullsive të paraqitura. Gjithashtu, janë realizuar inspektime të ndryshme në bashkëpunimin me Policinë e Kosovës-Stacioni Policor-Lipjan.

Si inspektorat kemi ofruar bashkëpunim me drejtoritë tjera në nivel komunal, me organet gjyqësore, Policinë e Kosovës, institucione të tjera, si dhe bashkëpunim me qytetarët.

Inspektorët e Tregut- gjatë vitit 2024 kanë zhvilluar inspektime të bazuara në planin e punës për vitin 2024. Qëllim kryesor i sektorit të tregut është që të punojë në përputhje me legjislacionin, udhëzimet administrative, si dhe rregulloret komunale, në mënyrë që të ndihmojë bizneset, organizatat dhe konsumatorët, parandalimin e ekonomisë joformale, sigurinë e përgjithshme të produkteve të plasura në treg, si dhe mbrojtjen e konsumatorit. Inspektorët e Tregut kanë për detyrë të sigurojnë përputhshmërinë e produkteve në treg, gjegjësisht sigurinë e produkteve me ligjet në fuqi.

Objektivë e inspektimit gjatë tërë vitit ka qenë regjistrimi i bizneseve, pranimi teknik i lokaleve në të cilat realizohet veprimtari biznesore, vendosjen e flamujve tek produktet, për të treguar origjinën e produkteve. Po ashtu janë bërë inspektime të subjekteve afariste për cilësinë e mallit përkatës afatin, vlefshmërinë e mallit, kushtet e ruajtjes së mallit, dhënien e faturave për shërbimet e ofruara konsumatorëve (në formë elektronike apo të shkruara), prejardhjen e mallit, librat e punës, krahasimin e çmimeve të ekspozuara me ato të arkës, vendosjen e çmimeve nëpër artikujt të ekspozuara, certifikatat e kalibrimit të njësive matëse pran organit të licencuar për kalibrim, respektimin e orarit të punës, kontrollimin e licencave për operatorët të cilët merren me tregtimin e karburanteve dhe lubrifikanteve dhe certifikatën e cilësisë së tyre.

Janë realizuar inspektime në lokalet afariste si: restorantet, kafiterit, maketet ushqimore dhe biznese të tjera, për respektimin e ligjit të duhanit etj.

Në bizneset të cilat kemi hasur parregullsi është iniciuar procedurë kundërvajtësve në Gjykatën Themelore në Prishtinë-dega Lipjan.

Gjatë sezonit të verës në fokus ka qenë inspektimin e shitësve ambulantiv në sheshin “Adem Jashari”, ku janë shqiptuar vërejtje dhe urdhëresa me procesverbal si dhe janë njoftuar se janë duke ushtruar veprimtari në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës.

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës stacioni në Lipjan, janë organizuar aksion në Sheshin “Adem Jashari” në Lipjan dhe janë konfiskuar të gjitha pajisjet dhe artikujt e shitësve të cilët ushtronin veprimtari ekonomike në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës.

Gjate këtij viti bashkëpunim me Policinë e Kosovës njësia në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” ku janë identifikuar dhe janë ndaluar disa persona të cilët ushtronin veprimtari ilegale brenda hapësirave të Aeroportit “Adem Jashari”, veprimtari të dhënies me qira të veturave për qytetarët të cilët e frekuentonin Aeroportin. Po ashtu janë bërë vërejtje ndaj disa bizneseve për mos respektim të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Ligjit për Tregtinë e Brendshme.

Në vazhdimësi është bërë inspektimi i tregjeve si: tregut të gjelbër, kafshëve dhe mobileve, nuk është lejuar asnjë lloj shitje jashtë tregut. Prioritare ka qenë dhe ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektori i mjedisit-ambientit- Nga sektori i mjedisit për mbrojtjen e ambientit është punuar sipas planit inspektues për inspektime për vitin 2024. Në planin inspektues është paraparë:

-Pranimi ankesave të qytetarëve dhe shqyrtimi i tyre në teren, kontrolla të shpeshta në deponit ilegale të mbeturinave që për fat të keq ekzistojnë edhe në komunën tonë, ndëshkimi i të gjithë atyre që takohen duke hedhur, apo gjeten dëshmi për ndotje të hapësirës publike, natyrës, pronës private me mbeturina, ndotjen e ajrit si pasoj e ndezjes së tyre.

-Mbikëqyrjen e grumbullimit të mbeturinave nga ekonomitë familjare, bizneset si dhe transportimit të tyre në deponi nga kompania e Pastrimi e cila është përgjegjëse për menaxhim të mbeturinave në K. Lipjanit.

-Mbrojtjen e ujërave, tokës, ajrit nga ndotja, mbikëqyrjen e kushteve të lejeve mjedisore komunale të aprovuara nga drejtoria e përkatëse e Komunës, mbrojtjen nga zhurmat eventuale, si dhe kontrolla tjera që kanë të bëjnë me ruajtjen e hapësirave publike, ruajtjen e ambientit nga ndotja sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

Sipas kërkesave dhe ankesave të qytetarëve janë bërë inspektime në vendngjarje për secilin rast, e që kërkesat kryesisht kishin të bëjnë me ndotjen e mjedisit me mbeturina sanitare apo inerte të hedhura në hapësirat publike, private, ndotjet e ajrit si pasoj e ndezjeve të mbeturinave, problemet me ujëra të zeza si pasoj e mbylljeve të rrjetit të kanalizimit pastaj probleme me mbylljen e kanaleve për ujërat atmosferik etj.

Për çdo ankesë është konstatuar gjendja me procesverbal, aty ku janë gjetur parregullsi janë dhënë urdhëresa, vërejtje për sanimin e parregullsive varësisht nga gjendja në teren. Janë shqiptuar gjopa mandatore ndaj personave fizik apo subjekteve që janë takuar apo janë gjetur dëshmi për ndotjen e mjedisit me mbeturina.

Sipas rregullores komunale të gjitha bizneset (restorantet, kafiterit, baret etj) të cilat kanë shfrytëzuar hapësirën publike me tavolina dhe ulëse janë detyruar dhe janë pajisur me pëlqim për hapësirën në shfrytëzim nga drejtoria përkatëse e Komunës.

Është bërë kontroll tek objektet që janë në ndërtim me shumë njësi banimi, depo, objekte tjera afariste të cilat janë në ndërtim apo bizneset që zhvillojnë aktiviteti në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale të aprovuara nga DPUMM. Janë dhënë urdhëresa për grumbullim e mbeturinave në vendpunishte, vendosja e tyre në kontejner, dorëzimin i tyre Kompanisë Pastrimit, gjithashtu janë dhënë urdhëresa për zbatimin e kushteve të LMK-së gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre. Ndaj disa bizneseve janë shqiptuar edhe gjopa me aktvendim për mos zbatim të kushteve të lejes mjedisore.

Ankesat e pranuar nga qytetarët për mbyllje të rrjetit të kanalizimit janë adresuar tek ujësjellësi, janë dhënë rekomandime për deblokim të rrjetit të kanalizimit sipas ankesave.

Sipas planeve nga drejtoria, është bërë kujdestari gjatë sezonës së verës, vikendeve, festave zyrtare për lirim e hapësirave publike nga shitës ambolantiv dhe problemeve tjera në kompetencën e Drejtorisë së Inspektoratit.

Si përfundim mund të themi se gjendja e ambientit në përgjithësi nuk është në nivelin e kënaqshëm, ambienti ende po vazhdohet të ndotet nga biznese dhe qytetarët e sidomos me mbeturina inerte (nga ndërtim-demolimi) sepse nuk ka ende kompani për menaxhim këtij lloji të mbeturinave në Komunën tonë. Mirëpo, ambienti është duke u përmirësuar gradualisht falë rritjes së ndërgjegjësimit të qytetareve për ruajtjen e ambientit, investimeve nga Komuna e Lipjanit, duke i pajisur të gjitha ekonomitë familjare me shporta për mbeturina.

Inspektoret e trafikut- po ashtu edhe inspektoret e trafikut kanë punuar në bazë të planit të punës që është hartuar për vitin 2024.

Objektivë e inspektoreve të trafikut ka qenë inspektimi i kompanive të autobusëve, auto-taksive, radio-taksiv si dhe kombi-taksi ilegal.

Kompanitë e autobusëve janë inspektuar për rend të udhëtimit është bërë verifikimi i orarit të punës dhe janë urdhëruar firmat që të respektohet rendi i udhëtimit ashtu si është lëshuar nga organi kompetent.

Edhe gjatë këtij viti janë organizuar kujdestari, gjatë kujdestarisë janë bërë aksione në bashkëpunim me Policin e Kosovës në Lipjan, Magure dhe me Policin kufitare në Aeroportin Ndërkombëtarë “Adem Jahsi”. Fokus ishin auto-taxit të cilët tentojnë të operojnë ilegalisht si dhe radio taksit.

Janë ndaluar auto-taksi dhe kombi-taksi të cilët nuk kishin Licenc dhe janë përjashtuar nga komunikacioni në afat prej 5 ditësh (të cilëve i janë konfiskuar targat dhe libreza e qarkullimit), si dhe janë shqiptuar gjopa mandatorë.

Inspektim i vazhdueshëm i trotuareve në qytet, lokalet janë urdhëruar me procesverbal që trotuari gjithmonë të jetë i lirë për këmbësorët dhe mos të vendosen reklama, janë kontrolluar edhe rrugët në qytet dhe fshatra ku janë vendosur pengesa në rrugë pa pëlqim nga organi kompetent ku janë urdhëruar që të largohen menjëherë nga rruga.

Ndaj të gjitha rasteve të ndaluara e të identifikua si të pa rregullta, janë marr të gjitha masat ligjore si: vërejtje, përjashtim nga komunikacioni-marrje e tabelave dhe janë shqiptuar gjopa.

Inspektori i ndërtimit- Gjatë vitit 2024 inspektori i ndërtimit ka inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi në të gjitha zonat e ndërtimit dhe zonat tjera ndërtimore, duke përfshirë edhe periferinë e Qytetit. Gjendja e ndërtimit për gjatë gjithë vitit ka qenë nën kontrollin e vazhdueshëm Inspektues. Janë identifikuar një numër i vogël i objekteve pa Leje ndërtimi në zonat e ndërtimit,

ndaj të cilave janë ndërmarrë masa ligjore konform ligjit të ndërtimit e dispozitave ligjore në fuqi. Inspektimet tjera rezultojnë të pajisura me leje ndërtimi nga organi kompetent.

E arritura e Inspektorit të ndërtimtarisë gjatë vitit 2024, është se ka filluar Rrënimi i objekteve me Leje rrënimi për Objektet Ekzistuese-Amortizuara me kompaninë e kontraktuar nga Komuna, gjithashtu janë Inspektuar edhe objektet-projektet e Investuara nga Komuna. Inspektorati ka pasur bashkëpunimi të kordinuar me Policinë duke njoftua për secilin ndërtim të filluar pa Leje, duke përfshirë edhe njoftimet e fillimit të ndërtimeve, kërkesave për inspektim nga Investitorët, kërkesave për Raporte Finale për Çertifikata e Përdorimi për objektet e përfunduara-finalizuara nga Investitorët, si dhe vetëdijesimi i shtuar i Investitorëve për ndërtime konform rregullave e procedurave ligjore, gjë e cila vërehet nga viti në vit për një numër më të vogël të ndërtimeve pa leje.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2024:

Janë inspektuar lokalet afariste, si: marketet, barnatoret humane, mishtoret, furrat e bukës, mullinjtë e grurit, auto-sallonet e veturave dhe veprimtari të tjera ekonomike ku janë kontrolluar çmimet e artikujve ushqimor në rafta dhe çmimet e arkës gjatë pagesës.

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste., si dhe janë bërë 137 pranime teknike të lokaleve afariste.

Inspektim i marketeve lidhur me zbatimin e Ligjit 06/L034 për Mbrojtje të Konsumatorit.

Inspektimi i bizneseve të cilat merren me shitjen e auto-pjesëve.

Inspektimi i bizneseve dhe marketeve të cilat mirren me shitjen e duhanit dhe alkoolit në lidhje me zbatimin e Ligjit nr.06/L034 për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Urdhëresa me procesverbal për deklarimin e çmimit të produkteve në raft dhe vendosjen e flamujve-tregues të origjinës.

Largimi i shitësve ambulant pa pëlqim nga Sheshi “Adem Jashari” dhe rrugët e qytetit.

Ndalimi i tregtimit në rrugët e qytetit (ndalim i shitjes jashtë tregut).

Zbatimi i urdhëresës që ndalon lëvizjen me trotinet elektrik, biçikleta në sheshin “Adem Jashari”.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Inspektim për lejet për rrënim.

Inspektimi i auto-taksive lokale, si dhe auto-taksitë që operojnë në ANP-Adem Jashari.

Ndalesa të vazhdueshme dhe ndëshkim për taksistët ilegal.

Inspektimi i radio- auto-taksive në qytetin e Lipjanit.

Inspektimi-kontrollimi i operatorëve-autobusëve në qytet dhe fshatrat për rendet e udhëtimit.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektim i firmave ndërtimore të cilat e dëmtojnë pjesën e trotuarit gjatë hyrje-daljes nga punishtja me kamion.

Urdhëresa për kryerje të obligimit të pagesës për bizneset ndaj Komunës për shfrytëzimin e hapësirave publike (terasave) sipas rregullores komunale.

Identifikimi i ndotësve përmes dëshmime të gjetura në teren, informatave të pranuar nga qytetarë dhe shqiptimi i gjobave.

Kontroll investitorëve të objekteve ndërtimore me shumë njësi banimi dhe subjektet tjera në zbatimin e kushteve të Lejes Mjedisore Komunale.

Pëlqimet për hapësirat publike, nga bizneset në qytet.

Shqiptimi i gjobave ndaj ndotësve të mjedisit.

Fletëparaqitje për Kundërvajtje

Shqiptimi i gjobave mandatore.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Inspektorët												Inspektorët												Inspektorët												Inspektorët											
Gjithsej inspektme	Gjithsej inspektme												Gjithsej inspektme												Gjithsej inspektme												Gjithsej inspektme											
Inspektme me procesverbal	Inspektme me procesverbal												Inspektme me procesverbal												Inspektme me procesverbal												Inspektme me procesverbal											
Kërkesa te shqyrtuara për pranime teknike	Kërkesa te shqyrtuara për pranime teknike												Kërkesa te shqyrtuara për pranime teknike												Kërkesa te shqyrtuara për pranime teknike												Kërkesa te shqyrtuara për pranime teknike											
Gjoha për mos zbatim të kushteve të LMK-së	Gjoha për mos zbatim të kushteve të LMK-së												Gjoha për mos zbatim të kushteve të LMK-së												Gjoha për mos zbatim të kushteve të LMK-së												Gjoha për mos zbatim të kushteve të LMK-së											
Fletëparaqitje	Fletëparaqitje												Fletëparaqitje												Fletëparaqitje												Fletëparaqitje											
Leje për pëlqime renovime	Leje për pëlqime renovime												Leje për pëlqime renovime												Leje për pëlqime renovime												Leje për pëlqime renovime											
Kontrolla për LMK	Kontrolla për LMK												Kontrolla për LMK												Kontrolla për LMK												Kontrolla për LMK											
Të pa inspektuara LMK për vitin 2024	Të pa inspektuara LMK për vitin 2024												Të pa inspektuara LMK për vitin 2024												Të pa inspektuara LMK për vitin 2024												Të pa inspektuara LMK për vitin 2024											
Vërejtje, njoftime	Vërejtje, njoftime												Vërejtje, njoftime												Vërejtje, njoftime												Vërejtje, njoftime											
Vendosja të shiritave	Vendosja të shiritave												Vendosja të shiritave												Vendosja të shiritave												Vendosja të shiritave											
Refuzime për leje ndërtimore nga DPUMM-ja	Refuzime për leje ndërtimore nga DPUMM-ja												Refuzime për leje ndërtimore nga DPUMM-ja												Refuzime për leje ndërtimore nga DPUMM-ja												Refuzime për leje ndërtimore nga DPUMM-ja											
Punë me palë, ankesa , kërkesa	Punë me palë, ankesa , kërkesa												Punë me palë, ankesa , kërkesa												Punë me palë, ankesa , kërkesa												Punë me palë, ankesa , kërkesa											
Lendet e pranuar dhe te shqyrtuara	Lendet e pranuar dhe te shqyrtuara												Lendet e pranuar dhe te shqyrtuara												Lendet e pranuar dhe te shqyrtuara												Lendet e pranuar dhe te shqyrtuara											
Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygesore	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygesore												Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygesore												Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygesore												Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygesore											
Gjoha mandatore	Gjoha mandatore												Gjoha mandatore												Gjoha mandatore												Gjoha mandatore											
Ndërtesa te reja te inspektuara me leje dertimi	Ndërtesa te reja te inspektuara me leje dertimi												Ndërtesa te reja te inspektuara me leje dertimi												Ndërtesa te reja te inspektuara me leje dertimi												Ndërtesa te reja te inspektuara me leje dertimi											
Njoftime për fillimin e ndërtimit	Njoftime për fillimin e ndërtimit												Njoftime për fillimin e ndërtimit												Njoftime për fillimin e ndërtimit												Njoftime për fillimin e ndërtimit											
Te hyra nga pranime teknike	Te hyra nga pranime teknike												Te hyra nga pranime teknike												Te hyra nga pranime teknike												Te hyra nga pranime teknike											
Objekte te reja te pajisura me leje ndërtimore	Objekte te reja te pajisura me leje ndërtimore												Objekte te reja te pajisura me leje ndërtimore												Objekte te reja te pajisura me leje ndërtimore												Objekte te reja te pajisura me leje ndërtimore											
Objektet te legalizuara	Objektet te legalizuara												Objektet te legalizuara												Objektet te legalizuara												Objektet te legalizuara											
Menaxhim i tregjeve	Menaxhim i tregjeve												Menaxhim i tregjeve												Menaxhim i tregjeve												Menaxhim i tregjeve											
Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa												Aktivendime, ndalesa, urdhëresa												Aktivendime, ndalesa, urdhëresa												Aktivendime, ndalesa, urdhëresa											
Inspektim me polici	Inspektim me polici												Inspektim me polici												Inspektim me polici												Inspektim me polici											
Inspektim I bizneseve pa regjistrim pa pranim teknik	Inspektim I bizneseve pa regjistrim pa pranim teknik												Inspektim I bizneseve pa regjistrim pa pranim teknik												Inspektim I bizneseve pa regjistrim pa pranim teknik												Inspektim I bizneseve pa regjistrim pa pranim teknik											
Inspektim për LMK të vitit 2024	Inspektim për LMK të vitit 2024												Inspektim për LMK të vitit 2024												Inspektim për LMK të vitit 2024												Inspektim për LMK të vitit 2024											
Konfiskim i targave dhe librezës	Konfiskim i targave dhe librezës												Konfiskim i targave dhe librezës												Konfiskim i targave dhe librezës												Konfiskim i targave dhe librezës											
Ndërtesa të inspektuara nga viti paraprak me leje ndërtimi	Ndërtesa të inspektuara nga viti paraprak me leje ndërtimi												Ndërtesa të inspektuara nga viti paraprak me leje ndërtimi												Ndërtesa të inspektuara nga viti paraprak me leje ndërtimi												Ndërtesa të inspektuara nga viti paraprak me leje ndërtimi											

DREJTORATI PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Sektori i Bujqësisë

Hartimi i këtij raporti është i bazuar sipas objektivave dhe prioritetëve të paraparë nga Plani i Punës për vitin 2024, duke i'a shtuar edhe aktivitetet të tjera të cilat janë kryer edhe pse nuk janë paraparë në Plan por që kanë qenë aktivitete të ndodhura ad hoc gjatë vitit.

Drejtorati për bujqësi dhe zhvillim rural ka mbajtur takime të rregullta mujore sipas nevojave të drejtoratit. Duke u nisur nga fakti që çdo fillim vit është i paraparë të fillojë me planifikime për punën edhe aktivitetin që do të pasojnë gjatë gjithë vitit. Në muajin Janar si zakonisht planifikojmë dhe dorzojmë planin e punës të drejtoratit të bujqësisë dhe pylltarisë me aktivitetet dhe projektet që do të realizohen si dhe punët e tjera.

Si çdo fillim vitë, Drejtori, formon komisionin në kuader të Drejtoratit në periudhën një vjeçare, ky Komision do të monitoroj, vizitot, përgadis raporte për kërkesat e bëra nga ana e fermerëve të cilët mund të kenë dëme të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, kafshët e egra apo të tjera.

Gjithashtu, në fillim vit kemi filluar procedurat për subvencionimin e fermerëve me mekanizëm bujqësorë të llojit frez për traktor, duke përgaditur edhe thirrjen publike e cila ka pasuar gjatë muajit shkurt dhe ka qenë e hapur për aplikim 15 ditë kalendarike, ku gjatë këtij aplikimi kanë aplikuar rreth 469 aplikues. Numri I pëfituesve do të jetë 273.

Në këtë periudh kemi pranuar kërkesat e fermerëve të cilët aplikojnë për sasi të qumështit në Ministri të Bujqësisë. Thirrje kjo e hapur nga Ministria e Bujqësisë por që fermerët dorzimin e aplikaconeve e bëjnë në Drejtoratit të Bujqësisë në Komunën e Lipjanit.

Gjatë muajit Shkurt, kemi pregaditur thirrjen për të subvencionuar sektorin e blegtoris për liter të qumështit, për periudhen 6 mujorshe të vitit të kaluar korrik- Dhjetor 2023, ku gjatë thirrjes kemi pasur rreth 50 aplikime. Duke pare si shumë të nevojshëm përkrahjen për këtë sektor, do të vazhdohet edhe periudhave të tjera gjatë vitëve.

Gjatë muajit Marsë është bërë hapja për aplikim për pagesa direkte, drejtorati ka bërë të gjitha pregaditjet, procesi i digjitalizimit të parcelave ka shkuar jashtzakonisht mire, ku për 30 ditë pune kanë aplikuar rreth 1650 fermer,për rreth 9,500 ha.

Po ashtu, bashkëpunimi me organizatën IRK në projektin e serave ka filluar ne muajin shkurt me vizitat në teren të komisionit të përbashkët në mes të Komunës dhe organizatës. Pas vizitave në teren do të bëhet përzgjedhja e 133 përfituesve, duke përfshi edhe 100 në listen pritëse të Komunës ku në total pritet të shpërndahen 233 sera të fermerët përfitues.

Në vitin 2024 kemi formuar një komision në kuader të drejtoratit të bujqësisë për të bërë verifikimin e secilit përfitues që është subvencionuar nga komuna respektivisht Drejtorati i Bujqësisë nga viti 2020 e tutje.

Gjatë muajit korrik kanë përfunduar korrje-shirejt e drithrave të bardha në të gjithë teritorin e Komunës së Lipjanit. Këtë vit si asnjëherë më pare rendimentet e drithrave të bardha kanë qënë në nivelin më të mirë në 20 vitet e fundit. Në komunën e Lipjanit ka pasur te mbellur me grur një sipërfqe prej 4100 ha dhe rendimenti ka shkuar nga 5500 deri 6000kg për ha.

Gjithashtu, kemi vazhduar bashkëpunimin edhe me organizata të tjera duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën e IADK-së, me projekte për sektorin e bujqësisë, më konkretisht për komunitetet jo shumicë të cilat jetojnë dhe veprojnë në Komunën e Lipjanit, respektivisht në zona më të thella rurale. Nga ky bashkëpunim me IADK-në pritet të jenë rreth 29 përfitues me sera dhe mekanizëm të ndryshëm bujqësore,

Gjithashtu, kemi nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit me organizatën Islamic Relief Kosovam IRK në dy projekte për motokultivator dhe sera me sipërfaqë 50m². Thirra publike është bërë ne muajin Tetor, gjatë kësaj periudhe kemi pasur rreth 400 aplikues, Në projektin e motokultivatorve kemi rreth 105 përfitues ndersa të projekti i serave kemi 114, në total nga ky projekt kanë përfituare rreth 219 fermer.

Gjitashtu kemi marrëveshje të bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit me organizatën e QATAR CHARITY, nga ky memorandum i bashkëpunimit janë përkrahur mbi 80 familje të cilat kanë qenë në nevoj dhe të cilat kanë pasur munges të pusve dhe ujt të pishëm,

Sipas raportit të menaxherit për trajtimin e qenëve endacak ka vazhduar trajtimi i tyre sipas kërkesave të qytetarëve në lagje dhe fshatra, pavarisist vështërsive, ne si drejtorat repsketivisht si Komunë jemi duke provuar të bejmë më të mirën ndaj kësaj problematike deri me tani janë trajtuar afersisht mbi 750 qenë endacak dhe do të vazhdohet edhe vitëve tjera.

Si kërkesë e nevojshme, drejtorati për bujqësi ka pranuar dy konsulet per të ndihmuar dhe vazhduar punët në drejtorat pa ndonjë vështërsi, me ndarjen e sektorit të pylltaris, sektor ky që është bartur përgjegjësia në nivelin qendror dhe si rezultat i ndarjës së stafit, ishte e nevojshme prannimi i dy konsuleneve.

Për veq procedurave qe kemi filluar qysh në fillim gjatë periudhës nga muaji Maj kemi zhavoruar mbi 12km rrugë fushore. Qëllimi i zhavorimit të rrugëve fushore ka qenë për të përmirësuar infrastrukturen rrugore për fermerët tanë të cilët kultivojnë kultura të ndryshmë bujqësore. Përmirësimi i rrugëve fushore ka për qëllim të lehtësojë dhe ofroj qasje më të lehtë të fermerëve në tokat e tyre bujqësore, përveç qasjejs, presim edhe rendimente me të mira nga sektori i bujqësisë.

Pas përfundimit të procesit të digjiltizimit të parcelave, kemi filluar me grumbullimin e të dhënave nga drejtorati bujqësisë për të pare sa hektar janë të mbjellur dhe cilat kultura bujqësore dominojnë me sipërfaqe në Komunën e Lipjanit,

Në vitin 2024, buxheti i alokuar për mallra, shërbime dhe bujqësi është shpenzuar mbi 97%, duke reflektuar një menaxhim shumë të mire.

Viti 2024 ka qenë vitë aktiv dhe produktiv për Drejtorinë e Bujqësisë, duke përfshirë planifikimin dhe menaxhimin e projekteve të realizuara. Këto arritje vendosin një bazë të fortë për punën në vitin 2024.

Me anë të tabelave mund të shihni listat e përfituesce të subvencioneve si dhe të dhëna të tjera për sipërfaqen me të mbjellura në komunën e Lipjanit për vitin 2024.

Nr.	Institucioni / organizata	Përfitues
1	Komuna	
•	Freza për traktor	273
•	Sera 100m2	97
•	Sera 50m2	93
•	Motokultivator	88

•	Subvencionimi i blegtorve/qumshtit	50
•	Ndihmë financiare për fermerët e dëmtuar	51
2	Islamik Relief Kosova	
•	Motokultivator	17
•	Sera 100m2	135
•	Sera 50m2	21
3	IADK	
	Sera 100m2	11
	Freza për traktor	12
4	QATAR charity	
•	Hapja e pushtave	81
Totali i përfituesve		929

Me anë të kësaj table paraqesim të dhënat e sipërfaqës më të mbjellurave në Komunën e Lipjanit për vitin 2024, këto të dhëna janë nxjerrur nga programi i pagesave direkte.

Kulturat Bujqësore	Sipërfaqja e mbjellur në hektar	Kulturat Bujqësore	Sipërfaqja e mbjellur në hektar
Grur	4,008.77	Mollë	47.10
Misër	4,350.30	Dardhë	2.4
Tersher	71.22	Kumbull	24.51
Elb	23.50	Arra	30.57
Patate	150.00	Qerrshi	2.28
Qepë	79.82	BMA	0.50
Fasule	196.26	Vreshta	4.59
Kunguj	95.35	Lajthija	14.65
Kunguj Misiri (Qylah)	17.06		
Luledielli	1.00	Totali	126.6
Hudher	0.35		
Spec	34.62		
Lakër	6.52	Pemë të imta	Sipërfaqja e mbjellur në hektar
Shakqin	15.72	Mjedra	2.71
Pjepër	15.45	Dredheza	2.93
Lulelakën	0.88	Aronia	0.30
Domate	0.96		
Perime në sera	66.86	Totali	5.94
Totali	9,557.89		

Me anë të kësaj table tregojmë të dhënat për sektorin e belgtorisë dhe Bletarin në Komunën e Lipjanit për vitin 2024. Këto të dhëna janë nxjerrur nga programi i pagesave direkte.

Nr.	Llojet e kafsheve	Totali
1	Lopë qumështore	1.534
2	Mushqerra	153
3	Dele	2,896
4	Dhi	593
5	Pula	6.350
6	Bletë/ koshere	5,435

DREJTORATI PËR SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave të Drejtoratit për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë periudhës së vitit 2024 ka kryer punët dhe aktivitetet të cilat janë paraqitur në formë të shkruar dhe tabelare.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Aktivitetet e përgjithshme të DSHPMSh-së

Pranimi, evidentimi, arkivimi dhe zgjedhja e kërkesave të arritura nga qytetarët apo institucioneve tjera, punimi i raporteve periodike të punës: javore, mujore, gjashtë mujorë dhe vjetor, raporti i punës së drejtoratit për vitin 2024, plani i punës së DSHPMSh-së për vitin 2025 dhe plani i prokurimit për vitin 2025.

Janë dhënë përgjigje kërkesave të parashtruara.

Janë mbajtur takime me qytetarë që kanë paraqitur kërkesa individuale dhe grupe nga përfaqësuesit e vendbanimeve të caktuara. Është bërë prezantimi në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve, Asamblesë Komunale dhe në KKSb.

Kërkesë Kryetarit të Komunës për nxjerrjen e vendimit për shpalljen e njoftimit publik dhe formimin e komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve për Auto- Taxi dhe për formimin e komisionit për hartimin e draft rregullores për rrugët lokale. Kërkesa zyrës së Avokatit Komunal për vazhdimin e procedurave për kompenzimin e dëmeve të shkaktuara në asetet komunale.

Kërkesë Drejtoratit për Prokurim për iniciimin e procedurave të prokurimit: mirëmbajtja e rrjeteve të kanalizimit në qytet dhe fshatra, pastrimi i varrezave dhe lapidarëve në komunën e Lipjanit, furnizimi me energji elektrike i ormanit të ndriqimit publik në shtigjet e ecjes në Sllovi, mirëmbajtja e shenjzimit horizontal dhe vertikal në komunën e Lipjanit, mirëmbajtja e paisjeve sinjalizuese, kamerave, zërimit dhe paisjeve tjera, furnizimi dhe montimi i shtyllave të betonarmisë, mirëmbajtja e ndriqimit publik në qytet dhe fshatra, rrënimi i objekteve të vjetra në Lipjan, mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror në qytetin e Lipjanit, menaxhimi i tregjeve të Lipjanit, mirëmbajtja dhe riparimi i rrjeteve të kanalizimit në qytet dhe fshatra dhe mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra.

Janë bërë kërkesa DBF-së për zotimet e mjeteve financiare për pagesat për borxhet e mbetura nga viti i kaluar të kontratave kornizë dhe pagesat tjera të këtij viti.

Kërkesë Drejtoratit për Inspektorat për inspektim të bizneseve me qëllim të pajisjes me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe kërkesë për identifikimin e deponive ilegale.

Kërkesa Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim, Drejtoratit për Arsim, Drejtoratit për Bujqësi dhe KRM Pasrtimit Njo Lipjan për ofrimin e të dhënave nga fushat e tyre për përfshirje në Planin për Menaxhimin e Mbeturinave.

Janë bërë kërkesa KRU Prishtina NjOU Lipjan për deblokimin e rrjeteve të kanalizimeve sipas kërkesave të qytetarëve.

Kërkesë AME-së për dalje në teren për vlerësimin e sigurisë teknike të objektit në Rr."Skënderbeu" në Lipjan. Njoftim INFRAKOS Sh.A për shenjzim vertikal pranë vendkalimeve mbi hekurudhë në qytetin e Lipjanit.

Është përgaditë dhe është shpallë njoftimi publik për ndarjen e licencave për operatorët auto taksi. Janë përgatitë dhe dërguar të dhënat për hartimin e Strategjisë Zhvillimore Lokale nga fusha e DSHPMSh-së, është raportuar dhe janë plotësuar formularët për performancën komunale për vitin 2023 nga fusha e DSHPMSh-së.

Është bërë barazimi me DBF-në për të hyrat nga inkasimi i mjeteve nga hapësirat publike si dhe të hyrave nga tregjet, si dhe barazimi me KEDS-in i fakturave të ndriqimit publik.

Është hartuar dhe miratuar Planin për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit 2024-2028, Planin për ndarjen e orareve të transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2024-2028 dhe plotësim ndryshimi i Rregullores për transportin e rregullt urban periferik në territorin e komunës së Lipjanit.

Janë dhënë pëlqime sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve, Vendime për shfrytëzim të hapësirës publike para lokaleve afariste dhe vërtetime për shtëpi të djegura gjatë luftës.

Janë bërë intervenime në rrjetet e kanalizimit në qytetin e Lipjanit dhe në fshatra.

Është bërë mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror ku është bërë fshirja dhe larja e rrugëve dhe trotuareve në gjatësi prej 422000m’. Po ashtu është bërë mirëmbajtja e rrugëve edhe gjatë sezonit dimëror ku janë mirëmbajtur rrugët e zonës urbane të qytetit, të gjitha rrugët e fshatrave, shtigjet e ecjes në Gadime dhe shtigjet e ecjes në Slllovi në gjatësi prej afro 460km.

Është bërë pastrimi, larja dhe rregullimi i permendoreve në varrezat e dëshmorëve dhe martirëve si dhe kositja e hapësirave gjelbëruese brenda hapësirave të varrezave në të gjitha vendbanimet e Komunës së Lipjanit, është bërë hapja dhe pastrimi i lumenjëve, hapësirave përgjat lumenjëve dhe mirëmbajtja e hapësirave publike në disa fshatra. Është bërë pastrimi dhe largimi i mbeturinave – deponive ilegale nëpër disa fshatra.

Është bërë krasitja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit dhe në sheshin “Adem Jashari” si dhe janë mbjellur lulet në rrethrotullime dhe në vazot e qytetit. Është bërë mirëmbajtja e hapësirave publike si: parqe, hapësira të gjelbërta, sheshi, trotualet me drurende etj, ku disa prej hapësirave të paraqitura më poshtë janë mirëmbajtur vazhdimisht:

Nr.	HHP	Numri i HHP	Sipërfaqja
1.	Parku te hekurudha	20	5 ha 3 ha gjelbërim
2.	Parku dhe parkungu te komuna		
3.	Parku te Shtëpia e Kulturës		
4.	Gjelbërimi te shtëpia e Kulurës		
5.	Drurendet Lidhja e Prizrenit, “Avdi Kelmendi” dhe “Komandat Kumanova”		
6.	Parku dhe parkingu te qerdhja		
7.	Stacioni i autobusëve		
8.	Parku mbrapa postes		
9.	Parkingu te shtëpia e kulturës		
10.	Qendra - sheshi “Adem Jashari”		
11.	Rruga drurendet Skënderbeu		
12.	Haxhi Kleqka		
13.	Parku “Haradin Bajrami”		
14.	Parku përkujtimor		
15.	Beter Live		
16.	Xhavit Kozhani		
17.	“Gjergj Fishta”, “Hamzë Jashari”, “Fehi Agani”, “Tahir Sinani”		
18.	Shtigjet e ecjes		
19.	Lumi Sitnica		
20.	Te KRU Prishtina		
21.	Hallaq i Madhë	1	100 m ²
22.	Hallaq i Vogel	1	500
23.	Kraishtë	1	1000
24.	Parku 1 Ribar i Madh Parku 2 Ribar i Madh	2	7500 1491.50
25.	Grackë e Vjeter	1	44414
26.	Hapësirat Dobrajë e Madhe	5	4641 4133 2500 1572.50 8400
27.	Medvec Kroni	1	300
28.	Parku Magurë	1	10180
29.	Shalë Sheshi Rambuje	1	1000
30.	Parku Konjuh	1	2378
31.	HHP Banullë Parku Banullë HHP Lumennjt	3	4250 3743.05 1562.76
32.	Parku Llugaxhi	1	14200
33.	Parku 1 Babush Parku 2 Babush	2	3390 1085
34.	Gadime e Ulët-Shtigjet e ecjes HHP-Përgjat lumit	2	18579 6825
35.	Gadime e Epërme Shtigjet e ecjes dhe HHP përgjat lumit	2	5115 14350
36.	HHP Sheshi Bash Qarshi	1	1000

37.	Parku Poturovc	1	7600
38.	Parku Bujari	1	1600
39.	Sllovi Shtigjet e ecjës	1	11360

Mbikqyrja e kontratave kornizë:

Janë menaxhuar kompanitë sipas loteve të ndara për pastrimin e borës gjatë sezonit dimëror në rrugët e qytetit dhe në fshatra. Menaxhimi i tregjeve në Komunën e Lipjanit.

Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera publike në qytetin e Lipjanit.

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror.

Pastrimi i varrezave dhe sanimi i lapidarëve në Komunën e Lipjanit.

Mirëmbajtja dhe pastrimi i lumenjëve në Komunën e Lipjanit.

Mirëmbajtja e ndriçimit publik në qytet dhe në fshatra.

Mirëmbajtja e infrastrukturës së rrugëve të asfaltuara dhe trotuareve në Komunën e Lipjanit.

Mirëmbajtja e rrjeteve të kanalizimit në qytet dhe në fshatra.

Mirëmbajtja e shenjësimit horizontal dhe vertikal në Komunën e Lipjanit.

Aktivitetet në ndriçimin publik

Janë bërë intervenime në rrjetin e ndriçimit publik në qytetin e Lipjanit dhe në fshatra.

Aktivitetet e zhvilluara në sektorin e trafikut

Në lëmin e transportit rrugor të udhëtarëve me autobus, DSHPMSh-ja sipas ndarjes së orareve dhe Planit të transportit të udhëtimit për transportin e udhëtarëve me Autobus janë duke operuar 12 operatorë, ku nga ky plan janë të përfshira 57 fshatra me 194 vend ndalje për marrje dhe zbritje të udhëtarëve, ku 174 prej tyre janë të shenjëzuara.

Me planin e orareve të rendeve të udhëtimit për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në teritorin e komunës së Lipjanit janë planifikuar 24 linja ku 21 prej tyre u janë ndarë operatorëve, ndërsa për linjat Vrellë e Gadimes - Gadime, Kleqkë - Shalë dhe Aklap – Lipjan nuk ka pasur aplikime nga operatorët për të operuar në këto linja.

Operatorët të cilët operojnë në linja lokale të transportit të udhëtarëve janë:

1. Fatlindi A
2. NTSH "Gmica Trans"
3. NTTP "Afërdita"
4. NTTP "Erxhani"
5. NTTP "Uka Trans"
6. NNTP "Nexhi Comerc"
7. NT P "Erona"
8. NTSH "Shala Trans"
9. NTP "Edisoni"
10. NTP "Titi Turs"
11. "Lipjani" shpk
12. Arioza Travel

Numri i përgjithshëm i operatorëve të transportit publik të licencuar që kanë operuar gjatë vitit 2024 është gjithsej 12 kompani.

Numri i auto taksi-ve të licencuar që kanë operuar në vitin 2024 në teritorin e Komunës së Lipjanit është **60**, ndërsa në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" gjithsej janë **100**. Parkingjet për autotaksi janë 8 lokacione në qytet dhe Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari, me kapacitet prej 160 vendparkigjeve. Ndërsa parkingje në hapësira publike, shirita rrugor, parkingje të bizneseve, shkollave etj janë 126 me kapacitet rreth 3584 automjete. Në kuadër të këtyre vendparkigjeve 120 vende janë të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara.

Aktivitetet e veçanta

Ndër aktivitetet më të rëndësishme të DSHPMSH-së që karakterizojnë periudhën kohore të raportimit janë:
 Kërkesë QRA - së në Lipjan për ofrimin e numrit të veturave te regjistruara gjatë vitit 2024 në Komunën e Lipjanit.
 Janë plotësuar formularët me të dhëna për raportim për performancën komunale.
 Janë plotësuar të dhënat nga fusha e DSHPMSH-së për raportin për përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane.
 Janë përgaditë të dhënat nga fusha e DSHPMSH-së për planin e Integritetit.

STATISTIKAT

Në vazhdim janë të paraqitura në formë tabelare aktivitet e përgjithshme dhe të veçanta të DSHP-së gjatë vitit 2024.

Pasqyra e lëndëve të pranuara dhe të zgjidhura gjatë vitit 2023				
Nr. i kërkesave të pranuara	Të zgjidhura	Të hedhura poshtë	Në kompetencë	Në procedurë
567	488	//	47	32

Aktivitetet e DSHPMSH-së zhvillohen sipas planit dinamik të punëve, mirëpo për tu njoftuar me problemet dhe nevojat e qytetarëve janë realizuar takime të ndryshme me qytetarë.

Aktivitetet e Sektorit për Shërbime Publike janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Pasqyra e aktiviteteve të DSHP-së		
Nr	Lloji i aktivitetit	Nr. i aktiviteteve
1.	Kërkesa dhe njoftime të ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera	423
2.	Takime zyrtare me Ministrinë, KEDS, AME, KRU Prishtina, INSI, etj	21
3.	Vizita në teren	790
4.	Pjesëmarrja në trajnime dhe punëtori të ndryshme	11
5.	Pjesëmarrja në vlerësimin e ofertave tenderuese	28
6.	Mbikëqyrja e kontrateve kornizë	14
7.	Hartimi i paramasave dhe parallogarive	18

Sipas raportit vjetor të Njesisë së Zjarrëfikjes me numër të protokolit 13-052/01-1797 të datës 10.01.2025 janë kryer aktivitetet si:

Pastrimi i shtratit të lumenjëve nga mbeturinat, zgjerimi dhe krijimi i bankinave për mbrojtjen nga vërshimet.
 Intervenime në shuarjen e zjarreve (shtëpi banimi, markete, fusha te hapura gjatë veres shuarja e pyjeve, aksidentet në rrugë, shtylla elektrike, kontenjer, vërshime etj.
 Përpunimi i të dhënave sektoriale dhe hartimi i draft vlerësmit të përgjithshëm të rrezikut për komunën.
 Hartimi i planit për mbrojtje dhe shpëtim sipas ligjit dhe në bazë të vlerësimit.
 Hartimi i planit operacional për fushatën korrije- shirjeve dhe mbikëqyrja e implementimit në teren.
 Implentimi i planit të ligjeratave dhe trajnimeve që do të mbahen me nxënësit e shkollave për parandalimin e zjarreve fushore dhe malore.
 Testimi i rregullt i sirenave për alarmim publik të qytetarëve dhe testimi i rregullt i funksionimit të sistemit të detektorëve dhe sirenave të brendshme në ndërtesat e KKL.

Ekipet e zjarrëfikësve kanë bërë interevnime në teren aty ku është paraqitur nevoja ku numri i përgjithshëm i fatkeqësive në Komunën e Lipjanit gjatë vitit 2024 është gjithsejt 445 ku përfshihen:zjarre, shpëtime, shërbime dhe intrvenime teknike intervenime.

Ekipet e zjarrëfikësve gjatë vitit 2024 kanë kryer gjithsejt 445 intervenime në vendin e ngjarjes.

Në vazhdim në formë tabelare janë paraqitur punët e njesisë së zjarrfikësve.

Nr	Emertimi	Numri i rasteve
1	Zjarre: (shtëpi banimi,oxhak,shtëpi ndihmëse,shtalla, objekte afariste, male, ushqim bagëtish, bari i thatë, mbeturina, trafo, orë rryme, shtylla etj.	382

2	Intervenime teknike: (aksidente komunikacioni, ashensor, thithje e ujit, thyrje akullit, intervenime tjera.	31
3	Sherbime: (furnizim me ujë, pastrim rrugësh, gara me automobila) etj	26
4	Shpëtime: (shpëtim nga lartësia, shpëtim nga uji, vërshime, ushtrim ne Aeroport me nxënës, alarme të rreme për bombë.	6
	Gjithësejt	445

DREJTORATI I PROKURIMIT

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtoria e Prokurimit, ka një shkallë të lartë të përgjegjësisë për të siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike dhe menaxhimit sa më të mirë të fondeve pulike. Në këtë Raport, janë të përfshira të gjitha aktivitetet e prokurimit që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Lipjanit ka zhvilluar gjatë kësaj periudhe dymbëdhjet mujore, për t’gjitha kategoritë e shpenzimeve, për mallra, shërbime dhe punë.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë kësaj periudhe raportuese, shenojmë këto aktivitete të Prokurimit:

- Zhvillimi i procedurave të prokurimit nga kërkesat e njërive kërkuese,
- Ankande Publike
- Hapje dhe vlerësim të tenderëve dhe Ankandëve Publike
- Kërkesa për referencë nga OE për punët e kryera.
- Në AQP, kemi dërguar **Planin e Prokurimit për Vitin Fiskal 2024**,
- Në KRPP, kemi dërguar **Raportin Vjetor të Kontratave të nënshkruara Publike për Vitin 2022**,

STATISTIKAT

NR:	Numri i rendor i prokurimit	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës (ne rast anulimi data e njoftimit për anulim)	Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës)	Vlera e parashikuar e kontratës	Cmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.
1	613-23-13986-5-5-8	Marrëveshje kornizë Furnizim me pemë dhe perime	15.1.2024.	12.1.2024.	8,404.00	6,665.00
2	613-23-13462-2-2-1	Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e objektit me shumë njësi banesore për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, si dhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e objektit me shumë njësi banesore në qendren e qytetit në pjesen lindore të rrugës Lidhja e Prizerenit-Ritender	11.1.2024.	10.1.2024.	55,000.00	45,500.00

3	613-23-11633-2-2-1	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve sportiv (kompleksi sportiv Better Life dhe palestra e re sportive)	16.1.2024.	15.1.2024.	70,000.00	55,600.00
4	613-24-329-1-3-6	Furnizimi i çerdhes me paisje shtëpiake-teknike dhe klima	12.2.2024.	8.2.2024.	9,000.00	7,396.30
5	613-24-251-1-3-6	Furnizimi i Qerdhes me materiale të imta shtrojë e mbulojë	13.2.2024.	12.2.2024.	9,500.00	9,495.10
6	613-24-162-2-2-1	Instalimi i internetit dhe shërbimet e rregullta mujore për paralelet e ndara fizike te IEA	23.2.2024.	22.2.2024.	15,000.00	6,330.72
7	613-24-310-1-2-1	Furnizimi me artikuj te ndryshem ushqimor dhe pije per dita te shkollave dhe per evente te ndryshme per drejtorin e DKRS-se	1.3.2024.	29.2.2024.	10,000.00	10,000.00
8	613-24-230-1-2-1	Furnizimi me material për mirëmbajtjen të Objekteve në të gjitha IEA dhe institucionet tjera komunale	1.3.2024.	29.2.2024.	100,000.00	100,000.00
9	613-24-439-5-2-1	Mirëmbajtja e rrjeteve të Kanalizimit në qytet dhe fshatra	5.3.2024.	4.3.2024.	300,000.00	300,000.00
10	613-24-164-5-2-1	Riparimi i defekteve dhe rregullimi i kulmeve në Institucionet Edukativo Arsimore, dhe objekteve të institucioneve tjera	8.3.2024.	7.3.2024.	45,000.00	45,000.00
11	613-24-416-2-2-1	Mirembajtja dhe servisimi i klimave dhe pajisjeve tjera ne IEA, dhe QKMF, etj	8.3.2024.	7.3.2024.	30,000.00	30,000.00
12	613-24-783-1-2-1	Furnizimi i qerdhes në Rucf me paisje të ndryshme dhe inventar - Ritenderim	22.3.2024.	21.3.2024.	17,000.00	15,275.00
13	613-24-405-1-1-1	Furnizimi me mekanizëm bujqësor për fermer	25.3.2024.	22.3.2024.	300,000.00	184,750.00
14	613-24-2818-5-5-8	Marrëveshje kornizë - Furnizimi me pemë dhe perime për QEAP Qerdhja - Lipjan	19.4.2024.	18.4.2024.	8,600.00	6,583.00
15	613-24-885-2-2-1	Sigurimi fizik i objekteve në shkollat SHFMU Vëllezërit Frashëri, SHMP Adem Gllavica dhe Gjimnazi Ulpiana - Lipjan	27.3.2024.	26.3.2024.	40,000.00	39,645.90
16	613-24-1139-5-2-1	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit & asflltimit i rrugicave në Kleqkë	29.3.2024.	28.3.2024.	139,000.00	137,819.98
17	613-24-278-1-2-1	Furnizimi me materiale higjienike për IEA dhe DKRS	29.3.2024.	28.3.2024.	66,000.00	66,000.00
18	613-24-3104-5-5-8	Furnizimi me PC kompjuterve për Administratën e Komunës së Lipjanit	8.5.2024.	7.5.2024.	11,000.00	10,849.00
19	613-24-544-2-2-1	Sigurimi i Automjeteve	1.4.2024.	29.3.2024.	33,800.00	34,199.10
20	613-24-1479-5-3-6	Furnizimi me energji elektrike i ormanit të ndriçimit publik në shtigjet e ecjes në Sllovi	1.4.2024.	29.3.2024.	9,900.00	6,230.00
21	613-24-1133-2-2-1	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objektit për shtëpinë me bazë në komunitet	9.4.2024.	8.4.2024.	14,400.00	11,880.00
22	613-24-2603-2-3-6	Qëndrim javor në vendet turistike për banorët e shtëpise me bazë në Komunitet	9.4.2024.	8.4.2024.	9,900.00	9,618.00
23	613-24-2008-2-3-6	Mbushja dhe servisim të bombolave kundër zjarrit	12.4.2024.	8.4.2024.	5,000.00	1,056.00
24	613-24-1539-2-2-1	Shërbime konsulente për nevojat e Komunës së Lipjanit , 1 lloje	29.4.2024.	26.4.2024.	13,200.00	13,200.00
25	613-24-1539-2-2-1	Shërbime konsulente për nevojat e Komunës së Lipjanit , 2 lloje	29.4.2024.	26.4.2024.	13,200.00	12,960.00
26	613-24-2872-1-3-6	Furnizimi me foli dhe rollne printeri për Autokllav në QKMF, QMF dhe AMF-Ritenderim	30.4.2024.	29.4.2024.	5,000.00	5,000.00
27	613-24-659-5-1-1	Shtuarja e rrugëve fushore me zhavorr - Ritenderim	30.4.2024.	26.4.2024.	520,000.00	520,000.00
28	613-24-1763-1-3-6	Furnizimi dhe montimi me pano reklamuese dhe tabel dixhitale	6.5.2024.	2.5.2024.	9,500.00	7,940.00
29	613-24-2588-2-3-6	Transporti i nxënësve semimaturant në testin e arritshmëris	6.5.2024.	2.5.2024.	2,200.00	2,184.99
30	613-24-1655-5-2-1	Demolimi furnizimi dhe montimi i dyerve dhe dritareve ne disa IEA-ritenderim	6.5.2024.	3.5.2024.	40,000.00	40,000.00
31	613-24-2823-2-2-1	Asgjësimi i materialeve të mprehta dhe jo të mprehta medicinale në QKMF,QKF dhe AMF - Kontratë 3 vjeqare	17.5.2024.	15.5.2024.	40,000.00	40,000.00

32	613-24-2604-2-2-1	Mirëmbajtja e paisjeve sinjaliuese, kamerave, zërimet dhe paisjeve tjera.	17.5.2024.	16.5.2024.	115,000.00	7,292.37
33	613-24-2974-1-3-6	Furnizim me inventar për institucionet shendetesore	20.5.2024.	17.5.2024.	6,000.00	5,475.00
34	613-24-2905-1-2-1	Furnizimi me instrumente dhe paisje medicinale në QKMF,QKM dhe AMF	21.5.2024.	20.5.2024.	10,000.00	10,000.00
35	613-24-3046-1-3-6	Furnizimi dhe montimi me perde shiritore në QKMF,QMF dhe AMF	23.5.2024.	22.5.2024.	3,000.00	1,656.00
36	613-24-4663-5-2-5	Aneks kontratë-Asfaltimi i rrugës së Shkupit dhe rrugës së lumit në Gadime të Ulët faza II	28.5.2024.	27.5.2024.	10,088.75	10,088.75
37	613-24-2513-1-1-1	Furnizimi me barna dhe materiale tjera mjekësore në QKMF	29.5.2024.	27.5.2024.	160,000.00	139,767.00
38	613-24-2545-2-2-1	Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal ne Komunën e Lipjanit	29.5.2024.	28.5.2024.	100,000.00	100,000.00
39	613-24-3193-2-2-1	Furnizimi me pjesë dhe servisimi i gjeneratorëve të institucioneve të Komunës së Lipjanit	3.6.2024.	31.5.2024.	15,000.00	4,316.00
40	613-23-11429-2-2-1	Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lartë perendimore në Komunën e Lipjanit- Loti-5 per vitin 2023-2025 Ritenderim	5.6.2024.	4.6.2024.	36,000.00	29,044.20
41	613-24-3463-1-2-1	Furnizimi dhe montimi i xhamave në të gjitha IEA-të	7.6.2024.	5.6.2024.	20,000.00	16,900.00
42	613-24-4327-5-2-1	Pastrimi i varrezave dhe lapidarëve në Komunën e Lipjanit-Ritender	10.6.2024.	7.6.2024.	200,000.00	200,000.00
43	613-24-3002-5-1-1	Furnizimi dhe vendosja me bari sintetik dhe infrastruktura tjera ne fushat sportive ne Magure dhe Dobraje e madhe	10.6.2024.	7.6.2024.	1,200,000.00	1,198,386.50
44	613-24-4622-1-3-6	Furnizimi dhe montimi me kallda për ngrohje në QKMF, QMF dhe AMF	24.6.2024.	21.6.2024.	6,000.00	2,813.60
45	613-24-4964-5-3-6	Rregullimi i parketit në shkollën e fshatit Topliqan, etj	28.6.2024.	27.6.2024.	9,500.00	5,633.33
46	613-24-4737-5-2-1	Izolimi dhe ngjyrosja e shkollës në Bujan	5.7.2024.	4.7.2024.	10,500.00	9,333.33
47	613-24-3715-2-2-1	Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024-2029	8.7.2024.	5.7.2024.	20,000.00	15,892.00
48	613-24-5600-1-3-6	Furnizimi dhe montimi i shtyllave të betonarmisë	8.7.2024.	5.7.2024.	5,500.00	3,966.00
49	613-24-4872-1-3-6	Pajisje për sherbimet e zjarrfikësve	9.7.2024.	8.7.2024.	2,700.00	2,650.00
50	613-24-6363-1-2-5	Aneks kontratë - Furnizimi me mekanizëm bujqësor për fermer	10.7.2024.	8.7.2024.	16,997.00	16,997.00
51	613-24-4440-2-2-1	Dezinfektim,dezinspektim, dezinfektim për Institucionet Edukativo Arsimore dhe institucionet e tjera komunale	10.7.2024.	9.7.2024.	14,300.00	8,827.46
52	613-24-5476-5-2-1	Demolimi i objektit të shkollës Adem Gllavica dhe shkollës në Resinove	15.7.2024.	12.7.2024.	25,000.00	13,918.73
53	613-24-3681-1-2-1	Furnizimi me pelet për ngrohje për IEA-të dhe QKMF-në dhe DKRS-në	15.7.2024.	12.7.2024.	124,800.00	77,080.00
54	613-24-4849-5-2-1	Gletimi dhe ngjyrosja në IEA në shkollën e Sllavisë dhe Qylagës	18.7.2024.	16.7.2024.	14,000.00	7,136.31
55	613-24-7644-5-5-8	Marrëveshje kornizë Furnizim me pemë dhe perime	26.8.2024.	20.8.2024.	6,500.00	6,096.00
56	613-24-5938-1-2-1	Furnizim me veshëmbathje, çarçaf shumëpërdorimësh, njëpërdorimësh dhe uniforma në QKMF dhe Urgjencë	1.8.2024.	31.7.2024.	15,000.00	9,144.00
57	613-24-4643-5-2-1	Llot 1 Asfaltimi i rrugicave në fshatrat Krojmir, Kraishtë dhe asfaltimi i rrugës me trotuar në fshatin Zllakuqan - faza V.	15.8.2024.	14.8.2024.	240,000.00	233,870.44
58	613-24-4684-5-2-1	Ndërtimi i urave në fshatrat Akllap, Janjevë dhe Banullë (faza III)	15.8.2024.	14.8.2024.	42,000.00	41,888.90
59	613-24-4795-5-2-1	Ndërtimi i infrastruktures se sallat e sportive ne Glllogovc dhe Rufc te Ri	16.8.2024.	15.8.2024.	118,000.00	106,606.98
60	613-24-6778-5-3-6	Renovimi i sallës se regenit në QKMF-Lipjan	22.8.2024.	20.8.2024.	8,000.00	7,071.15

61	613-24-7290-5-3-6	Finalizimi i punimeve në aneks objekt në shtëpinë me bazë në komunitet-Lipjan	5.9.2024.	4.9.2024.	8,000.00	6,500.00
62	613-24-8060-5-2-1	Rrërimi i objekteve të vjetra te tregu i gjelbër në Lipjan dhe rrërimi i objektit të vjetër të QMF-së në Shalë	17.9.2024.	16.9.2024.	12,500.00	12,499.00
63	613-24-7438-1-2-1	Rregullimi i kuzhinës me paisje përcjellëse të amvisërisë për Shtëpinë me bazë në Komunitet- Lipjan	23.9.2024.	20.9.2024.	15,000.00	10,284.25
64	613-24-8550-5-2-1	Rikonstruimi i rrugës së shkollës në Dobrajë të Madhe dhe rrugica tjera dhe rikonstruimi i trotuarit me ndriçim publik rr. Hivzi Sylejmani Dobrajë e Madhe - Ritenderim	26.9.2024.	25.9.2024.	298,165.89	297,729.73
65	613-24-9072-1-3-6	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal në Institucione shëndetësore.	1.10.2024.	30.9.2024.	6,000.00	2,825.20
66	613-24-8697-2-3-6	Promovimi dhe edukim shëndetësorë dhe materialet promovuese edukativo shëndetësore	1.10.2024.	30.9.2024.	9,500.00	6,467.70
67	613-24-8566-5-2-1	Ndërtimi i infrastrukturës te memoriali i UÇK-së në fshatin Shalë-ritenderim	10.10.2024.	9.10.2024.	25,000.00	23,999.50
68	613-24-8279-1-2-1	Furnizimi dhe montimi me klima-inverter për ngrohje dhe ftohje per QKMF, QMF, AMF si dhe DKRS-së	11.10.2024.	9.10.2024.	13,020.00	10,866.00
69	613-24-9629-5-3-6	Dislokimi i shtyllave elektrike në rrugën Bashkim Krasniqi dhe Zylfije Gashi në Lipjan - Ritenderim	15.10.2024.	14.10.2024.	5,000.00	4,999.00
70	613-24-9008-1-3-6	Furnizimi, montimi dhe funksionalizimi me inverter për aparatura Laboratorike në QKMF, QMF dhe AMF - Ritenderim	16.10.2024.	15.10.2024.	7,000.00	4,340.00
71	613-24-11209-5-5-8	Marrëveshje kornizë Furnizim me pemë dhe perime	28.11.2024.	26.11.2024.	8,500.00	5,696.85
72	613-24-9154-5-2-1	Aneks të rrjetit të ujësjellësit në lagjet në Sillovi dhe Lipjan- Ritenderim	25.10.2024.	24.10.2024.	60,000.00	57,333.25
73	613-24-11354-5-5-8	Furnizimi me paisje të teknologjis informative	25.11.2024.	21.11.2024.	28,800.00	27,340.00
74	613-24-10369-5-3-6	Ndërtimi i rrethrrrotullimit në kryqëzimin e rrugëve Haradin Bajrami, Bashkim Krasniqi dhe Zylfije Gashi	31.10.2024.	30.10.2024.	Shkëputur me marrëveshje dy anshme	
75	613-24-10628-5-2-1	Ndërtimi i infrastrukturës në oborrin e shkollës fillore në fshatin Ribar i Madh- Ritenderim	4.11.2024.	1.11.2024.	84,000.00	80,090.00
76	613-24-10635-5-3-6	Rehabilitimi i infrastrukturës në oborrin e qendrës së Azilit	6.11.2024.	15.11.2024.	9,484.00	6,861.00
77	613-24-10798-1-3-6	Furnizimi dhe montimi me table dixhitale	18.11.2024.	14.11.2024.	3,850.00	1,540.00
78	613-24-10372-5-2-1	Renovimi i objektit shtesë të Komunës (Baraka), renovimi-adaptimi i zyreve për nevojat e shërbyesve civil	22.11.2024.	21.11.2024.	24,000.00	22,904.73
79	613-24-11737-1-3-6	Blerja e dhuratave për festat e fundvitit- Ritenderim	9.12.2024.	6.12.2024.	3,000.00	2,920.00
80	613-24-10927-2-2-1	Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore dhe rregullimi i dëmtimeve në Komunën e Lipjanit	16.12.2024.	13.12.2024.	80,000.00	1,065.07
81	613-24-7437-5-3-6	Rregullimi dhe ngjyrosja e mureve të brendshme në Institucionet Shëndetësore në Lipjan në QKMF, QMF dhe AMF	18.12.2024.	17.9.2024.	9,000.00	3,630.00
82	613-24-11061-2-2-1	Përzgjedhja e kompanise per kryerjen e sherbimeve te demolimit dhe rrenimit te objekteve te ndertuara pa leje ndertimi	20.12.2024.	19.12.2024.	24,700.00	23,750.00
83	613-24-10891-2-2-1	Mirëmbajtja e tregjeve në Komunën e Lipjanit	20.12.2024.	19.12.2024.	35,000.00	20.00
84	613-24-11617-2-2-1	Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve gjatë sezonit verorë në qytetin e Lipjanit	24.12.2024.	23.12.2024.	80,000.00	79,791.61
85	613-24-11923-5-2-1	Mirëmbajtja dhe riparimet në rrjetin e kanalizimit në qytet dhe fshatra në Komunën e Lipjanit	31.12.2024.	30.12.2024.	300,000.00	1,353.50
86	001	Mbajtja e punetoris nje ditore,lidhur me pergaditjen e cash planit per vitin 2024	18.01.2024	€ 960.00	€ 960.00	€ 960.00

87	002	Transporti i nxënësve ne garat nderkombetare ne Tirane	07.02.2024	€ 920.00	€ 918.00	€ 918.00
88	003	Furnizimi me paisje te GPS-it	22.07.2024	€ 600.00	€ 355.00	€ 355.00
89	004	Drekë për familjet e Dëshmorëve, për nder të ditës së Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit	09.07.2024	€ 980.00	€ 960.00	€ 960.00
90	005	Bartja e lëndëve të vjetra dhe transporti i tyre nga Objekti i Qendres Kulturore Tahir Sinani kati I dyte,deri ne objektin e komunes se Lipjanit si dhe vendosja e tyre ne raftat e caktuar ne arkiven e komunes(bodrum).	10.07.2024	€ 800.00	€ 800.00	€ 800.00
91	006	Larja e tepiave në ÇEAP Çerdhja - Lipjan	25.4.2024	€ 997.50	€ 931.00	€ 931.00
92	007	Furnizimi me librezë, kartona dhe xhepa për bibliotekë	22.07.2024	€ 950.00	€ 950.00	€ 950.00
93	008	Rregullimi i kulmit te ashensorit ne QKMF-Lipjan	17.09.2024	€ 995.00	€ 980.00	€ 980.00
94	009	Shërbime te transportit ajror	16.09.2024	€ 500.00	€ 500.00	€ 500.00
95	010	Drekë zyrtare me rastin e mbajtjes së punëtorisë një ditore rreth kërkesave për vlerësimin e performances të gjithë mesimdhënsve	16.10.2024	€ 550.00	€ 540.00	€ 540.00
96	011	Kyqja e gjeneratorit 10kë në emergjencë, vazhdimi i kabllor dhe funksionalizimi i tij	06.11.2024	€ 990.00	€ 968.00	€ 968.00
97	012	Servisimi dhe qertifikimi i paisjes GPS-it	02.12.2024	€ 950.00	€ 950.00	€ 950.00
98	013	Ndarja e klasave me knauf ne shkollen ne Brus	07.11.2024	€ 980.00	€ 978.00	€ 978.00
99	014	Transporti i nxënësve të shkollës Vëllezërit Frashëri në garat ndërkombëtare në Tiranë	12.11.2024	€ 850.00	€ 841.50	€ 841.50
100	015	Dislokimi i shtyllave elektrike në rrugën Bashkim Krasniqi dhe Zylfije Gashi	21.11.2024	€ 850.00	€ 850.00	€ 852.00
101	016	Rehabilitimi i trotuarit ne ZE- Qylage	20.11.2024	€ 950.00	€ 945.00	€ 945.00
102	017	Furnizimi i shkollës 17 Shkurti Glllogovc me antifriz për ngrohje qendrore-Ritenderim	09.12.2024	€ 950.00	€ 880.00	€ 880.00
103	018	Sigurimi i 3 automjeteve te reja	03.12.2024	€ 990.00	€ 412.41	€ 412.41

Ankandet publike:

- Shitja e aseteve jashtë përdorimit në pronësi të komunës , në objektin e qendrës kulturore “Tahir Sinani” në Lipjan.
- Shitja e prodhimeve bimore, Grurit-Ritenderim.

Sfidat kanë qenë të natyrave të ndryshme:

- * Ankesat në Organi Shqyrtues i Prokurimi (OSHP), ka sjellur pasoja në mos lidhjen e kontratave duke pritur vendime e tyre, gjithashtu kërkesat për Ri-shqyrtim nga OE në vlerësimi të ofertave nga Drejtoria e Prokurimit.
- * Paramasat dhe paralogaritë për disa projekte kanë qenë jo mirë të formuluar nga Njësia Kërkuese, apo edhe nga OE të kontraktuar për çka është dashtë të ndërhyjë në rubrikën “përmirësim gabimi” dhe shtyerjen e hapjes së ofertave edhe për disa ditë tjera.
- * Paramasat dhe paralogaritë për disa projekte kanë qenë jo mirë të formuluar, me c`rats në gjatë fazës së vlerësimit kemi vërejtur gabimet dhe kemi anuluar procedurat.
- * Mungesa e Projekteve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit, sidomos për investimet kapitale.
- * Sfidë tjetër kemi shkëputjen e kontratave për mosrealizim nga OE dhe si të tillë, po shkaktojnë vonesa në mosrealizime dhe dëme buxhetore, edhe pse shkëputja e tyre është minimale.

Rekomandimet

Edhe gjatë kësaj periudhe raporuere, detyrë parësore e Drejtorisë së Prokurimit ka qene objektive ulja e kostos së shpenzimeve për gjitha llojet e shpenzimeve, realizimi me kohë dhe në mënyrë cilësore i gjitha kërkesave të njësive kërkuese, si dhe identifikimi real dhe vlerësimi i nevojave, në bashkëpunim të ndërsjellët me shfrytëzuesit e gjitha shtyllave të buxhetit. Nga 1 janari i viti 2017, me vendim të KRPP-së, përdorimi i prokurimit elektronik është bërë i obligueshëm për të gjitha organizatat buxhetore të nivelit qendror, lokal dhe ndërmarrjeve publike.

Rekomadohet të Çertifikohet zyrtari i cili ka filluar punën në vitin 2023.

Qështje të tjera

Një bashkëpunim të ngushtë, Drejtoria e Prokurimit në Lipjan, do ta ketë edhe me AQP-në, dhe KRPP-në, për të ofruar informata të nevojshme, kur AQP-ja në planin e saj ka udhëheqjen e prokurimeve të centralizuara për nevoja të autoriteteve kontraktuese të nivelit lokal ose atij qendror, ashtu sikurse është rregulluar me dispozitat e nenit 94 dhe 95 të LPP-së, dhe kordinimin-konsultimet me KRPP-në,

Drejtoria do të bashkëpunoi ngusht me organizatat e caktuara jo qeveritare mbi bazën e marrëveshjeve së bashkëpunimit e lidhur mes Komunës së Lipjanit, rrespektivisht me USAID-in, e cila në fokus ka bashkëpunimin, ofrimin e ndihmës dhe monitorimin e aktiviteteve të punës në Komunën e Lipjanit, me theks për kryerjen me sukses të aktiviteteve të punës, hapje ofertave, vlerësim dhe menaxhim të kontratave dhe punë tjera të nevojshme.

* Paramasat dhe parallogaritë për disa projekte kanë qenë jo mirë të formuluar nga Operatori Ekonomik dhe nga Njësia Kërkuese për çka është dashtë të ndërhyjë në rubrikën “përmirësim gabimi” dhe shtyerjen e hapjes së ofertave edhe për disa ditë tjera.

Perveç aktiviteteve të listuara më lartë drejtorati i prokurimit kryen edhe punë tjera si përgjigjeje në kërkesa për Rishqyrtim, dhënia e urdhërblerjeve, angazhimet tjera rutinore, dhe pjesëmarrja në punëtori apo trajnime të ndryshme.

Përfundimi

Drejtorati i prokurimit publik ka arritur të realizoj objektivat e veta, sipas planit e prokurimit dhe planit të punës, për vitin 2024, (80% realizimi i planit të prokurimit) janë brenda planit të prokurimit 2024,(shif planin e prokurimit) ndërsa aktivitetet tjera që janë jashtë planit të prokurimit janë me donacione apo me vendime të kuvendit komunal.